



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENSIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA / AGENCY FOR GENDER EQUALITY

MANUALI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT TË BARAZISË GJINORE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENSIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA / AGENCY FOR GENDER EQUALITY

MANUALI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT TË BARAZISË GJINORE

Ky manual është hartuar në mbështetje të nismës së Agjencisë për Barazi Gjinore dhe në zbatim të Projektit “Forcimi institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave gjinore në Kosovë” financuar nga Qeveria Suedeze, Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar – Sida dhe zbatuar nga konsorcium: Niras & CPM International



NIRAS

CPM
CONSULTING & PUBLIC MANAGEMENT INTERNATIONAL

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	5
Fjalorthi	7
Rreth këtij manuali	11
Kapitulli 1: Hyrje.....	13
Çfarë është VN(B)GJ?	14
Pse duhet politikëbërësit të përdorin V(N)BGJ-në?	19
Kornizat dhe angazhimet ligjore ndërkombëtare	22
Kornizat kombëtare rregullatore dhe ligjore	25
VN(B)GJ brenda kontekstit të VNR në Kosovë	26
Referenca në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve.....	27
Kapitulli 2: Karakteristikat kryesore të mjetit të VN(B)GJ-së.....	31
Udhëzim hap pas hapi.....	31
Tre fazat dhe pesë hapat e VNGJ-së	31
Faza I. Vlerësimi i Relevancës Gjinore	32
Hapi 1 Përkufizimi i Qëllimit të Politikës	32
Hapi 2. Vlerësimi i Relevancës Gjinore.....	36
Faza II. Vlerësimi i Ndikimit Gjinor	40
Hapi 3. Analiza e ndjeshme gjinore.....	41
Hapi 4. Peshimi i ndikimit gjinor.....	48
Faza e III-të. Vlerësimi i ndikimit të barazisë/cilësisë gjinore	58
Hapi 5 Gjetjet dhe propozimi	58
Kapitulli 3: Si mund të inkorporohet VN(B)GJ-ja në koncept dokument dhe vlerësimet tjera të ndikimit	63
Kombinimi me metodat tjera.....	63
Llojet e të dhënave të nevojshme	64
Formati(-et) i dokumentit të VN(B)GJ	69
Shtojcat	71
Shtojca 1. Instrumenti(-et), Tabelat dhe Shabllonet e VN(B)GJ	71
I. Vlerësimi i relevancës gjinore	71
Hapi 1 Përkufizimi i qëllimit të politikës.....	71
Hapi 2 Kontrolli i relevancës gjinore	74

II. Vlerësimi i ndikimit gjinor	76
Hapi 3 Analiza e ndjeshmërisë gjinore	76
Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor	80
III. Vlerësimi i Cilësisë Gjinore	87
Hapi 5 Gjetjet dhe propozimi	87
Shtojca 2. Referencat.....	89
Manualet e trajnimit	89
Dokumentet dhe raportet e zbatimit të VNGJ	91
Shtojca 3. Moduli i Trajnimit.....	93
Manuali, Konceptet, dhe Trajnimi në Praktikë për Vlerësimin/Analizën e Ndikimit Gjinor	93
I. Formulari i vlerësimit të relevancës gjinore (për këtë hap përdorni tabelën e dhënë në shtojcën e manualit të VNGJ-së së Kosovës).....	101
Hapi 2 Kontrollimi i relevancës gjinore (për këtë hap përdorni tabelën e dhënë në shtojcën e manualit të VNGJ-së së Kosovës)	101
II. Vlerësimi i ndikimit gjinor (për këtë hap përdorni tabelën e dhënë në shtojcën e manualit të VNGJ-së së Kosovës)	101
Hapi 3 Analiza e ndjeshme gjinore	102
Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor (për këtë hap përdorni tabelën e dhënë në shtojcën e manualit të VNGJ-së së Kosovës)	102
III. Vlerësimi cilësor gjinor, Hapi 5 Gjetjet dhe propozimet-5A Rekomandimet dhe rezultatet	102
Shtojca 4. Shembull i analizës së ndikimit gjinor	103

SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
CEDAW	Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (<i>e miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1979</i>)
COM (96)	Komunikata e Integritimit (<i>e miratuar nga Komisioni Evropian në shkurt 1996</i>)
KAZH	Komisioni për Asistencën Zhvillimore (në kuadër të OBEZH)
IEBGJ	Instituti Evropian për Barazi Gjinore (<i>i themeluar nga Parlamenti Evropian në vitin 2006</i>)
VN(B)GJ	Vlerësimi i Ndikimit (Barazisë) Gjinore
OBGJ	Objektivat e Barazisë Gjinore
PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
RIA	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator
GNZH	Gratë në Zhvillim (WID) (divizion i veçantë i themeluar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (<i>UNDP</i>) <i>ne fund të viteve të 60ta</i>)

FJALORTHI

Seksi, barazia gjinore, barazia dhe integrimi gjinor janë terma që janë bërë të zakonshme në diskursin global lidhur me integrimin gjinor. Megjithatë, vazhdon të ketë shumë paqartësi dhe debat rreth kuptimeve të tyre. Në kontekste të ndryshme dhe në kohë të ndryshme secili mund të përfaqësojë qëndrime të ndryshme ideologjike dhe mund të përdoret për të identifikuar një shumëllojshmëri praktikash. Pra, në fillim të këtij manuali është e rëndësishme të krijojmë një kuptim të përbashkët të koncepteve që ndërlidhen me integrimin gjinor, prej nga mund të vazhdojmë me një diskutim të detajuar dhe praktik. Përkufizimet e mëposhtme janë marrë nga marrëveshjet dhe dokumentet ndërkombëtare dhe thjesht paraqiten për të qartësuar dhe lehtësuar përdorimin e manualit pa u zhytur në debatet teorike, e ndonjëherë edhe abstrakte.

Gjinia dhe seksi— *Gjinia është një përkufizim i ndërtuar nga shoqëria për gratë dhe burrat. Ai është projektion shoqëror i seksit biologjik, i përcaktuar nga koncepti i detyrave, funksioneve dhe roleve që i atribuohen grave dhe burrave në shoqëri dhe në jetën publike dhe private. Ky është një përkufizim specifik për kulturën e feminitetit dhe mashkulloritetit dhe për këtë arsye ndryshon në kohë dhe hapësirë (Këshilli i Evropës 1998). Gjinia nuk është sinonim për seksin biologjik ose për gratë.*

Seksi biologjik — *identifikon dallimet biologjike midis grave dhe burrave dhe është i përcaktuar gjenetikisht. Vetëm një pjesë shumë e vogël e dallimeve në rolet e caktuara për burrat dhe gratë mund t'i atribuohet dallimeve biologjike ose fizike të bazuara në seksin biologjik. Për shembull, shtatzënia, lindja dhe dallimet fiziologjike mund t'i atribuohen karakteristikave të ndërlidhura me seksin biologjik.*

Marrëdhëniet gjinore — *Këto janë marrëdhënie shoqërore mes grave dhe burrave. Ato janë të lidhura me shpërndarjen e pushtetit mes sekseve biologjike. Ato përcaktojnë mënyrën se si ndahen përgjegjësitë dhe pritjet sociale, dhe mënyrën se si secilës i jepet një vlerë. Marrëdhëniet gjinore dallojnë sipas kohës dhe vendit, dhe midis grupeve të ndryshme të njerëzve. Kjo do të thotë se ato ndryshojnë sipas marrëdhënieve të tjera shoqërore si klasa, raca, etnia, aftësia e kufizuar, moshja dhe kultura. Një qasje ndaj politikave e bazuar në marrëdhëniet gjinore nënkupton vëmendjen ndaj mënyrave në të cilat ndërveprimet ndërmjet grave dhe burrave, dhe rrethanat nën të cilat të njëjtit ndër-veprojnë, janë relevante për politikën ekzistuese ose atë të propozuar. Në këtë aspekt, gjinia është proces dhe jo karakteristikë e një personi. Nuk kemi gjini; ne bëjmë gjininë.*

Barazia gjinore — *nënkupton një visibilitet, fuqizim dhe pjesëmarrje të barabartë të të dy sekseve biologjike në të gjitha sferat e jetës publike dhe private (Këshilli i Evropës 1998). Të kuptuarit e tillë të barazisë shkon përtej qasjes së thjeshtë të trajtimit të barabartë, që përcakton burrat dhe konditat e tyre si normë. Është e rëndësishme të pranojmë, për shembull, se shqetësimet e grave aborigjine lidhur me drejtësinë nuk janë gjithmonë të nxitura nga dëshira për barazi me burrat, por nga çështjet e bazuara në komunitet dhe të drejtat themelore të njeriut.*

Barabarësia gjinore — *është rezultat i të qenit i/e drejtë ndaj grave dhe burrave. Kjo e bën të domosdoshëm trajtimin dhe korrigjimin e faktorëve që kontribuojnë në nënshtrimin e grave. Për të siguruar drejtësinë, shpesh është e domosdoshme që të ketë në dispozicion masa për të kompensuar*

disavantazhet historike dhe sociale që pengojnë gratë dhe burrat për të vepruar ndryshe në kushte të barabarta. Drejtësia mund të kuptohet si mjeti, ku barazia është qëllimi. Drejtësia çon në barazi gjinore.

Analiza gjinore — është një proces për të vlerësuar ndikimin e ndryshëm të politikave, programeve, projekteve dhe legjislacionit të propozuar ose që ekzistues mbi burrat dhe gratë. Analiza gjinore njihet që realitetet e jetës së burrave dhe grave janë të ndryshme dhe se mundësitë e barabarta jo domosdoshmërishtë nënkupton rezultate të barabarta.

Diskriminimi sistematik — shkaktohet nga politikat dhe praktikët që janë ndërtuar në sisteme dhe që kanë efektin e përjashtimit të grave dhe pakicave. Megjithatë mund të mos përjashtojë të gjithë anëtarët e një grupi, efektet do të jenë më serioze mbi një grup sesa të tjerët.

Përgjegjshmëria gjinore — nënkupton vëmendje të vazhdueshme dhe sistematike ndaj dallimeve midis grave dhe burrave në shoqëri me qëllim adresimin e kufizimeve strukturore ndaj barazisë gjinore.

Qasja specifike për gratë — i referohet nismave që synojnë ekskluzivisht gratë apo vajzat. Këto iniciativa kanë tendencë të kenë një objektiv të qartë për të përmbushur nevojat praktike ose strategjike të grave që nuk adresohen gjithmonë përmes qasjes së integruar. Aktivitetet e tilla shpesh janë investime të vlefshme zhvillimore, veçanërisht aty ku ato janë katalitike, inovative ose strategjike, ose kur ato rregullojnë një pabarazi gjinore veçanërisht urgjente. Ato justifikohen si të domosdoshme për të tejkaluar verbërinë gjinore që në të kaluarën ka përjashtuar gratë nga përfitimet e zhvillimit.

Analiza gjinore dhe kulturore – zgjeron kornizën e “bazuar në gjini” për të përfshirë dhe reflektuar përvojat shumëdimensionale të grave në shtresa të ndryshme shoqërore dhe ekonomike dhe të grave nga mjedisë të ndryshme kulturore dhe gjuhësore. Të gjitha diskutimet rreth barazisë, drejtësisë apo të metave duhet të përfshijnë diskutimet rreth diversitetit dhe të drejtave të njeriut (Harris, 1990 & Ma Rhee, 2000).

Analiza neutrale gjinore — supozon që politikat/programet/projektet ndikojnë tek të gjithë njerëzit në të njëjtën mënyrë, ose politika/programi/projekti ka ndikim neutral ndaj njerëzve. Analiza neutrale-gjinore nuk jep rezultate të barabarta për gratë dhe burrat. Nëse përdorni një qasje neutrale-gjinore, pa qëllim do të përjetësoni pabarazitë ekzistuese në jetën e burrave dhe grave.

Organizimi gjinor i punës — Kjo i referohet mënyrave në të cilat gratë në shoqërinë tonë kanë përgjegjësinë kryesore për detyrat e kryera në sferën e brendshme (shtëpiake), kujdesin dhe edukimin e fëmijëve dhe vartësve të tjerë. Në anën tjetër, supozohet se meshkujt janë përgjithësisht të lirë të angazhohen me orar të plotë për të punuar jashtë shtëpisë. Kjo ndarje e pabarabartë e përgjegjësisë të kujdesit shpesh nënkupton se gratë punojnë në sektorë të veçantë të tregut të punës, ku punojnë me gjysmë orari për shembull. Rolet e grave në përkujdesje dhe edukim reflektohen edhe në industri dhe ndarjen profesionale të fuqisë punëtore.

Diversiteti — Koncepti i diversitetit tërheq vëmendjen në mënyrat në të cilat njerëzit kapërcejnë kategoritë e gjinisë, racës, aftësisë së kufizuar, moshës, orientimit seksual dhe klasës. Trajtimi i diversitetit nënkupton tërheqjen e vëmendjes në kryqëzimet ndërmjet/midis këtyre kategorive, ku këto kryqëzime janë relevante për politikën në fjalë. Për shkak se gjinia kuptohet në VN(B)GJ si një proces, është e rëndësishme të shqyrtohet ndikimi i supozimeve gjinore në krijimin e marrëdhënieve hierarkike përtej atyre midis "burrave" dhe "grave" (shih përkufizimin e marrëdhënieve gjinore më lartë).

RRETH KËTIJ MANUALI

Ky manual përbëhet nga kapitujt e mëposhtëm:

1. Hyrja (kapitulli i parë) ku prezanton shkurtimisht konceptin e VN(B)GJ-së dhe nxjerr në pah kornizat kyçe legjislative dhe rregullative të brendshme dhe të jashtme që rregullojnë zbatimin e VN(B)GJ-së në përgjithësi si dhe në Kosovë. Ky kapitull thekson procesin e VN(B)GJ-së brenda kontekstit të procesit të përgjithshëm të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator në Kosovë dhe tregon për përfitimet kryesore të përdorimit të këtij mjeti për politikë-bërje të përmirësuar dhe të informuar.
2. Kapitulli i dytë shpjegon qasjet standarde metodologjike të VN(B)GJ-së, si dhe i siguron përdoruesit fundor informacionin e detajuar mbi llojet e ndryshme të analizës gjinore dhe hapat e ndryshëm të VN(B)GJ-së.
3. Kapitulli i tretë i siguron politikë-bërësve një pasqyrë të modelit të përgjithshëm të VN(B)GJ-së, duke përfshirë fazat e zbatimit, shembujt praktik dhe modelet, si dhe shembujt e praktikave më të mira nga vendet e BE-së.

Shtojca e këtij manuali liston disa prej mjeteve, teknikave dhe modeleve të disponueshme për VN(B)GJ-në dhe që përdoren në nivel global, të cilët politikë-bërësit në Kosovë mund t'i përshtatin dhe shfrytëzojnë për zbatimin e VN(B)GJ-së në sektorë të ndryshëm.

KAPITULLI 1: HYRJE

Ky manual për Vlerësimin e Ndikimit (Barazisë) Gjimore (në tekstin e mëtejshëm si VN(B)GJ) dhe zbatimin e tij është hartuar - si udhëzues plotësues për nëpunësit publikë që e realizojnë VN(B)GJ si pjesë të procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator - për të ndihmuar politikë-bërësit dhe zbatuesit në Kosovë. Qëllimi i këtij manuali është të ofrojë informacione teorike dhe praktike mbi metodologjinë e VN(B)GJ-së dhe shfrytëzimin praktik për nëpunësit publik në Kosovë në mënyrë që t'u mundësohet atyre të kuptojnë më mirë teknikat që do t'i ndihmojnë ata të trajtojnë pabarazitë që ekzistojnë mes grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në fusha të ndryshme të politikave brenda shtresave të ndryshme të shoqërisë kosovare dhe të dalin me strategji të përshtatshme dhe praktike për t'i adresuar ato.

Përderisa manuali ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për pabarazitë gjimore midis politikë-bërësve, gjithashtu u prezanton atyre qasjen, metodologjinë dhe mjetet specifike që mund të përdoren për të siguruar zvogëlimin e paragjyqimeve gjimore që ndikojnë në veprimet e individëve dhe punën e institucioneve. Manuali merr parasysh praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe përfshin shembuj nga sektorë të ndryshëm. Gjithashtu, në hartimin e listave kontrolluese dhe tabelave për përdorim nga politikë-bërësit në Kosovë, manuali merr parasysh përvojat e këtyre qeverive rajonale dhe globale të cilët kanë kryer vlerësime të ndikimit të barazisë.


Ky manual është dizajnuar që të ndihmojë nëpunësit publikë, administratorët dhe aktorët e tjerë që janë të përfshirë në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e çdo politike, aktiviteti ose programi dhe duhet të shërbejnë si pikë referimi për të fuqizuar politikë-bërësit për të kryer një vlerësim të ndikimit të barazisë gjimore të të gjitha politikave, programeve dhe aktiviteteve për të siguruar që para zbatimit të tyre të bëhet një analizë e plotë mbi efektet e mundshme si për gratë ashtu edhe për burrat, respektivisht vajzat dhe djemtë. Përmbajtja është e projektuar që t'u sigurojë përdoruesve fundor njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të siguruar që politikatat, aktivitetet, programet apo masat janë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe në këtë mënyrë ofrojnë një kontekst për politikë-bërësit të zhvillojnë gjithashtu planifikimin e ardhshëm në integrimin gjinor.

Manuali përshkruan fazat më të zakonshme të zhvillimit të politikave publike, me qëllim që të ndihmojnë politikë-bërësit të ndërtojnë VN(B)GJ-të në sistemet e tyre të politikë-bërjes dhe rishikimit, pavarësisht nga madhësia e organizatës. Prandaj, manuali u mundëson organizatave dhe institucioneve të ndryshme t'i përshtatin këto faza në kontekstin e tyre duke ofruar metoda që mund të inkorporohen në një sërë zhvillimesh të politikave dhe proceseve të rishikimit për politikatat e reja dhe ato ekzistuese. Në mënyrë eksplicite mbulon kërkesat ligjore të integritetit dhe barazisë gjimore. Brenda saj, po ashtu, mbulohen edhe aspekte më të gjera të çështjeve që lidhen me barazinë (raca, mosha, aftësia e kufizuar, gjendja socio-ekonomike, besimet fetare etj.). Kështu, manuali përdor Vlerësimin e Ndikimit të Barazisë Gjimore kur përkufizimi më i gjerë është më i përshtatshëm dhe kur synohet që politikë-bërësit të mendojnë për ndikimin e politikave jashtë kontekstit të zakonshëm të "çështjeve të grave/vajzave" të politikave, programeve dhe masave të propozuara.

Së fundi, ky manual synon të përdoret si një nga mjetet bazë që udhëzon administratën publike të Kosovës në zbatimin dhe pajtueshmërinë me Strategjinë për rregullim më të mirë. Aplikimi i saj, në

kuadër të zbatimit të Analizës së Përgjithshme të Ndikimit Rregullator (ANRr)¹, kontribuon në integrimin gjinor pasi që është një nga mjetet e ANRr-së që duhet të aplikohet njëkohësisht sa herë që propozohet, hartohet, vlerësohet, etj., ndonjë kornizë e re rregullative. Mjeti i VN(B)GJ-së, i përdorur në kuadër të ANRr-së, mbron dhe promovon barazinë gjinore duke ri-orientuar politikën, aktivitetet, programet dhe projektet me qëllim të analizimit dhe adresimit të faktorëve të ndryshëm të diskriminimit dhe përjashtimit gjinor. Ky mjet synon gjithashtu promovimin e një sistemi të llogaridhënies dhe efektivitetit përmes vlerësimit të ndikimit mbi gjininë nëpërmjet zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të çdo legjislacioni, politike, aktiviteti, programi ose projekti.

Çfarë është VN(B)GJ?



Komisioni Evropian përkufizon vlerësimin e ndikimit të barazisë gjinore si në vijim: "**Vlerësimi i ndikimit të barazisë gjinore është procesi i krahasimit dhe vlerësimit, sipas kritereve relevante gjinore, i situatës dhe trendëve aktuale me zhvillimet e pritura që rezultojnë nga futja e politikës së propozuar**", dhe "**Vlerësimi i ndikimit të barazisë gjinore është vlerësimi i efekteve të ndryshme (pozitive, negative apo neutrale) të çdo politike ose aktiviteti të zbatuar për artikujt specifik në aspektin e barazisë gjinore**".

Vlerësimi i ndikimit të barazisë gjinore është përkufizuar si një vlerësim *ex ante*, analizë ose vlerësim i një ligji, politike ose programi që bën të mundur identifikimin, në mënyrë parandaluese, të gjasave të një vendimi të caktuar që ka pasoja negative mbi gjendjen e barazisë midis grave dhe burrave².

VNBGJ përfshin një qasje të dyanshme: duke shikuar pozicionin aktual që ka të bëjë me gjininë në lidhje me politikën në fjalë si dhe duke vlerësuar ndikimet e parashikuara për gratë dhe burrat pas zbatimit të politikës. Kjo lejon shqyrtimin e një propozimi të caktuar të politikave, për të zbuluar dhe vlerësuar ndikimin ose efektet e saj diferenciale mbi gratë dhe burrat, në mënyrë që këto mosbalancime të mund të korrigjohen para se të miratohet propozimi. Një analizë nga perspektiva gjinore ndihmon për të parë nëse ky propozim i shqyrton dhe trajton në mënyrë të barabartë nevojat e grave dhe burrave. Ajo u mundëson politikë-bërësve të zhvillojnë politika duke kuptuar realitetin

¹ Roli i një VNR është të ofrojë një vlerësim të hollësishëm dhe sistematik të ndikimeve të mundshme të një rregulloreje të re në mënyrë që të vlerësojë nëse rregullorja ka të ngjarë të arrijë objektivat e dëshiruara. Nevoja për VNR lind nga fakti që një rregullore zakonisht ka ndikime të shumta dhe se këto shpesh janë të vështira për t'u parashikuar pa një studim dhe konsultim të hollësishëm me palët e prekura. Qasjet ekonomike ndaj çështjes së rregullimit gjithashtu vënë në pah rrezikun e lartë që kostot rregullatore mund të tejkalojnë përfitimet. Nga ky këndvështrim, qëllimi qendror i VNR-së është të sigurojë që rregullorja do të përmirësojë mirëqenien nga pikëpamja shoqërore - domethënë përfitimet do të tejkalojnë kostot. VNR në përgjithësi zhvillohet në një kontekst krahasimor, ku mjetet e ndryshme për arritjen e objektivit të kërkuar analizohen dhe rezultatet krahasohen.

² Bazuar në përkufizimin e marrë nga Mjeti për Vlerësimin e Ndikimit të Barazisë Gjinore, botuar në vitin 2016 nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore.

socio-ekonomik të grave dhe burrave dhe lejon që politikat të marrin në konsideratë dallimet (gjinore). Ato mund të përdoren në administratë, si dhe nga “aktorë të jashtëm”, mirëpo, në të dyja rastet kërkojnë njohuri të konsiderueshme lidhur me çështjet gjinore. Avantazhi i këtij mjeti qëndron në faktin se nxjerr një pasqyrë shumë të saktë të efekteve të një politike, strategjie apo plani të caktuar. Sigurisht që vlerësimi i ndikimit të barazisë gjinore mund të aplikohet për legjislacionin, planet e politikave, programet e politikave, buxhetet, veprimet konkrete, projekt-ligjet dhe raportet ose thirrjet për hulumtim dhe nuk është menduar të aplikohet vetëm për politikat në hartim e sipër, por gjithashtu edhe për politikat ekzistuese.

Praktika e zbatimit të VN(B)GJ-së në faza të ndryshme të ciklit të politikave është krejtësisht e ndryshme nga përdorimi i saj në të kaluarën, ku në atë kohë, ky instrument shpeshherë është përdorur vetëm për vlerësimin e akteve legjislative. Në fakt, ky ka qenë interpretim shumë i ngushtë i potencialit të VN(B)GJ-së. Aktualisht fushëveprimi i vlerësimit të ndikimit të barazisë gjinore është më i gjerë. Përdorimi më i gjerë i vlerësimit të ndikimit të barazisë gjinore në vendet nordike ka treguar sa i dobishëm është ky instrument për t’iu ndihmuar politikëbërësve dhe shërbyesve publik që të analizojnë dhe parashikojnë ndikimin gjinor për çdo vendim të rëndësishëm që është nën shqyrtim, gjë që ndihmoi në përmirësimin dhe forcimin e masave ekzistuese dhe informimin e vendimeve lidhur me alokimin e buxhetit.

Kur duhet të kryhet një VN(B)GJ?

Praktikat botërore dhe rajonale tregojnë që autoritetet mund të kryejnë një VN(B)GJ përmes procesit të zhvillimit të politikave - në të gjitha pesë fazat kyçe të procesit:

Faza 1. Zhvillimi paraprak i politikave ose planifikimi i rishikimit të politikave

Faza 2. Hartimi i politikave dhe vlerësimi i ndikimit

Faza 3. Krijimi i qasjeve të monitorimit, vlerësimit dhe rishikimit

Faza 4. Nënshkrimi dhe publikimi i politikës

Faza 5. Monitorimi dhe rishikimi i planit të veprimit

Është e qartë se çdo politikë, propozim dhe akt ligjor që konsiderohet relevant në aspektin gjinor duhet t’i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit gjinor. Në anën tjetër, çdo propozim që konsiderohet si jo relevant në aspektin gjinor duhet të shoqërohet me një arsyetim mbështetës, duke shpjeguar arsyet pse aspekti gjinor nuk është relevant. Po kështu, edhe në rastet kur ndonjë rregullore, politikë apo program nuk i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit të barazisë gjinore, nuk nënkupton që politikëbërësit dhe shërbyesit publikë përgjegjës për hartimin, zbatimin, monitorimin ose vlerësimin e tij, nuk duhet të angazhohen për të promovuar barazinë gjinore dhe eliminuar pabarazitë. Në fakt, ata duhet të sigurohen që në hartimin e politikave dhe programeve të tyre, kanë marrë në konsideratë ndikimin që do të kenë këto rregullore, politika apo programe në grupe të ndryshme në shoqëri dhe për rrjedhojë, ndikimin e tyre të ndryshëm mbi gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në të gjitha ato grupe. Me të vërtetë VN(B)GJ-ja është instrument që ndihmon autoritetet publike të sigurojnë se politikat që ata krijojnë, dhe mënyrat se si ata i kryejnë funksionet e tyre, të bëjnë atë për çfarë janë synuar dhe për të gjithë.

Në të vërtetë, asnjëra nga politikat, legjislacionet dhe programet nuk janë neutral ndaj aspektit gjinor, prandaj zbatimi i vlerësimit të ndikimit të barazisë gjinore duhet të përfshihet në të gjitha kornizat e

politikave në të gjitha nivelet, në të gjithë sektorët socio-ekonomik dhe nën-sektorët që nga bujqësia dhe siguria e ushqimit e deri tek arti, arsimi, mbrojtja sociale, shëndetësia, etj. Në fushat e menaxhimit të sektorit publik³, zbatimi i VN(B)GJ-së duhet të konsiderohet si *de rigneur* (i domosdoshëm). Edhe pse ekzistojnë disa politika ku aspekti gjinor (ose aftësia e kufizuar, moshë, përkatësia etnike) luan (-jnë) një rol thelbësor, prapë se prapë janë disa të tjera ku relevanca e saj është më pak e dukshme. Si rezultat, këto nganjëherë etiketohen si politika neutrale në aspektin gjinor/ jo diskriminuese (për shembull: shëndeti dhe siguria dhe planifikimi rajonal apo i qytetit). Nëse politikat perceptohen gabimisht si neutrale në aspektin gjinor dhe rrjedhimisht konsiderohen se ndikojnë tek popullata si grup homogjen, atëherë do heqin mundësitë për të përfshirë pikëpamje nga grupe të ndryshme të grave dhe burrave në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe, nga ana tjetër, do llogariten keq efektet e ndryshme në secilin grup, si dhe në sistemet dhe organizatat që i mbështesin ato.

Thjesht, në kontekstin më të gjerë të menaxhimit të financave publike dhe qeverisjes së mirë, VN(B)GJ-ja është instrument që duhet përdorur në hartimin e politikave të bazuara në dëshmi, dhe duhet të jetë pjesë integrale e vendimmarrjes së mirë nga një organizatë.

Gjithashtu, ajo mund të ndihmojë autoritetet publike për të kuptuar plotësisht rëndësinë dhe efektin e politikave dhe për të identifikuar përgjigjet më proporcionale dhe efektive⁴. Në vazhden e reduktimeve të vazhdueshme buxhetore në shpenzimet publike, ku institucionet duhet të marrin vendime të vështira financiare, VN(B)GJ-ja mund të përdoret si instrument kyç për të siguruar që këto politika dhe vendime buxhetore janë bërë në bazë të dëshmive, dhe të marrin në konsideratë nevojat e të gjithë anëtarëve të shoqërisë.

³ Menaxhimi ekonomik, Menaxhimi publik fiskal dhe shpenzimet publike, Administrata publike, Decentralizimi, Ligji dhe gjyqësori, Demokratizimi (reforma zgjedhore), Integrimi evropian etj.

⁴ Ofrimi i shërbimeve publike varet nga kuptimi i komuniteteve të ndryshme që duhet shërbyer, duke marrë parasysh nevojat e ndryshme.

SHËNIM PËR SKEDAR


⇒ Qëllimi i çdo vlerësimi të ndikimit është të analizojë efektet e mundshme të planeve ose programeve të reja të politikave para zbatimit, po ashtu VN(B)GJ është jashtëzakonisht e dobishme me rastin e analizimit të efekteve të politikave, programeve dhe projekteve aktuale, dhe njësoj sikurse me vlerësimet e tjera të ndikimit, ekzistojnë disa hapa të përfshirë në hartimin e studimit të vlerësimi të ndikimit të barazisë gjinore. Këto shpesh përfshijnë:

1. Një përshkrim të plotë të situatës aktuale para zbatimit të një plani të ri të politikave.
2. Vlerësimin e zhvillimit të mundshëm të kësaj situatë në mungesë të ndonjë politike të re. (të ashtuquajtur *alternativa zero*).
3. Analiza e përmbajtjes së planit të politikave, masat e tij, oraret, qëllimet dhe fushat e veprimit.

Analiza e situatës aktuale, zhvillimi i mundshëm i situatës, dhe plani i politikave e bëjnë të mundur të:

4. Përshkruhen efektet e mundshme, dhe
5. Balancohen efektet pozitive dhe negative kundrejt njëra tjetrës.

Në përgjithësi, procesi i vlerësimi të ndikimit të barazisë gjinore duhet të përfshijë tre faza vlerësimi:




Fazat e VN(B)GJ-së

⇒ Analiza e ndikimit të barazisë gjinore ka për qëllim të **(i)** identifikojë çështjet kyçe gjinore dhe përcaktuesit që lidhen drejtpërsëdrejti me shërbimet e synuara që do të ofrohen nga politika/strategjia/projekti; **(ii)** informoj hartimin e projekteve me përfshirje gjinore duke identifikuar mundësitë për të maksimizuar përfitimet gjinore dhe për të minimizuar dhe zbutur ndikimet apo rreziqet negative gjinore përmes politikës/strategjisë/projektit të propozuar; dhe **(iii)** mbledh të dhënat bazë/pikënisje të ndara sipas seksit që do të përdoren për monitorimin e outputeve, rezultateve dhe ndikimeve të projektit gjatë zbatimit të tij.

Në thelb VN(B)GJ-ja është një proces që përkthen çështjet relevante gjinore dhe sektoriale në projekt propozime në kuadër të konteksteve specifike të politikave, teknologjisë dhe institucioneve

⇒ Një VN(B)GJ e plotë (komplete) e politikës, strategjisë ose projektit do të përmbajë një analizë rreth:


- Dallimeve mes grave dhe burrave në fushën (-at) e analizuar të ndikimit.
- Mënyrës se si mund të kontribuoj politika, programi dhe projekti në eliminimin e pabarazive ekzistuese dhe në promovimin e barazisë midis grave dhe burrave.



Përmbajtja dhe lloji i informatave prezente në VN(B)GJ

Pse duhet politikëbërësit të përdorin V(N)BGJ-në?

Autoritetet kanë për detyrë ligjore eliminimin e diskriminimit të paligjshëm, avancimin e mundësive të barabarta dhe nxitjen e marrëdhënieve të mira të bazuara në karakteristikat e mbrojtura si gjinia, raca, aftësia e kufizuar ose moshë. Këto detyra nuk i pengojnë ata të marrin vendime për zvogëlimin e shërbimeve ose përfitimeve kur është e nevojshme, por në anën tjetër proceset sikurse V(N)BGJ-ja ofrojnë një mënyrë për zhvillimin e propozimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve që i marrin parasysh nevojat specifike të grupeve të caktuara, posaçërisht kur pozita e aktorëve të caktuar (grave) nuk është e barabarte në piken fillestare. Është e mundur që V(N)BGJ-ja të realizohet para intervenimit (ex ante) ose të monitorohen dhe të vlerësohen rezultatet dhe implikimet e politikave dhe ndërhyrjeve aktuale (të tilla si masat shtrënguese gjatë krizës së fundit ekonomike). Pasi që përgjegjësia për këto politika dhe shërbime të duhura bie mbi institucionet relevante, menaxhmenti i lartë në këto institucione duhet të siguroj që profesionistët të cilët punojnë në përgatitjen e opsioneve të politikave dhe të cilët hartojnë propozimet e programeve dhe politikave, të kuptojnë rëndësinë e përdorimit të instrumenteve siç është VN(B)GJ-ja. Politikëbërësit që nuk përdorin VN(B)GJ-të, rrezikojnë të marrin vendime të gabuara dhe të padrejta që mund të diskriminojnë grupe të veçanta dhe madje të përkeqësojnë pabarazinë ndërmjet grupeve të ndryshme. Vendimi gjithashtu mund të jetë i hapur për sfida ligjore dhe mund të çojë në rezultate më të dobëta që sjellin ngarkesa shtesë financiare në një fazë të mëvonshme.



Synimi dhe qëllimi i shfrytëzimit të VN(B)GJ-së

SHËNIM PËR SKEDAR

Vlerat e shtuara të VN(B)GJ-së

Instrument për të fuqizuar barazinë gjinore

Puna drejt barazisë gjinore është një qëllim shoqëror i mirë rregulluar. Ligji kombëtar në Kosovë, si dhe në të gjitha shtetet anëtare të BE-së rregullon mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të gjinisë/seksit. Përveç kësaj, sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut ekziston detyrimi për ta promovuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Përtej ligjit, ekziston një pranim i përgjithshëm - si dhe dëshmi empirike - se barazia gjinore promovon kushte më të mira në vendin e punës dhe përmirëson produktivitetin. Të dish se si funksionon pabarazia gjinore, si ndikohet nga politika publike, si është e pranishme në sektorët dhe sferat e ndryshme të jetës është çelësi për eliminimin e pabarazisë gjinore. Një vlerësim i ndikimit gjinor është ndoshta hapi i parë më i mirë drejt politikave që ndihmojnë në realizimin e këtij objekti.

Politikat më të mira

Vlerësimi i ndikimit të barazisë gjinore - si të gjitha proceset e vlerësimit të ndikimit - kontribuon në krijimin e një politike dhe legjislacioni më të mirë, pasi që ai ofron informata rreth rezultatit të parashikuar. Kjo lejon mundësinë e përfshirjes së elementeve që kanë munguar gjatë fazës së hartimit të rregullores, politikës ose programit. Krijimi i politikave më të mira nënkupton identifikimin e boshllëqeve gjinore dhe kuptimin e pabarazive gjinore në këtë fushë, në mënyrë që të përcaktohen prioritetet dhe të arrihet grupi i synuar. Këto masa mund të ofrojnë mbrojtje ndaj kurtheve të mundshme dhe të maksimizojnë fushëveprimin për arritjen e objektivave të synuara. Ndërhyrjet e projektuara dobët dhe të orientuara gabimisht prodhojnë rezultate jo të kënaqshme dhe ndikime të paqëndrueshme. Njohuritë dhe analiza joadekuata e situatës, si dhe problemeve dhe nevojave të grupeve të synuara/përfituesve të synuar, çojnë në adoptimin e zgjidhjeve të papërshtatshme ose të pjesshme për këto probleme dhe nevoja.

Nëse grupet e synuara përcaktohen vetëm në terma të gjerë (të rinjtë, minoritetet, pensionistët e ardhshëm, të sëmurët, të moshuarit, studentët, të varfrit, etj.) dhe nëse nuk janë analizuar fare ose në një masë të pamjaftueshme dallimet gjinore në mes të grupeve të synuara, është e pamundur që të sigurohet ose vlerësohet nëse ndërhyrja e planifikuar plotëson nevojat e grave dhe burrave brenda grupeve më të gjera.

Qeverisja më e mirë

Një vlerësim i ndikimit gjinor i cilësisë së lartë kontribuon në politikë-bërje dhe punën legjislative që është më relevante për shoqërinë, për shkak se reagon ndaj nevojave të të gjithë qytetarëve (gra dhe burra, vajza dhe djem). VN(B)GJ-ja ka për qëllim t'i ndihmojë autoritetet publike që t'i përmbushin kërkesat e detyrave të barazisë dhe t'i identifikojnë hapat aktivë që duhet të ndërmerren për ta promovuar barazinë.

Realizimi VN(B)GJ-së përfshinë vlerësimin sistematik të ndikimeve të mundshme (apo reale) të politikave në njerëzit sa i përket aftësisë së kufizuar, barazisë gjinore dhe racore dhe, kur autoritetet zgjedhin, madje edhe fusha më të gjera të barazisë. Kjo përfshin kërkimin e mundësive për të promovuar barazinë, të cilat më parë janë humbur ose kanë mundur të përdoren më mirë, si dhe identifikimin e ndikimeve negative ose të pafavorshme që mund të largohen ose zbuten, ku është e mundur. Nëse ndonjë ndikim negativ ose i pafavorshëm përbën diskriminim të paligjshëm, ai nuk duhet të përfshihet.

Sigurimi i perspektivës gjinore në fazat e hershme të politikë-bërjes ndihmon që të adresohen çështje më të duhura për grupet specifike të synuara dhe mundëson që të planifikohen masa të duhura - si dhe të alokohet buxheti i duhur për t'i arritur objektivat e përcaktuara

Një mjet për të mësuar

Hartimi i një politike që është efektive në zvogëlimin e pabarazisë gjinore dhe që promovon në mënyrë proaktive barazinë, kërkon të njohim se si pabarazia gjinore shprehet në të gjitha sferat e jetës. E njëjta vlen edhe për atë se si duhet të përcaktohen prioritetet lidhur me masat e barazisë gjinore.


Vlerësimi i ndikimit gjinor u mundëson politikëbërësve që t'i shohin sfidat sa i përket barazisë gjinore dhe t'i identifikojnë veprimet e nevojshme për t'i tejkaluar boshllëqet gjinore. Gjithashtu, mund të jetë i dobishëm për t'i kuptuar pabarazitë strukturore gjinore në të cilat bazohen boshllëqet gjinore. Të bërit pyetje dhe të grumbulluarit e të dhënave dhe informatave tjera relevante mund të kontribuojnë në ndërtimin e njohurive të rëndësishme lidhur me pabarazinë gjinore.

Përfitimet nga VN(B)GJ-ja

Realizimi i Vlerësimit të Ndikimit të Barazisë Gjinore VN(B)GJ jo vetëm që do t'i ndihmojë institucionet t'i përmbushin detyrat e tyre ligjore dhe mandatin e tyre dhe njëkohësisht të ofrojnë shumë përfitime për përdoruesit fundorë të shërbimeve dhe të drejtave në fjalë, ai gjithashtu do të:

- ❖ Sigurojë që vendimet e marra nga autoritetet publike **të kenë ndikim në të gjithë (grupet e ndryshme të synuara) në mënyrë të drejtë**
 - ⇒ kur ekzistojnë dëshmi se grupe specifike do të ndikohen negativisht nga një vendim, duhet të merren veprime për ta adresuar këtë.
- ❖ Sigurojë që këto vendime **bazohen në dëshmi**
 - ⇒ VN(B)GJ-ja ofron një mënyrë të qartë dhe të strukturuar për mbledhjen, vlerësimin dhe paraqitjen e dëshmive relevante.
- ❖ Sigurojë që proceset e vendimmarrjes janë **më transparente**
 - ⇒ një proces që përfshin ata që janë të prekur nga politika dhe që bazohet në dëshmi dhe është shumë më i hapur dhe transparent. Kjo ka më shumë gjasë të nxisë besimin tek vendimmarrësit dhe në vendimet mbi politikat.
- ❖ Sigurojë një platformë për **punën në partneritet**
 - ⇒ VN(B)GJ-ja ofron një mundësi për institucionet që të punojnë në partneritet dhe të marrin në konsideratë ndikimin mbi përfituesit e tyre, që t'i synojnë komunitetet dhe të identifikojnë se si ata mund të bashkëpunojnë dhe të koordinohen më mirë në vendimet politike dhe financiare.

Kornizat dhe angazhimet ligjore ndërkombëtare



Bazat që mundësojnë lidhjen midis perspektivës gjinore dhe vlerësimit të ndikimit u vendosën nga Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), e miratuar në vitin 1967 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) në formulimin i cili detyron nënshkruesit të inkorporojnë parimin e barazisë mes burrave dhe grave në sistemin e tyre ligjor, të shfuqizojnë të gjitha ligjet diskriminuese dhe të miratojnë ato që ndalojnë diskriminimin ndaj grave. Në CEDAW, pabarazitë gjinore kuptohen si të prodhuara nga diskriminimi i bazuar në seks, dhe të përsëriten më tej dhe të riprodhohen nga strukturat institucionale shtetërore dhe shoqërore.

Për të tejkaluar diskriminimin dhe pabarazitë në baza gjinore, CEDAW shikon barazinë nga një pikëpamje tre dimensionale. Në vend që të shqyrtojë barazinë në terma formal dhe ligjor dhe duke thënë se ligjet dhe politikat sigurojnë barazi midis grave dhe burrave thjesht duke qenë neutrale nga pikëpamja gjinore, CEDAW kërkon që të konsiderohet edhe ndikimi dhe efekti i tyre real.

Sipas CEDAW, shteti jo vetëm që është i obliguar të shfuqizojë ligjet që diskriminojnë drejtpërdrejt në bazë të gjinisë, por gjithashtu duhet të sigurojnë që të gjitha rregullimet e nevojshme janë krijuar dhe u mundësojnë grave të përjetojnë barazi dhe të gëzojnë të drejtat në jetën e tyre. CEDAW konsideron se Shtetet jo vetëm që janë përgjegjëse për veprimet e tyre, por duhet të eliminojnë diskriminimin dhe pabarazitë që kryhen nga individë dhe organizata⁵.



Në CEDAW, pabarazitë gjinore kuptohen si të prodhuara nga diskriminimi i bazuar në seks, dhe të përsëriten më tej dhe të riprodhohen nga strukturat institucionale shtetërore dhe shoqërore.



Për të tejkaluar diskriminimin dhe pabarazitë në baza gjinore, CEDAW shikon barazinë nga një pikëpamje tre dimensionale. Në vend që të shqyrtojë barazinë në terma formal dhe ligjor dhe duke thënë se ligjet dhe politikat sigurojnë barazi midis grave dhe burrave thjesht duke qenë neutrale nga pikëpamja gjinore, CEDAW kërkon që të konsiderohet edhe ndikimi dhe efekti i tyre real.



Sipas CEDAW, shteti jo vetëm që është i obliguar të shfuqizojë ligjet që diskriminojnë drejtpërdrejt në bazë të gjinisë, por gjithashtu duhet të sigurojnë që të gjitha rregullimet e nevojshme janë krijuar dhe u mundësojnë grave të përjetojnë barazi dhe të gëzojnë të drejtat në jetën e tyre. CEDAW konsideron se Shtetet jo vetëm që janë përgjegjëse për veprimet e tyre, por duhet të eliminojnë diskriminimin dhe pabarazitë që kryhen nga individë dhe organizata.

REFERENCA NDAJ VNBGJ NË KONVENTËN PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE (CEDAW)

⁵ Shihni gjithashtu: Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979), <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>

Gjithashtu, brenda Platformës së Pekinit për Veprim të OKB-së, interpretimi i "gjinia" dhe "vlerësimi" janë eksplicite, dhe koncepti "integrimi (i) perspektivës gjinore" është prezantuar si parakusht për përfshirjen e perspektivës gjinore në proceset e politik bërjes në të gjitha nivelet. Metodatat me të cilat mund të arrihen këto qëllime janë sqaruar në vitin 1995 në Konferencën e 4-të Botërore të Kombeve të Bashkuara në Pekin. Konferenca krijoi një platformë për veprim për VN(B)GJ-në dhe analiza tjera relevante gjinore. Në veçanti, neni 202 thotë që: *"Gjatë adresimit të çështjes së mekanizmave për promovimin e avancimit të grave, qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të perspektivës gjinore në të gjitha politikatat dhe programet, në mënyrë që, para marrjes së vendimeve, të bëhet një analizë lidhur me efektet mbi gratë dhe burrat, respektivisht"*. Objektivi strategjik H2 (1a) kërkon që të gjitha shtetet anëtare të *"përpiqen të sigurojnë se para marrjes së vendimit për një politikë të kryhet një analizë e ndikimit të tyre në gratë*

Gjithashtu, brenda Platformës së Pekinit për Veprim të OKB-së, interpretimi i "gjinia" dhe "vlerësimi" janë eksplicite, dhe koncepti "integrimi (i) perspektivës gjinore" është prezantuar si parakusht për përfshirjen e perspektivës gjinore në proceset e politik-bërjes në të gjitha nivelet.



Në veçanti, neni 202 thotë që: *"Gjatë adresimit të çështjes së mekanizmave për promovimin e avancimit të grave, qeveritë dhe aktorët e tjerë duhet të promovojnë një politikë aktive dhe të dukshme të integritit të perspektivës gjinore në të gjitha politikatat dhe programet, në mënyrë që, para marrjes së vendimeve, të bëhet një analizë lidhur me efektet mbi gratë dhe burrat, respektivisht"*. Objektivi strategjik H2 (1a) kërkon që të gjitha shtetet anëtare të *"përpiqen të sigurojnë që para marrjes së vendimit për një politikë, të kryhet një analizë e ndikimit të tyre në gratë dhe burrat."*

REFERENCA NDAJ VNBJGJ NË PLATFORMËN E VEPRIMIT TË PEKINIT

dhe burrat⁶."

Kornizat e sipërpërmendura kanë pasur ndikim edhe në mënyrën se si arrihet barazia gjinore, ndër të tjera, në Bashkimin Evropian⁷. Në shkurt të vitit 1996, Komisioni Evropian miratoi komunikatën mbi integrimin⁸ si hap i parë drejt zbatimit të angazhimit të BE-së ndaj integritit gjinor në nivel të Komunitetit. Në Dokumentin vijues Strategjik të muajit shkurt të vitit 1997, i dakorduar nga Grupi për ndër-shërbime dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, vlerësimi i ndikimit të barazisë gjinore në shërbimet e Komisionit përmendet në mesin e masave bazë. Për më tepër, Traktati i Amsterdimit formalizon angazhimin për integrim në nivel evropian dhe shprehimisht përmend eliminimin e pabarazive si dhe promovimin e barazisë midis grave dhe burrave në mesin e detyrave dhe

⁶ Po aty.

⁷ J. Rubery dhe C. Fagan, 2000. Vlerësimi i Ndikimit Gjinor dhe Politika Evropiane e Punësimit. Qendra Evropiane e Hulumtimit të Punës dhe Punësimit (EÉERC). Manchester School of Management UMIST.

⁸ COM (96) 67 final i 21 shkurtit 1996 mbi: "Inkorporimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha politikatat dhe aktivitetet e Komunitetit".

objektivave të Komunitetit në nenet 2 dhe 3⁹. Neni 2(d) i Konventës thotë se: *"Nënshkruesit e konventës duhet të zotohen që të përmbahen nga kryerja e ndonjë veprimi apo praktike të diskriminimit ndaj grave dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike veprojnë në përputhje me këtë detyrim"*, dhe neni 3 thotë se: *"Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, në të gjitha fushat veçanërisht në fushat politike, sociale, ekonomike dhe kulturore, për të siguruar zhvillimin dhe përparimin e plotë të grave, me qëllim garantimin e ushtrimit dhe gëzimit të drejtave njerëzore dhe lirive themelore mbi baza të barazisë me burra"*¹⁰.

Pas Pekinit, Komisioni Evropian lëshoi një komunikatë mbi integrimin gjinor duke e definuar atë si: *"mobilizimi i të gjitha politikave dhe masave të përgjithshme në mënyrë specifike për arritjen e barazisë duke marrë parasysh në mënyrë aktive dhe të hapur gjatë fazës së planifikimit efektet e tyre të mundshme në situatat përkatëse të burrave dhe grave (perspektiva gjinore)"* (COM (96) 67).

Integrimi gjinor si politikë e BE-së u formalizua në Traktatin e Amsterdimit në vitin 1997 dhe u pranua që për t'u zbatuar siç duhet integrimi gjinor kërkon një sërë teknikash dhe instrumentesh të politikës (Rubery dhe Fagan, 2000). Rrjedhimisht, Këshilli i Evropës (2004: 20-21) siguroi një sinopsis të dobishëm të vlerësimit të ndikimit të barazisë si një nga instrumentet e nevojshme për të funksionalizuar integrimin gjinor. Për të udhëhequr këtë proces, Parlamenti Evropian në vitin 2006 krijoi Institutin Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ), i cili ofron udhëzime të gjera mbi të gjitha aspektet e integritit gjinor duke përfshirë vlerësimin e ndikimit të barazisë gjinore. Udhëzuesit e përpiluar deri më sot nga EIGE kanë qenë, dhe në këtë rast vazhdojnë të jenë baza për zhvillimin e manualeve specifike për sektor dhe vende, në zbatimin e VN(B)GJ-së.

Traktati i Amsterdimit formalizon angazhimin për integrim në nivel evropian dhe shprehimisht përmend eliminimin e pabarazive si dhe promovimin e barazisë midis grave dhe burrave në mesin e detyrave dhe objektivave të Komunitetit në nenet 2 dhe 3. Neni 2(d) i Konventës thotë se: *"Nënshkruesit e konventës duhet të zotohen që të përmbahen nga kryerja e ndonjë veprimi apo praktike të diskriminimit ndaj grave dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike veprojnë në përputhje me këtë detyrim"*, dhe neni 3 thotë se: *"Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, në të gjitha fushat veçanërisht në fushat politike, sociale, ekonomike dhe kulturore, për të siguruar zhvillimin dhe përparimin e plotë të grave, me qëllim garantimin e ushtrimit dhe gëzimit të drejtave njerëzore dhe lirive themelore mbi baza të barazisë me burra"*

VNGJ DHE TRAKTATI I AMSTERDAMIT

⁹ OECD/DAC/WID Formulari i Vlerësimit të Ndikimit Gjinor, i përdorur ndër të tjerë nga DG IB, Paketa e Trajnimit Gjinor të ILO-s.

¹⁰ <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/text/econvention.htm#article2>

Kornizat kombëtare rregulatore dhe ligjore



Kornizat e politikave në Kosovë mbështesin qëllimin përfundimtar të ndryshimit të qëndrimeve ndaj grave deri në atë pikë ku kuotat dhe masat e tjera afirmative nuk do të jenë më të domosdoshme, megjithëse zbatimi i këtyre rregulloreve lë për të dëshiruar. Në fakt, korniza legjislative e Kosovës është shembullore. Kushtetuta e Kosovës e përkufizon barazinë gjinore si "*vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, dhe për të arritur këtë, duhet të sigurohen mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.*" Gjithashtu, neni 22 i Kushtetutës i ka dhënë funksion kushtetues dispozitive të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave (CEDAW). Për më tepër, Ligji Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore (LBGJ), garanton, mbron dhe promovon barazinë gjinore në të gjitha nivelet dhe të gjithë sektorët e shoqërisë kosovare, ku Neni 4 në mënyrë specifike ndalon diskriminimin gjinor dhe Neni 5 (më relevanti për vlerësimin e ndikimit të barazisë gjinore) promovon masat për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe për sigurimin e barazisë gjinore.

Neni 22 i Kushtetutës i ka dhënë funksion kushtetues dispozitive të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave (CEDAW).

Ligji Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore (LBGJ) garanton, mbron dhe promovon barazinë gjinore në të gjitha nivelet dhe të gjithë sektorët e shoqërisë kosovare, ku **Neni 4** në mënyrë specifike ndalon diskriminimin gjinor dhe **Neni 5** (më relevanti për vlerësimin e ndikimit të barazisë gjinore) promovon masat për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe për sigurimin e barazisë gjinore.

KUSHTETUTA E KOSOVËS DHE LIGJI MBI BARAZINË GJINORE

Ligji përcakton që parimet e barazisë gjinore dhe integrimi duhet të zbatohen në të gjitha fazat e analizës, planifikimit, buxhetimit dhe zbatimit të politikave dhe legjislacionit nga subjektet publike dhe private. Të gjitha institucionet publike - legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe më gjerë - duhet të sigurojnë që elementet themelore të barazisë gjinore përfshihen në hartimin dhe zbatimin e politikave të tyre dhe kornizave ligjore. Kjo përfshin konceptet, proceset, sistemet dhe instrumentet. Natyrisht, kjo gjithashtu nënkupton që vlerësimi i ndikimit të barazisë gjinore, si instrument për kryerjen e analizës gjinore, duhet të jetë pjesë integrale e zhvillimit të politikave dhe procesit të hartimit të Koncept Dokumenteve.

VN(B)GJ brenda kontekstit të VNR në Kosovë



Ligji kombëtar në Kosovë, si dhe në të gjitha vendet anëtare të BE-së parashih mbrojtje kundër diskriminimit të bazuar në gjini/seks. Përveç kësaj, sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ekziston një detyrim për të promovuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.



Kornizat e politikave në Kosovë e mbështesin qëllimin përfundimtar të ndryshimit të qëndrimeve ndaj grave deri në atë pikë ku kuotat dhe masat e tjera afirmative nuk do të jenë më të nevojshme, megjithëse zbatimi i atyre rregulloreve mbetet shumë i rëndësishëm.

VNGJ BRENDË RREGULLATORIT KOMBËTAR DHE KORNIZAVE LIGJORE

01

Grumbullimi i rregullt i të dhënave të ndara në baza gjinore dhe shpërndarja e tyre.

02

Analiza gjinore e të dhënave dhe analizave në lidhje me statusin e burrave dhe grave në sektorin/et përkatës ose problemin/et në fjalë.

03

Integrimi gjinor i të gjitha politikave, dokumenteve dhe legjislacionit.

04

Miratimi i strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ).

05

Përfshirja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha fushat, si mjet i nevojshëm për të garantuar respektimin e parimit të barazisë gjinore në grumbullimin, shpërndarjen dhe alokimin e burimeve.

06

Alokimi i burimeve adekuate njerëzore dhe financiare në kornizën e politikave për arritjen e barazisë gjinore.

KËRKESAT KRYESORE TË LIGJIT TË KOSOVËS PËR BARAZINË GJINORE NË ZBATIMIN E VN(B)GJ

Siç u përmend shkurtimisht në hyrje, në vitin 2017, autoritetet në Kosovë filluan me procesin e zhvillimit dhe hartimit të Udhëzimeve dhe Manualit për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Këto instrumente janë të destinuara për të mbështetur politikë-bërësit në zhvillimin e koncept dokumenteve të reja dhe rrjedhimisht politikat që përdorin Vlerësimin e Ndikimit Rregullativ (VNR) si një qasje sistematike për të vlerësuar në mënyrë kritike efektet pozitive dhe negative të rregulloreve të propozuara dhe ekzistuese dhe alternativat jo-rregullatore. VN(B)GJ është e integruar në kuadër të këtij procesi si pjesë e përpjekjeve për të forcuar politikat me qëllim të arritjes së barazisë *de facto* mes grave dhe burrave.

Vendosja e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në qendër të agjendës nacionale për demokratizim tregon se autoritetet pranojnë se arritja e rritjes gjithëpërfshirëse, reduktimi i varfërisë dhe ndërtimi i një shoqërie paqësore dhe të qëndrueshme kërkon shfrytëzim të barabartë të talenteve dhe kapitalit njerëzor, dhe që, nga ana tjetër, kërkon që institucionet dhe autoritetet në të gjitha nivelet e qeverisjes në Kosovë ta konsiderojnë barazinë gjinore një pjesë integrale të të gjitha programeve, politikave dhe kornizave ligjore. Përkatësisht, kjo do të thotë se instrumentet e reja dhe relevante të tilla si VN(B)GJ po fillojnë të përfshihen në proceset e hartimit të politikave dhe legjislacionit duke ju mundësuar politikë-bërësve dhe akterëve të përfshirë për t'i kuptuar dallimet gjinore dhe për të përshtatur agjendën e politikave në përputhje me rrethanat. Aktiviteti i vazhdueshëm i përfshirjes së

VN(B)GJ si pjesë integrale e procesit të VNR të Kosovës, është një hap tutje në njohjen e rëndësisë së integritimit gjinor në të gjitha proceset e politikave në Kosovë.

Përveç kësaj, rritja e barazisë gjinore mbështetet në konsideratë të kujdesshme të dallimeve në jetën e grave dhe burrave dhe në pranimin se mund të nevojiten qasje të ndryshme për të prodhuar rezultate të barabarta. Qasja e VN(B)GJ sigurisht do të ndihmojë politikë-bërësit të krijojnë një të kuptuar më të thellë të grupeve të ndryshme shoqërore në Kosovë dhe të kenë një pasqyrë të realiteteve të ndryshme të grave dhe burrave (pasi që këto realitete rrjedhin jo vetëm nga gjinia por edhe nga mosha, raca, klasa, origjina kombëtare dhe etnike, orientimi seksual, aftësitë e kufizuara, gjuha dhe feja). Gjithashtu do t'u mundësojë autoriteteve të krijojnë politika që i marrin në konsideratë në të gjitha nivelet e qeverisjes. Kjo do të ndihmojë më tej në zhvendosjen e burimeve për të adresuar këto dallime dhe kështu duke krijuar mundësi më efektive dhe më të informuara për politikatat.

Duke pasur parasysh këtë lidhje me planifikimin strategjik dhe procesin e institucionalizimit të VNR, ky manual duhet të lexohet së bashku me Udhëzimet dhe Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve si dhe së bashku me kodet relevante të praktikave të ministrive relevante si një udhëzues gjithëpërfshirës për krijimin e politikave, strategjive, masave dhe programeve gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në dëshmi.

HAPAT E KONCEPT DOKUMENTIT	INFORMATA RELEVANTE PËR VN(B)GJ
Hapi 1: Përkufizimi i problemit	Hapi 1 Përcaktimi i qëllimit të politikës
Hapi 2: Vendosja/përshkrimi i qëllimeve dhe objektivave	Hapi 2 Kontrolli i relevancës gjinore
Hapi 3: Përcaktimi i opcioneve	Informacioni relevant nga Hapi 3 Analiza e ndjeshme gjinore dhe Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor
Hapi 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	Informacioni relevant nga Hapi 3 Analiza e ndjeshme gjinore dhe Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor
Hapi 5: Komunikimi dhe konsultimi	Si pjesë e Hapit 4 Peshimi i ndikimit gjinor
Hapi 6: Përzgjedhja dhe paraqitja e zgjidhjeve më të mira: duke krahasuar opcionet dhe ndikimet e tyre	Hapi 5 Gjetjet dhe propozimet
Hapi 7: Paraqitja e konkluzioneve dhe hapave të ardhshëm për Koncept Dokumentin	

Referenca në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve

Udhëzimet dhe Manuali për Hartimin e Koncept Dokumenteve për Qeverinë e Kosovës, përmendin pesë kategori ndikimesh potenciale përmes të cilat duhet të shqyrtohen veprimet e qeverisë:

1. **Ndikimet ekonomike:** ndikimet në biznese, në punonjës, në rritjen ekonomike, në investimet e huaja direkte, etj.;
2. **Ndikimet sociale:** ndikimet në arsim, pozicion social të nën-grupeve brenda shoqërisë, pensionet, etj.;
3. **Ndikimet mjedisore:** ndikimet në cilësinë e ajrit, ndotjen, nivelet e mbeturinave, cilësinë e ujit, etj.;
4. **Ndikimet ndër-sektoriale:** ndikimet në barazinë gjinore, të drejtat e qytetarëve, etj.; dhe
5. **Ndikimet e buxhetit:** ndikimet në të ardhurat dhe shpenzimet e Republikës së Kosovës.

Prandaj, përderisa procesi i vlerësimit të ndikimit të barazisë gjinore është dhe duhet të jetë një proces i pavarur, administrata e tanishme publike e Kosovës gjithashtu mund të përfshijë VN(B)GJ në procese ekzistuese:

- ❖ Vlerësimet e ndikimit strategjik rregullator
- ❖ Vlerësimet e ndikimit kulmulativ
- ❖ Vlerësimet e ndikimit ekonomik
- ❖ Analiza e efektivitetit të kostos dhe/ose Vlerësimet e ndikimit buxhetor


Udhëzimet dhe Manuali për Hartimin e Dokumenteve të Konceptit përcaktojnë 7 hapa në procesin e hartimit të dokumenteve konceptuale të strategjive, politikave, programeve dhe masave të reja.

Megjithëse qëllimi i qeverive duhet të jetë të zbatojë vetë VN(B)GJ gjithmonë si një mënyrë për të informuar gjithëpërfshirjen e proceseve të tyre të bërjes së politikave, është e këshillueshme që të fillohet zbatimi i VN(B)GJ në Kosovë në mënyrë të integruar duke pasur parasysh proceset e vazhdueshme të qeverisjes së mire.

ZBATIMI I VN(B)GJ NË KOSOVË

Për të treguar angazhim praktik në planifikimin e politikës për barazi gjinore, nëpunësit civilë të Kosovës që punojnë për zyrat qeveritare (në nivel kombëtar ose vendor), departamentet ose ministritë dhe që iniciojnë norma apo politika të reja duhet të përfshihen në procesin e vlerësimit të ndikimit të barazisë gjinore. Ky është modeli më gjithëpërfshirës për vlerësimin e ndikimit gjinor, dhe parasheh se shërbyesit civilë në kuadër të ministrive përkatëse janë personat përgjegjës për realizimin e saj.

Nëse është e nevojshme dhe nëse nuk ka njohuri brenda institucionit sa i përket barazisë gjinore dhe integritimit gjinor, rekomandohet kontraktimi i ekspertëve gjinorë jashtë sektorit publik. Në këtë model, Agjencia për Barazi Gjinore duhet ta përmbushë një rol mbështetës, duke u ofruar institucioneve përkatëse metoda, instrumente dhe rekomandime përkatëse gjatë procesit për të siguruar që vlerësimi i ndikimit të barazisë gjinore është i një cilësie të lartë. Agjencia për Barazi Gjinore gjithashtu ka një rol monitorues për të siguruar që vlerësimi i ndikimit gjinor është kryer për çdo rregullore përkatëse.



Nxitësit e programit/politikave Modeli i Njesisë - Modeli gjithëpërfshirës i VN(B)GJ-së


KAPITULLI 2: KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË MJETIT TË VN(B)GJ-SË

Ky kapitull i ofron politikë-bërësve një pasqyrë të fazave dhe hapave të VN(B)GJ-së dhe i prezanton ato tek elementët e ndryshëm të këtij mjeti të VN(B)GJ -së. Në këtë kapitull specifikohen pyetjet më relevante, megjithatë, shembujt e listës së kontrollit dhe shablloneve që përfshijnë hapat e ndryshëm të përmendura këtu e tutje, përfshihen në Shtojcën 1 të këtij manuali. Qëllimi është t'i ndihmohet politikë-bërësve në lansimin e VN(B)GJ-së dhe për t'i udhëzuar ata në përdorimin e mjetit në mënyrën më efektive.

Udhëzim hap pas hapi

Shumica e kornizave të VN(B)GJ-së, përfshijnë tre faza vlerësimi, të cilat nga ana tjetër përbëhen nga disa hapa individualë (siç përshkruhet në Figurën 4): së pari vjen vlerësimi i përkatësisë gjinore, pastaj vlerësimi i përgjithshëm i ndikimit dhe në fund monitorimi dhe vlerësimi. Për çdo hap, politikë-bërësit dhe praktikuesit duhet të synojnë të mbledhin dhe të analizojnë sa më shumë të dhëna që të jetë e mundshme për të qenë në gjendje t'i përgjigjen pyetjeve të renditura në forma specifike të dizajnuara për këtë hap. Informacioni i grumbulluar nga të gjitha format paraqet Vlerësimin e Plotë të Ndikimit Gjinor për atë sektor/politikë.

Tre fazat dhe pesë hapat e VNGJ-së



Fazat e VN(B)GJ-së

Faza I. Vlerësimi i Relevancës Gjinore

Kjo fazë e parë e VN(B)GJ-së konceptohet në mënyrë të tillë që mbështet politikë-bërësit në përcaktimin e qëllimit të politikës, strategjisë, ligjit apo programit të planifikuar (Hapi 1 - Përkufizimi i Qëllimit të Politikës, përkatësisht përcaktimi i qëllimit të politikës, ligjit apo programit). Për më tepër tregon ndërlidhjen me barazinë gjinore (Hapi 2 - Kontrolli i përkatësisë gjinore). Në parim, hapi i dytë ndihmon në vlerësimin dhe përshkrimin e situatës aktuale nëpërmjet grumbullimit të statistikave të ndara sipas gjinisë në dispozicion dhe nëpërmjet identifikimit të asaj që është e njohur rreth përvojave, situatave dhe roleve të ndryshme të burrave dhe grave nëpërmjet përdorimit të matjeve cilësore dhe sasore dhe si dhe sprovimin e grave dhe burrave të cilët kanë të ngjarë të preken nga prioritetet e politikave që ndiqen (grupet e punës, konsultimi me Agjencinë për Barazi Gjinore, ekspertët e jashtëm).

Në këtë fazë, autoriteteve u kërkohet t'i gjejnë dhe t'iu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- ❖ Cila çështje e barazisë gjinore po trajtohet nga kjo politikë/legjislacion/program/ndërhyrje?
- ❖ Pse kjo ndërhyrje po merret parasysh për këtë situatë?
- ❖ A synon ndërhyrja të kontribuojë në barazinë gjinore?
- ❖ Si synon kjo ndërhyrje të kontribuojë në barazinë gjinore?
- ❖ Cilat janë objektivat ekzistuese të barazisë gjinore në këtë fushë?
- ❖ Cilat janë treguesit specifik gjinorë, nëse ka ndonjë?

Hapi 1 Përkufizimi i Qëllimit të Politikës

Në thelb, hapi i parë i kësaj faze (Përkufizimi i Qëllimit të Politikës) synon t'i mundësojë ministrisë/institucionit/departamentit/njesisë të përkufizoj se çfarë po përpiqet të arrijë politika/ndërhyrja, si në aspektin e të kuptuarit të problemeve dhe shqetësimeve të ndryshme nga perspektiva gjinore ashtu edhe në drejtim të mundësisit të një kontributi të barabartë të masave të propozuara të politikave.

Kjo është një detyrë shumë e rëndësishme dhe sfiduese, dhe mund të jetë e nevojshme që ministria/institucioni/departamenti të konsultohen me raporte si dhe statistika zyrtare dhe administrative (konsultohuni me raporte të tilla si burrat dhe gratë në Kosovë, profile gjinore, raporti i barazisë gjinore në Kosovë). Institucionet dhe grupet punuese duhet të kërkojnë ekspertizën gjinore të Agjencisë për Barazi Gjinore dhe/ose të njerëzve me njohuri në fushën që po shqyrtohet (qoftë nga brenda ose jashtë shërbimit publik) kur dhe në qoftë se ata nuk mund të gjejnë informacionin e duhur dhe ekspertizën e brendshme për të ndihmuar në përgjigjen e disa prej pyetjeve të mëposhtme:

PËRCAKTIMI I QËLLIMIT TË POLITIKËS		
I.Relevanca Gjinore - Hapi 1	Titulli i politikës ose emri i programit	
	Emri i Ministrisë/Institucioni	
	Emri i Departamentit/Njësia	
	Drejtoria ose Agjencia	

Kuadri ligjor	
<i>Lista e Kontrollit 1 – Situata siç është</i>	
<p>Në fushën e politikës në shqyrtim, a ka dallime midis burrave dhe grave në organizimin gjinor të punës (brenda institucionit tuaj, por edhe brenda grupit të synuar të përfituesve në të cilët politika/koncepti juaj po ndikon)?</p> <p>⇒ A kanë gratë/burrat punë specifike në këtë sektor, a i përshtaten ato roleve specifike të gjinisë?</p> <p>⇒ A ka një hendek të dukshëm pagash në këtë sektor/a marrin gratë paga të pabarabarta??</p> <p>⇒ A ekziston presupozimi se njerëzit janë të liruar nga përgjegjësitë e kujdesit dhe si i tillë nuk ka asnjë kufizim për pjesëmarrjen e tyre??</p> <p>⇒ A janë marrë parasysh dallimet mes burrave dhe grave në grupe të ndryshme kulturore/komunitete të ndryshme?</p>	
<p>A ka dallime të rëndësishme në organizimin e marrëdhënieve relevante personale në këtë sektor/ose a mund të ndikojnë këto dallime në programin në fjalë në mënyrë negative/pozitive? Mendoni se si ndryshimet e propozuara të theksuara në Koncept Note (ndryshimet në ligj, ligji i ri, masa të reja) mund të ndryshojnë ose të ndikojnë pozitivisht/negativisht në dinamikën e kujdesit familjar ose normat ekzistuese)?</p> <p>⇒ Kush është kryesisht përgjegjës për kujdesin familjar? A ndryshon kjo për grupe të ndryshme (sociale, etnike)?</p> <p>⇒ A bënë politika një transformim të normave ekzistuese gjinore?</p>	

	<p>A ka një shpërndarje të pabarabartë të burimeve mes grave dhe burrave? (Kjo pyetje duhet të shqyrtohet me kujdes dhe të përqendrohet në shpërndarjen e burimeve të programit, si dhe burimet midis përfituesve - burrave dhe grave)</p>	
<p>Cilat rregulla gjinore ekzistojnë? (Për shembull, a u jepet roleve dhe aktiviteteve të grave/burrave në këtë sektor më pak vlerë?) Edhe nëse është për shembull fusha të tilla si minierat, ju lutemi referojuni roleve gjinore të përcaktuara - minierat nuk konsiderohen punë të përshtatshme për femra!)</p>		
<p>Si do ta vlerësonit situatën aktuale në sektorin/fushën e politikave sa i përket:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Barazisë? ⇒ Autonomisë/decentralizimit fiskal/përgjegjësisë për ofrimin e shërbimeve? ⇒ Diversiteti (ekonomi/grupe të ndryshme/përfshirja sociale/mosha, etj.?) 		
<p>A keni të dhëna për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve? *Ku mund të gjenden të dhënat (Statistikat, të dhënat administrative, sondazhet...)</p>		
Lista e Kontrollit-2 – Situata që do të jetë		
<p>A është plani për të krijuar një politikë/program të ri apo për të bërë ndryshime në një politikë?</p>		
<p>Përshkrim i shkurtër i politikës / programit të propozuar (ose të ndryshimeve që duhet të bëhen në një politikë) - theksoni rëndësinë gjinore të atyre!!</p>		
<p>Cili rezultat(e) të barazisë gjinore i kontribuon politikat/programi i propozuar (ose ndryshimet që duhet të bëhen në një politikë)?</p>		
<p>Cila është politika/programi i</p>		

	propozuar (ose ndryshimet që duhen bërë në politikë) që përpiqen të arrijnë? (<u>Qëllimet-nga perspektiva e barazisë gjinore</u>)	
	A përputhen qëllimet dhe rezultatet e politikës / programit të propozuar (ose ndryshimet që duhen bërë në politikë) me promovimin e barazisë gjinore ?	
<i>Bërë nga [emri (at) dhe funksioni (et)]</i>		

* Mund të jetë e nevojshme të grumbullohen statistika të zbërthyera gjinore, të përdoren matjet cilësore dhe sasore dhe të konsultohen me gratë dhe burrat të cilët ka të ngjarë të preken nga politika (grupet punuese, kontributi i ekspertëve të jashtëm)

Mbani mend → Pyetjet lidhur me barazinë gjinore nuk parashtrohen vetëm për gratë: barazia gjinore shihet si proces, jo si kategori!!!

Gjinia theksohet në dokumentet e aplikimit për financim, dokumentet e projektimit të programit, trajnimet për faqet e internetit, raportet vjetore dhe kështu me radhë. Por shumë shpesh, përdoret si sinonim për punën me gratë. Kjo prapë bie në kundërshtim me nocionin e gjinisë, në kundërshtim me dallimin biologjik të seksit. Padrejtësia dhe pabarazia nuk janë të shkruar në kromozomet tona. Nëse flasim për gjininë si “burra” dhe “gra”, ne mbetemi në atë që Connell (2012: 1676 dhe 1681) e quan “të menduarit kategorik”¹¹.

Connell argumenton se të mbështeturit mbi këtë mënyrë të të menduarit, e pengon punën efektive mbi “shkaqet themelore” të pabarazisë: “Mendimi kategorik nuk ka një mënyrë për të konceptuar dinamikën e gjinisë: domethënë, proceset historike në vetë gjininë, mënyrën se si janë krijuar rregullat gjinore dhe se si janë krijuar dhe sfiduar pabarazitë gjinore ... nuk mund të mbështetemi më gjatë në të menduarit kategorik nëse duam të kuptojmë proceset aktuale gjinore që ndikojnë në shëndetin [ose varfërinë], mjedisin e komplikuar shoqëror në të cilin dalin si dhe urgjenca e trajtimit të këtyre çështjeve/problemeve.

Duke u ndalur tek stereotipat, normat dhe gjykimet lidhur me mashkulloritetin dhe feminitetin (në vend se të thuhet meshkujt / femrat) na lejon të mendojmë për proceset përmes të cilave disa forma të feminitetit dhe mashkulloritetit u jepet vlerë më e madhe se format e tjera (me forma të mashkulloritetit dominues zakonisht duke pasur qasje më të madhe në pushtet dhe burime).

¹¹ Cornwall, A. et al. (2008) ‘Reclaiming Feminism: Gender and Neoliberalism’ (‘Rivendosja e Feminizmit: Gjinia dhe Neoliberalizmi’). Në Buletin IDS 39(6). I disponueshëm nga: www.ids.ac.uk/files/dmfile/bull39.6intro3.pdf (qasja e fundit më 18 qershor 2018).

Hapi 2. Vlerësimi i Relevancës Gjinore



PYETJET KRYESORE PËR T'U TRAJTUAR NË VLERËSIMIN E RELEVANCËS GJINORE

Cila çështje e barazisë gjinore është duke u trajtuar nga kjo politikë / legjislacion / program / intervenim?	Pse kjo ndërhyrje po merret parasysh për këtë situatë?	A ka për qëllim intervenimi të kontribuojë në barazinë gjinore?	Si ka për qëllim kjo ndërhyrje të kontribuojë në barazinë gjinore?	Cilat janë objektivat ekzistues të barazisë gjinore në këtë fushë?	Cilët janë treguesit specifik gjinorë, nëse ka ndonjë?
--	---	--	---	---	---

Për të vendosur nëse një politikë, program, strategji është e rëndësishme për gjininë, duhet të zbatohet Hapi 2 Vlerësimi i Relevancës Gjinore. Vlerësimi mund të bazohet në shqyrtimin e politikës së propozuar duke përdorur katër kriteret e renditura më poshtë:

Informatat mbështetëse

Kjo përfshin informatat që përmbajnë:

- Përshkrimin e objektivave të politikave të propozuara,
- Përshkrimin e grupit të targetuar të politikës së propozuar,
- Informata se mbi kë mund të ndikoj potencialisht,

Përfituesit e drejtpërdrejtë

Kjo përfshin shqyrtimin e përfituesve të drejtpërdrejt të politikës dhe programit. Këtu përfshihen individë të cilët i synon politika/programi/strategjia. Kjo analizë ndriçuese duhet të zërthehet më tutje sipas gjinisë në:

- Pjesëmarrje
- Burime
- Norma dhe Vlera
- Të drejtat

(Vini re: nëse nuk ekzistojnë statistika gjinore në lidhje me këto segmente, atëherë duhet të ndërmerret VN(B)GJ për të kuptuar më mirë dhe më thellësisht ndikimin gjinor të politikës / programit / strategjisë)

Përfituesit indirekte

Kjo përfshin analizimin e përfituesve indirekt, konkretisht individëve të cilët edhe pse politika nuk i targeton drejtpërdrejt, mund të ndikohet nga zbatimi i saj. Këtu mund të përfshihen individët si të afërmit e përfituesve të drejtpërdrejtë ose qytetet fqinje.

Vlerësimi

Kjo është faza përfundimtare e fazës së vlerësimit të relevancës gjinore dhe përfshin një vlerësim të informacionit të grumbulluar për tre kriteret e renditura më lartë. Kjo bëhet për të vlerësuar nëse kërkohet VN(B)GJ e plotë. Kjo fazë kërkon një gjykim i cili bazohet në potencial, qoftë gjithëpërfshirës apo minimal.

Është e rëndësishme të kihet parasysh se një tregues i relevancës gjinore mjafton që VN(B)GJ të realizohet.

KONTROLLI I RELEVANCËS GJINORE		
I. Përkatesia Gjinore - Hapi 2	Titulli i Politikave ose Emri i Programit	
	Emri i Ministrisë / Institucionit	
	Emri i Departamentit / Njesisë	
	Drejtoria ose Agjencia	
	Korniza Ligjore	
	<i>Informacioni përmbledhës</i>	
	Përshkrimi i politikës / programit të propozuar (ose të ndryshimeve që duhet të bëhen në një politikë) dhe të objektivave të saj	
	Përshkrimi i grupit/grupeve të synuara të politikës / programit të propozuar	
	Informacion se për kë mund të ketë ndikim potencialisht politika / programi i propozuar	
	<i>Përfituesit e drejtpërdrejtë</i>	
	Pjesëmarrja sipas gjinisë	
	Burimet sipas gjinisë	
	Normat dhe Vlerat sipas gjinisë	
	Të drejtat sipas gjinisë	
	<i>Përfituesit indirekt</i>	
A ka përfitues indirekt të politikës / programit të propozuar (p.sh. të afërmit e përfituesve të drejtpërdrejtë, qytetet fqinje, ...)?		
Si do të ndikohet secili grup i përfituesve indirekt nga politika / programi i propozuar?		

<p>⇒ Ndikim pozitiv ⇒ Ndikim negativ</p>	
Vlerësimi	
<p>A ka ndonjë indikacion apo dëshmi të pjesëmarrjes së lartë apo të ulët apo pranueshmëri nga grupe të ndryshme? (Shkalla e lartë, e mesme ose e ulët e ndikimit)</p>	
<p>A ka ndonjë indikacion apo dëshmi që grupet e ndryshme kanë nevoja, përvoja, çështje dhe prioritete të ndryshme në lidhje me politikën / programin e propozuar? ('Shkalla e lartë, e mesme ose e ulët e ndikimit)</p>	
<p>A kanë treguar konsultimet paraprake me grupet, organizatat ose individët përkatës, që politikat e veçanta krijojnë probleme që janë specifike për ata? ('Shkalla e lartë, e mesme ose e ulët e ndikimit)</p>	
<p>A ka ndonjë mundësi për të promovuar më mirë barazinë e mundësive apo marrëdhëniet të mira duke ndryshuar politikën / programin e propozuar?</p>	
Përfundimi	
<p>Cili është përfundimi? *</p> <p>⇒ Arsyetim ⇒ Problemet kryesore, nëse ka ⇒ Grupet në të cilat duhet të fokusohemi, nëse ka</p>	
Përgatitur nga [emri (at) dhe funksioni (et)]	

* Ose nuk ka asnjë ndryshim në politikat, funksionet ose shërbimet (p.sh., raporti 'vetëm për informacion') apo VN(B)GJ përkatëse e kohës së fundit është kryer tashmë ose duket qartë se nuk ka relevancë për barazinë ose kërkohet vlerësimi i plotë i ndikimit

SHËNIM PËR SKEDAR

Megjithëse në parim, të gjitha detyrat duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të integritimit gjinor, politikëbërësit/njësitë përgjegjëse duhet të përfundojnë Fazën I të VN(B)GJ si një test i shkurtër dhe të vlerësojnë nëse është e rëndësishme të bëhet vlerësim i plotë dhe gjithëpërfshirës i integritimit gjinor të detyrave që do t'i kryeni.

Testi

1. Fillimisht, identifikoni se në **kë** do të ndikojë detyra.
2. Brenda fushëveprimit të detyrës, shqyrtoni nëse ekzistojnë **dallime** për burrat dhe gratë:
 - ⇒ Kushtet
 - ⇒ Sjellje
 - ⇒ Preferencat, nevojat dhe mundësitë
3. Shqyrtoni nëse plotësimi i politikës / programit mund të ketë **pasoja të ndryshme** për gratë dhe burrat, si dhe për vajzat dhe djemtë. (p.sh. qasja në arsim, tregun e punës, pushimi, pensioni, pagat, taksat, jeta sociale, strehimi, shëndeti, siguria ose të ngjashme.)

Rezultati A. Nëse ekzistojnë dallime për gjinitë për të paktën një nga çështjet, është e rëndësishme të kryhet një vlerësimi i integritimit gjinor.

Rezultati B. Nëse nuk vëreni dallime gjinore në fushën në të cilën duhet të kryeni detyrën tuaj, nuk është e rëndësishme të bëhet vlerësimi i integritimit gjinor.

Sigurimi i të Dhënave të Nevojshme

Për t'iu përgjigjur pyetjeve në testin e relevancës mund të nevojiten shifra dhe të dhëna.

Përdorni të dhëna dhe statistika për të fituar njohuri sa i përket:

- Shpërndarjes gjinore brenda zonës ku jeni duke punuar.
- Dallimet gjinore në modelet e sjelljes, siç është përfundimi i një programi arsimor, gjobat, anëtarësimi në një klub sportiv, pensionimi i parakohshëm, jetesa në shtëpitë e banuara nga pronarët.
- Efekteve të iniciativave të mëparshme në zonë për burrat, gratë, vajzat dhe djemtë.

Për të realizuar VN(B)GJ, **të dhënat e ndara sipas seksit dhe aftësia për aplikimin e analizës së ndjeshme gjinore në të dhënat e grumbulluara janë të rëndësishme.**

Kjo mund të përfshijë realizimin e anketave/studimeve të reja për grumbullimin e të dhënave të nevojshme, ose në disa raste vetëm një aplikim tjetër të analizës së ndjeshme gjinore ndaj të dhënave që tashmë janë grumbulluar për qëllime të tjera.

Gjithashtu mund të përfshijë konsultime me palë të ndryshme të interesuara dhe të dyja gjinitë në komunitetin ku do të zbatohet politika.

Në disa raste, kjo mund të kërkojë organizimin e strategjive kërkimore me pjesëmarrje për grumbullimin e të dhënave mbi ndikimin gjinor të politikës.

VN(B)GJ-ja për një politik/ligj/vendim nuk ka nevojë të kryhet nëse zbatohet një nga opsionet e mëposhtme:

a. Nuk ka ndryshim në politika, funksione apo shërbime

Vendimi nuk ka të bëjë me një “politikë, shërbim apo funksion të propozuar të ri ose të ndryshuar”, nuk përmban propozime për ristrukturimin e fuqisë punëtore dhe nuk është vendim financiar që do të ndikojë mbi shërbimet.

Një shembull mund të jetë raporti “Vetëm për informim”. Nëse kjo notë e përcjell zhvillimin e një politike ose shërbimi të ri ose ndryshimin e këtyre të fundit, pritja është që VN(B)GJ do të ketë ndodhur në një fazë më të hershme (për shembull për vendimet e marra në nivelin e menaxhimit të departamenteve).

b. VN(B)GJ relevante e kohëve të fundit tashmë është kryer

Çështja tashmë i është nënshtruar ose është një veprim që del nga një vlerësim i kohës së fundit i ndikimit të barazisë dhe se VN(B)GJ ka konsideruar siç duhet çështjet që janë relevante për këtë vendim.

c. Duket qartë se nuk ka relevancë për barazinë

Çështja duket qartë se nuk ka relevancë për barazinë (të keni parasysh se shumë çështje që në pamje duket të mos kenë ndonjë relevancë të dukshme mund të kenë ndikime të fshehura).

Si shembull mund të jetë (megjithëse çështjet e rëndësishme të barazisë duhet të merren parasysh) një raport, i cili është përditësim mbi zbatimin e një strategjie që fillimisht i ishte nënshtruar një VN(B)GJ (edhe pse do të ishte praktikë e mirë të përditësohej VN(B)GJ origjinale dhe të konfirmohet se veprimet që vlerësimi ka vënë në dukje janë kryer).

Sa i përket procesit të hartimit të një Koncept Dokumenti, informatat e grumbulluara nëpërmjet këtij hapi do të përdoren për të informuar Vlerësimin e Ndikimit Rregullativ

Hapin 1 Përkufizimi i problemit; Hapin 2 Përcaktimi/përshkrimi i qëllimeve dhe objektivave dhe Hapin 3 Përcaktimi i opsioneve¹².

Faza II. Vlerësimi i Ndikimit Gjinator

Faza e dytë e zbatimit të VN(B)GJ përfshin Hapin 3 - Analizën e ndjeshme gjinore dhe Hapin 4 – Peshimi i ndikimit gjinator. Këta hapa janë të nevojshëm për të mbështetur politikëbërësit në përshtatjen e politikave në veçanti në drejtim të arritjes së qëllimeve të barazisë gjinore dhe zhvillimit

¹² Për më shumë informacione të hollësishme mbi lidhjet midis Udhëzimeve dhe Manualit për Hartimin e Koncept Dokumenteve dhe fazat e VN(B)GJ, shih Kapitullin 3: Si ndikon VN(B)GJ në Koncept Dokumentin dhe Vlerësimet e Tjera të Ndikimit (faqe 33)

dhe rritjes së barabartë, si dhe për të ndihmuar ata që të përcaktojnë prioritetin që duhet t'i bashkëngjitet adoptimit të politikave që promovojnë në mënyrë aktive barazinë gjinore. Bazuar në gjetjet e grumbulluara në Fazën I Vlerësimi i relevancës gjinore, politikëbërësit duhet që në këtë fazë të dytë të vlerësojnë ndikimet (pozitive dhe negative) të ndërhyrjeve/politikave të propozuara, të marrin

ANALIZA E NDJESHME GJINORE DUHET T'I PËRGJIGJET NGA SE VIJON:

në konsideratë opsionet e

ndryshme dhe të peshojnë ndikimin e tyre në grupin (et) e synuara.

A ka prova në lidhje me natyrën e problemit?

Si do të ndikojë tek gratë dhe burrat?

Kush do të ndikohet?

Si mund të zgjidhet problemi?

Kush mund ta zgjidhë problemin?

Kjo fazë përfshin grumbullimin e të dhënave të plota të ndara sipas seksit të cilat duhet të përdoren si informacion bazë për vlerësimin e ndikimit të mundshëm gjinor. Të dhënat duhet të përfshijnë informacion në lidhje me statusin aktual, rolet dhe marrëdhëniet.

Është e rëndësishme që këto të dhëna të ndahen më tej dhe përfshijnë informata shtesë të tilla si mosha, feja, niveli i shkollimit, statusi martesor dhe kështu me radhë. Të rikujtojmë, konsultimi konsiderohet të jetë një element shumë i rëndësishëm gjatë kryerjes së kësaj faze të VN(B)GJ pasi kjo do të sigurojë që të dëgjohen pikëpamjet e atyre që ndikohen nga politika e propozuar, qoftë direkt apo indirekt.

Hapi 3. Analiza e ndjeshme gjinore

Ky hap është i nevojshëm për vlerësimin e trendëve gjinore në mjedisin aktual, për të cilat duhet mbledhur dhe analizuar më shumë informacion. Kjo mund të përfshijë trendët demografike, ekonomike, kulturore ose informacionin mbi ligjet dhe politikat. Në këtë rast, një instrument i Analizës Gjinore përdoret për të grumbulluar informacione lidhur me rolet dhe relacionet gjinore dhe ofron një mënyrë të strukturuar për mbledhjen e informacionit gjinor duke tubuar së bashku informacion në lidhje me:

- **Rolet dhe Përgjegjësitë** e grave dhe burrave (brenda sektorit)
- **Asetet dhe Burimet** me të cilat kanë të bëjnë gratë dhe burrat (lidhur me politikën e propozuar),
- **Pushtetin dhe Vendimmarrjen** ku gratë dhe burrat marrin pjesë në nivele të ndryshme (si familja, komuniteti, karriera)
- **Nevojat, Prioritetet dhe Perspektivat** e grave dhe burrave

ANALIZA E NDJESHME GJINORE KA PËR QËLLIM

01

Identifikimin e çështjeve kyçe gjinore dhe përcaktuesit që lidhen drejtpërsëdrejti me shërbimet e synuara që do të ofrohen nga politika / strategjia / projekti,

02

Informimin e hartimit të projekteve që janë përfshirëse të gjinisë duke identifikuar mundësitë për maksimizimin e përfitimeve gjinore dhe minimizimin dhe zbutjen e ndikimeve apo rreziqeve negative gjinore përmes politikës/strategjisë/projektit të propozuar; dhe

03

Grumbullimin e të dhënave bazë të ndara sipas seksit që do të përdoren për monitorimin e outputeve, rezultateve dhe ndikimeve të projektit gjatë zbatimit të projektit

Nëse një politike/intervenim i është përshkruar relevancë gjinore në fazën konceptuale, atëherë kërkohet (një analizë e hollësishme gjinore, shpesh si një analizë e pavarur ose si pjesë e vlerësimit të ndikimit të varfërisë dhe ndikimit social, vlerësimit të ndikimit mjedisor ose ekonomik/buxhetor) për të përcaktuar ndikimin (rezultatet e ndjeshme) që ndërhyrja mund të ketë në barazinë efektive të grave dhe burrave. Një analizë e tillë duhet të përqipet të vlerësoj situatën aktuale për grupet në fjalë, të vlerësoj se si mund të evoluojë pa ndërhyrje publike dhe të masë se si intervenimi i planifikuar pritet të ndryshoj gjendjen aktuale. Në të njëjtën kohë, në këtë fazë të analizës, duhet të matet, sa më shumë që të jetë e mundur, se si ndërhyrja e planifikuar pritet të ndryshojë gjendjen ekzistuese, duke përdorur të gjitha të dhënat e disponueshme për burrat dhe gratë në zonat e prekura nga politika dhe/ose legjislacioni i planifikuar (të dhënat cilësore dhe sasiore, administrative dhe/ose hulumtuese të mbledhura nga komuniteti akademik, etj.¹³).

Një VN(B)GJ e plotë e politikës, strategjisë ose projektit do të përmbajë një analizë të:

1. Dallimeve mes grave dhe burrave në zonën (at) e ndikimit në sektorin që është duke u analizuar.
2. Mënyrave në të cilat politika, programi ose projekti mund të **kontribuojë në eliminimin e pabarazive ekzistuese dhe të nxisë barazinë ndërmjet grave dhe burrave**; p.sh:
 - në normat e pjesëmarrjes,
 - në ndarjen e burimeve, përfitimeve, detyrave dhe përgjegjësisë në jetën private dhe publike,
 - në vlerën dhe vëmendjen e akorduar për meshkujt dhe femrat, për karakteristikat (stereotipet) e mashkulloritetit dhe feminitetit sielliet dhe prioritetet?

¹³ Gjatë përdorimit të statistikave të grumbulluara nga akterë të jashtëm, metodologjitë e tyre kërkimore duhet të shqyrtohen plotësisht për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre përpara çdo përdorimi ose referimi të mëtejshëm.

FUSHAT E ANALIZËS GJINORE



Dallimet në mes të grave dhe burrave në zonën(at) e ndikimit që janë duke u analizuar, siç janë pjesëmarrja, burimet, normat dhe vlerat, si dhe të drejtat



Normat dhe vlerat: të cilat ndikojnë në rolet gjinore, ndarjen e punës sipas gjinisë, qëndrimet dhe sjelljet e grave dhe burrave respektivisht dhe pabarazitë në vlerën e atribuar burrave dhe grave apo karakteristikave (stereotipeve) të mashkulloritetit dhe feminitetit);



Burimet: shpërndarja e burimeve të rëndësishme siç si koha, hapësira, informacioni dhe paraja, fuqia politike dhe ekonomike, arsimit dhe trajnimit, puna dhe karriera profesionale, teknologjitë e reja, shërbimet shëndetësore, strehimi, mjetet e transporti, koha e lirë;



Pjesëmarrja: përbërja e grupit (ve) të synuara/të popullsisë sipas seksit, përfaqësimi i grave dhe burrave në pozita vendim-marrëse);



Të drejtat: që kanë të bëjnë me diskriminimin seksual të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të drejtat e njeriut (duke përfshirë lirinë nga dhuna seksuale dhe degradimi) dhe me qasjen në drejtësi, në mjedisin ligjor, politik ose socio-ekonomik;

Edhe pse kjo fazë e procesit mbështetet në masë të madhe në grumbullimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për sigurimin e dëshmive mbi ndryshimet/rregullimet e nevojshme të politikave/strategjive/programeve të propozuara, është po aq e rëndësishme të merren parasysh pikëpamjet e atyre që janë të prekur (kryesisht grupet që janë të synuara direkt) dhe të merren përgjigjet në pyetjet e mëposhtme kryesore:

- Cilat janë pritjet dhe nevojat e tyre?
- A janë këto të ndryshme për gratë dhe burrat?
- A adreson intervenimi i planifikuar nevojat edhe të grave edhe të burrave, duke marrë parasysh interesat, rolet dhe pozicionet e tyre të ndryshme?
- Si mund të forcohet kontributi ndaj nevojave të grave dhe burrave?
- Konsideroni pabarazitë mes grave dhe burrave në aspektin e qasjes në burime (punë, para, pushtet, shëndet, mirëqenie, siguri, njohuri/arsim, mobilitet, kohë, etj.) dhe në ushtrimin e të drejtave themelore (civile, sociale dhe të drejtat politike) bazuar në seksin e tyre ose për shkak të roleve që u atribuohen grave dhe burrave (rolet gjinore).

ANALIZA NDJESHMËRISË GJINORE *		
II. Vlerësimi i Ndikimit Gjinator - Hapi 3	Titulli i Politikave ose Emri i Programit	
	Emri i Ministrisë / Institucionit	
	Emri i Departamentit / Njesisë	
	Drejtoria ose Agjencia	
	Korniza Ligjore (përfshirë kornizën ligjor përkatëse për barazinë gjinore)	
	<i>Caktimi i përmasës së ndikimit**</i>	
	A ekzistojnë dëshmi për natyrën e problemit nga perspektiva gjinore? Ku mund të gjenden këto dëshmi (raportet, dokumentet për diskutim qeveritar, etj.?	
	Cili është ndikimi i mundshëm i politikës në barazinë gjinore? (Pozitiv/Negativ/Neutral)	
	Nëse ka ndikim: ⇒ Si do të ndikojë politika/programi i propozuar në gratë dhe burrat? (radhitni ndikimet kryesore në grupe të ndryshme) ⇒ Kush do të ndikohet? (sipas ndikimit kryesor) – Në mënyrë të drejtpërdrejt (informata mbi përfituesit e drejtpërdrejtë nga grupe të ndryshme- nëse aplikohet) – Në mënyrë të tërthortë (informata mbi përfituesit e tërthortë nga grupe të ndryshme-nëse aplikohet) ⇒ Përmbledhje e dëshmive (sipas ndikimit kryesor) - ofroni statistika nëse janë në dispozicion dhe tregoni burimin e tyre	
	<i>Mundësitë për të nxitur ndikim pozitiv në barazinë gjinore</i>	
Nëse nuk ka ndonjë ndikim, a ekzistojnë mundësi për të zhvilluar politikën në mënyrë që të nxitë një ndikim pozitiv apo politika transformuese gjinore (a mund të jetë transformuese në drejtim të hapjes së llojeve të reja të vendeve të		

punës në këtë sektor për burrat / gratë, ndryshim të normave?		
<i>Shqyrtimi i dëshmime</i>		
	<i>Përmbledhje e shkurtër e dëshmime</i>	<i>Dëshmitë mbështetëse (lista e dëshmime Cilësore dhe Sasiore)***</i>
<p>Cilat janë dallimet gjinore në këtë çështje? Merrni parasysh ndikimet diferenciale të politikës së propozuar për gratë dhe burrat dhe identifikoni pasojat mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Rolet dhe përgjegjësitë e grave dhe burrave (brenda sektorit) ⇒ Asetet dhe burimet me të cilat merren gratë dhe burrat (lidhur me politikat e propozuara) ⇒ Fuqia dhe vendimmarrja në të cilën marrin pjesë gratë dhe burrat, në nivele të ndryshme (të tilla si familja, komuniteti, karriera) ⇒ Nevojat, prioritetet dhe perspektivat e grave dhe burrave 		
<p>Cilët janë faktorët ndikues social, kulturor, ekonomik dhe politik? Identifikoni dallimet mes burrave dhe grave, në fushën(at) e ndikimit në bazë të analizave, në aspektin e:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pjesëmarrjes (përfaqësimi i grave dhe burrave në pozita vendimmarrëse, përbërja gjinore e grupit(eve) të synuar(a), ...) ⇒ Burimet (koha, hapësira, informacioni, fuqia politike dhe ekonomike, arsimi dhe trajnimi, puna, teknologjitë e reja, shërbimet e kujdesit shëndetësor, strehimi, gatishmëria, ...) ⇒ Normat dhe vlerat (rolet, qëndrimet dhe sjelljet e grave dhe burrave përkatësisht, pabarazitë në vlerën e burrave dhe grave, stereotipat, ...) ⇒ Ndarja e punës sipas gjinisë ⇒ Organizimi i jetës private si relevante për barazinë gjinore brenda sektorit ⇒ Organizimi i shtetësisë (pjesëmarrja relevante e burrave/grave në shoqata, sindikata, etj.) 		

	<p>⇒ Të drejtat themelore (të drejtat civile, sociale, politike dhe të drejtat e njeriut, diskriminimi gjinor i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, qasja në drejtësi, ...)</p>		
	<p>Çfarë politika/legjislacione ekzistojnë në këtë fushë? A reflektojnë ato në dëshmitë gjinore që keni identifikuar?</p>		
	<p>A ka pasur ndonjë ndryshim reagues gjinor në këtë fushë? Nëse po:</p> <p>⇒ Cilat janë ato?</p> <p>⇒ Si kanë ndodhur këto ndryshime, çfarë i ka shkaktuar ato (programet e reja, legjislacionet, buxhetet)?</p>		
	<p>A kanë bërë ato ndonjë ndryshim të matshëm për përvojat e burrave të grave deri më sot? Nëse jo:</p> <p>⇒ Pse jo?</p> <p>⇒ A nuk ka pasur lobim/përkrahje?</p> <p>⇒ A nuk kanë qenë efektive metodat e lobimit?</p> <p>⇒ A janë identifikuar pengesa tjera?</p>		
	<p>A i adreson politika e propozuar nevojat e grave dhe burrave, duke marrë parasysh interesat, rolet dhe pozicionet e tyre të ndryshme?</p> <p>Identifikoni mundësitë për mbështetjen e nevojave praktike dhe interesave strategjike të grave, për të kontribuar në eliminimin e pabarazive ekzistuese dhe për të promovuar barazinë ndërmjet grave dhe burrave:</p> <p>⇒ Në norma të pjesëmarrjes</p> <p>⇒ Në shpërndarjen e burimeve, përfitimeve, detyrave dhe përgjegjësisive në jetën private dhe publike</p> <p>⇒ Në vlerën dhe vëmendjen e akorduar për karakteristikat mashkullore dhe femërore, sjelljet dhe prioritetet</p>		
	<p>A do të promovojë politika/programi i propozuar:</p> <p>⇒ Barazi të mundësive</p>		


⇒ Si?		
<i>Përmirësimet e sugjeruara, Shqyrtimi i masave lehtësuese dhe/ose alternativave të politikave</i>		
Nëse është identifikuar ndonjë ndikim negativ, çfarë masash mund të ndërmerren për të zvogëluar ndikimin negativ të politikës?		
Nëse është identifikuar ndonjë ndikim pozitiv, çfarë masash mund të ndërmerren për të rritur ndikimin pozitiv të politikës?		
<i>Përgatitur nga [emri (emrat) dhe funksioni (funksionet)]</i>		

* Ky hap mbështetet në masë të madhe në mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Po aq e rëndësishme është të merren parasysh pikëpamjet e atyre që janë të interesuar (kryesisht, por jo vetëm, grupet e synuara) përmes anketimeve, konsultimeve në grupe, intervistave,

** Përmbledhje e të gjitha informatave të mbledhura në Hapin 1. Të dhënat duhet të përfshijnë informacione lidhur me statusin aktual, rolet dhe marrëdhëniet, moshën, fenë, nivelin e arsimit, statusin martesor,

***Sigurohuni që të tregoni nëse provat vijnë nga një burim me një 'interes të përfshirë' në këtë çështje?

FUSHAT E ANALIZËS GJINORE



Këto ndryshime mund të mos jenë të menjëhershme. Le të marrim, për shembull, një Koncept Notën mbi hartimin e një ligji apo një mase të re - ndikimi i procesit të hartimit nuk është fokusi i kësaj analize, por ndikimi i neneve të reja të propozuar, etj. Prandaj, çështjet që duam të analizojmë janë se si dhe në çfarë mase do të ndryshojnë jetët e grave dhe burrave si rezultat i këtij ligji të ri të propozuar/masave të reja të propozuara?

SHËNIM PËR SKEDARIN

Për t'i adresuar këto pyetje, autoritetet duhet të marrin në konsideratë normat dhe vlerat që rregullojnë procesin e qasjes dhe kontrollin e burimeve. Kjo ka të bëjë me mundësitë për të marrë pjesë në kushte të barabarta në të gjitha aspektet e shoqërisë:

❖ Ndarja e punës sipas gjinisë

Strukturat të cilat organizojnë ndarjen e punës rregullojnë shpërndarjen e punës sipas normave dhe vlerave mbizotëruese në fushën e punës. Kjo ka të bëjë me shpërndarjen e punës së paguar dhe të papaguar dhe me ndarjen gjinore horizontale dhe vertikale të tregut të punës. Dallimet zbatohen për grupe të ndryshme të grave dhe burrave, sipas moshës, përkatësisë etnike, nivelit të arsimit, klasës shoqërore, vlefshmërisë dhe kritere tjera të ndryshme.

❖ Organizimi i jetës private

Struktura e organizimit të jetës private rregullohet nga një sërë normash dhe vlerash në fushën e rregullimeve të jetesës, seksualitetit dhe riprodhimit, marrëdhënieve midis grave dhe burrave, midis të rriturve dhe fëmijëve. Gratë dhe burrat kanë pozita të ndryshme në këtë fushë. Amësia dhe atësia përbëjnë role të ndryshme dhe vlerësohen ndryshe. Këto dallime kanë pasoja në pozitën e grave dhe burrave në jetën shoqërore. Pabarazitë gjinore mund të përforcohen ose sfidohen nga kritere specifike kulturore, etnike, fetare, të lidhura me moshën dhe kritere tjera të ndryshme.


❖ Organizimi i shtetësisë

Struktura e organizimit të shtetësisë i referohet normave dhe vlerave që rregullojnë procesin e kontrollit dhe vendimmarrjes. Bëhet fjalë për mundësitë për pjesëmarrje në kushte të barabarta në të gjitha aspektet e shoqërisë. Mediat janë pjesë e rëndësishme e kësaj strukture, si dhe strukturave vendimmarrëse të organeve politike, bordeve dhe komisioneve.

Hapi 4. Peshimi i ndikimit gjinor

Pas përfundimit të vlerësimit të ndikimeve, Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor, do të ndihmojë në përcaktimin e prioritetit që duhet bashkangjitur politikave miratuese (ato që promovojnë në mënyrë aktive barazinë gjinore) dhe do të përcaktojë nëse nevojiten qasje ose veprime të politikave specifike për të siguruar që grupet specifike brenda grupeve të burrave dhe grave, përfitojnë nga ndërhyrja e propozuar e politikave.

PESHIMI I NDIKIMIT GJINOR



Ky hap ka të bëjë me fillimin e procesit të prioritizimit të ndikimeve, peshimin e ndikimit gjinor, hartimit të rekomandimeve dhe prioritizimi i tyre bazuar në rëndësinë e ndikimeve pozitive dhe negative dhe probabilitetit të shfaqjes së tyre. Kriteret për prioritizim varen nga rrethanat specifike të vlerësimeve individuale të ndikimit, ose nga prioritetet e ndryshme të qeverisë në nivele të ndryshme. Së fundi, duhet të theksohet se mundësia për peshim të efekteve të një politike/programi të propozuar kryesisht varet nga cilësia e informatave të mbledhura gjatë fazave të hershme të vlerësimit të ndikimit gjinor. Sa më shumë informata të janë marrë, aq më mirë vlerësohen efektet e pritura.

Ka disa nën-hapa për peshimin e ndikimit gjinor:

Së pari, pala/ët e interesuara duhet të realizojnë një vlerësim gjithëpërfshirës të ndikimit - Tabela 4A, pas kësaj, duke përdorur informatat nga Tabela 4A ata duhet të provojnë prioritizimit e ndikimeve duke identifikuar rëndësinë e ndikimit dhe probabilitetin që ky ndikim të ndodhë - Tabela 4B. Pastaj, ata duhet të identifikojnë ndikimet pozitive dhe ato negative Tabela 4C. Së fundmi, në nën-hapin e fundit ata duhet të përcaktojnë prioritetin që duhet bashkangjitur miratimit të politikave që promovojnë në mënyrë aktive barazinë gjinore dhe të përcaktoj nëse qasja ose veprime specifike të politikave nevojiten për të siguruar që grupe specifike (brenda grupeve të burrave dhe grave) përfitojnë nga ndërhyrja e propozuar e politikave- Tabela 4D.

4A. Vlerësimi gjithëpërfshirës i ndikimeve

Në këtë hap, është e rëndësishme të përcaktohet se si masa politike ose legislative do të kontribuojë në barazinë gjinore dhe të vlerësojë ndikimin e parashikuar në marrëdhëniet gjinore. Pasi të jenë identifikuar efektet e politikës së propozuar, ato duhet të "maten", duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme në mënyrë që të peshohet ndikimi pozitiv, neutral ose negativ të çdo iniciative:

- ⇒ Pjesëmarrja e grave dhe burrave - Ndikimi konsiderohet pozitiv kur parashikohet një rritje e ndjeshme e përfaqësimit të gjinisë së nën-përfaqësuar në zonë.
- ⇒ Qasja dhe kontrolli i burimeve - Ndikimi konsiderohet pozitiv kur eliminohet boshllëku ekzistues gjinor (ose të paktën parashikohet një reduktim i konsiderueshëm). Ky reduktim duhet gjithmonë të synojë rritjen e fuqizimit fizik, emocional dhe ekonomik të grave.
- ⇒ Normat dhe vlerat shoqërore të bazuara në gjini - Ndikimi do të konsiderohet pozitiv kur:
 - Mekanizmat ose strukturat që ndihmojnë në riprodhimin e pabarazive gjinore modifikohen.
 - Është bërë progres në eliminimin e stereotipave gjinorë.

PESHIMI I NDIKIMIT GJINOR	
VLERËSIMI GJITHËPËRFSHIRËS I NDIKIMEVE *	
II. Vlerësimi i Ndikimit Gjinor -	Titulli i Politikave ose Emri i Programit
	Emri i Ministrisë/Institucionit
	Emri i Departamentit/Njesisë
	Drejtoria ose Agjencia

Korniza ligjore				
Vlerësimi i ndikimeve				
	Pozitiv, Negativ, Asnjë	Cilësor (dëshmi të detajuara)	Sasi (dëshmi të detajuara)	Shqyrtimi i masave lehtësuese dhe/ose politikave alternative**
Pjesëmarrja e grave dhe burrave ***				
Si kontribuon politika e propozuar në nxitjen e pjesëmarrjes në sferën publike? ⇒ Politikë ⇒ Ekonomi ⇒ Punësim ⇒ Kulturë				
Nëse është relevante për sektorin/programin - Si kontribuon politika e propozuar në nxitjen e pjesëmarrjes së burrave në punët e shtëpisë dhe kujdesit?				
Është e nevojshme të theksohet një përjashtim nga këto rregulla të përgjithshme? <i><u>Kur flasim për politikën, programet apo shërbimet specifike të grave për të nxitur fuqizimin e tyre dhe përfshirjen sociale, është me rëndësi kyçe të kuptohet se pjesëmarrja vetëm nga gratë është një strategji relevante dhe e pranueshme për të promovuar barazinë gjinore.</u></i>				
Qasja në burime dhe kontrolli i burimeve ***				
Si kontribuon politika e propozuar në qasjen e grave dhe burrave në burimet esenciale?				

<p>⇒ Arsim ⇒ Punësim ⇒ Karrierë ⇒ Shëndetësi ⇒ Kohë ⇒ Para ⇒ Pushtet ⇒ Informata ⇒ Teknologji të reja</p> <p><u>Ndikimi do të konsiderohet pozitiv kur është paraparë eliminimi i boshllëqeve ekzistuese gjinore, ose të paktën një reduktim i konsiderueshëm i tyre. Ky reduktim duhet gjithmonë të synojë rritjen e fuqizimit fizik, emocional dhe ekonomik të grave. Në rastin e burrave, fokusi duhet të jetë rritja e përfshirjes së tyre në punët e shtëpisë dhe në punët e kujdesit. Për të siguruar kontroll të barabartë të burimeve, është e rëndësishme të analizohet pjesëmarrja e grave dhe burrave në vendimmarrje në fushën e projektit, siç është përshkruar më sipër.</u></p>				
<p>Normat dhe vlerat shoqërore të bazuara në gjini ***</p>				
<p>Si kontribuon politika e propozuar në promovimin e vlerës së barabartë shoqërore të grave dhe burrave, feminitetit dhe mashkulloritetit/stereotipave gjinore?</p> <p><u>Ndikimi do të konsiderohet pozitiv kur modifikohen mekanizmat ose strukturat që ndihmojnë në riprodhimin e pabarazive gjinore. Kjo do të thotë të veprosh mbi ndarjen seksuale të punës, mbi</u></p>				

II. Vlerësimi i Ndikimit Gjnor - Hapi 4B	<u>organizimin e jetës private, ose mbi organizimin e qytetarisë. Në radhë të parë, bëhet progres në eliminimin e stereotipave gjnore.</u>				
Përgatitur nga [emri (emrat) dhe funksioni (funksionet)]					

* Mund të jetë e dobishme të krahasohen dëshmitë e mbledhura me dëshmitë e organizatave qeveritare dhe joqeveritare, të dhënat publike (p.sh. përqindja e njerëzve të pakicave etnike që potencialisht janë të ndikuar, numri i grave të punësuar në nivele të larta, niveli i kënaqshmërisë së përdoruesve përfitues të shërbimit për grupe të ndryshme, Indeksi i Barazisë Gjnore,...)

** Bazuar në gjetjet nga Vlerësimi i Relevancës Gjnore dhe Analiza e ndjeshme gjnore, duhet të sugjerohen rregullime të politikave. Vendimi duhet të shqyrtojë nëse duhet të (1) Ridefinohet përkufizimi i problemit, (2) Ridefinohen objektivat e politikave të propozuara ose (3) Rishikohet dhe përcaktohet se cilat prioritete mund të promovojnë në mënyrë aktive barazinë gjnore dhe të kenë ndikim pozitiv tek burrat dhe gratë (shih Hapin 4B)

*** Informatat duhet gjithmonë të përcaktohen veçmas për gratë/burrat.

4B. Prioritizimi i ndikimeve

PESHIMI I NDIKIMIT GJNOR PRIORITIZIMI I NDIKIMEVE*								
II. Vlerësimi i Ndikimit Gjnor - Hapi 4B	Titulli i politikave ose emri i programit							
	Emri i Ministrisë/Institucionit							
	Emri i Departamentit/Njesisë							
	Drejtoria apo Agjencia							
	Korniza Ligjore							
	<i>Ndikimet Pozitive</i>							
		<i>Ndikimi**</i>	<i>Signifikanca e ndikimit</i>			<i>Probabiliteti i ndodhjes</i>		
			<i>E lartë</i>	<i>E mesme</i>	<i>E ulët</i>	<i>I lartë</i>	<i>I ulët</i>	<i>I pamundur</i>
	Pjesëmarrja e grave dhe burrave							
		A nxitë politika e propozuar pjesëmarrjen e grave/burrave (nga grupe të ndryshme) në sferën publike? ⇒ Politika ⇒ Ekonomi ⇒ Punësim ⇒ Kulturë						
	A nxitë politika e propozuar pjesëmarrjen e							

burrave në punët e shtëpisë dhe kujdesit?							
Qasja në burime dhe kontrolli i burimeve							
A e nxit politika e propozuar pjesëmarrjen e grave dhe burrave në burimet esenciale? ⇒ Arsim ⇒ Punësim ⇒ Karrierë ⇒ Shëndetësi ⇒ Kohë ⇒ Para ⇒ Pushtet ⇒ Informata ⇒ Teknologji të reja							
Normat dhe vlerat shoqërore të bazuara në gjini							
A e nxit politika e propozuar vlera të barabarta shoqërore për grat dhe burrat, feminitetin dhe mashkulloritetin/stereotipa gjinore?							
Ndikimet Negative							
	<i>Ndikimi**</i>	<i>Signifikanca e ndikimit</i>			<i>Probabiliteti i ndodhjes</i>		
		<i>E lartë</i>	<i>E mesme</i>	<i>E ulët</i>	<i>I lartë</i>	<i>I ulët</i>	<i>I pamundur</i>
Pjesëmarrja e grave dhe burrave							
A e minon politika e propozuar pjesëmarrjen e grave dhe burrave in sferën publike? ⇒ Politika ⇒ Ekonomi ⇒ Punësim ⇒ Kulturë							
A e pengon politika e propozuar pjesëmarrjen e burrave në punët e							

	shtëpisë dhe kujdesit?							
	Qasja në burime dhe kontrolli i burimeve							
	A e minon politika e propozuar pjesëmarrjen e grave dhe burrave në burimet esenciale? ⇒ Arsim ⇒ Punësim ⇒ Karrierë ⇒ Shëndetësi ⇒ Kohë ⇒ Para ⇒ Pushtet ⇒ Informata ⇒ Teknologji të reja							
	Normat dhe vlerat shoqërore të bazuara në gjini							
	A i minon politika e propozuar vlera të barabarta shoqërore për grat dhe burrat, feminitetin dhe mashkulloritetin/stereotip a gjinore?							
	<i>Përgatitur nga [emri(emrat) dhe funksioni(funksionet)]</i>							

* Kriteret për prioritizimin varen nga rrethanat specifike (vlerësimet individuale të ndikimit, prioritetet e ndryshme të qeverisë, nivelet e ndryshme të prioritetit)

** Çdo ndikim duhet të analizohet për gratë dhe burrat

4C. Signifikanca dhe probabiliteti i ndikimeve

Bazuar në informatat e mbledhura në hapin 4B, identifikoni/tregoni të gjitha ndikimet në diagramin më poshtë. Nevojiten dy diagrame të tilla, një për ndikimet pozitive dhe një për ndikimet negative.

PESHIMI I NDIKIMIT GJINOR SIGNIFIKANCA DHE PROBABILITETI I NDIKIMEVE *		
II. Vlerësimi i Ndikimit Gjikor - Hapi 4C	Titulli i politikave ose emri i programit	
	Emri i Ministrisë/Institucionit	
	Emri i Departamentit/Njesisë	
	Drejtoria apo Agjencia	
	Korniza Ligjore	
Signifikanca e ndikimit **	E lartë	E ulët
	I ulët	I lartë
Probabiliteti i ndodhjes **		
<i>Përgatitur nga [emri (emrat) dhe funksioni (funksionet)]</i>		

* Me kalimin e kohës mund të ndryshojë signifikanca ose probabiliteti i mundshëm i ndodhjes së një ndikimi; Prandaj është e këshillueshme që ta përsërisni këtë ushtrim në intervale të rregullta, për të përcaktuar nëse ndikimet duhet të riprioritizohen.

** Ndikimet me signifikanca të lartë dhe të mesme dhe me shumë probabilitet regjistrohen në celulën B (janë ato që do të prioritizohen në hapin 4D). Ndikimet me signifikanca të ulët dhe me pak gjasa për të ndodhur, regjistrohen në celulën C.

SHËNIM PËR SKEDAR

BAZUAR NË GJETJEN (ET) E VLERËSIMIT TË RELEVANCËS GJINORE DHE TË REZULTATEVE TË ANALIZËS SË NDJESHME GJINORE, MUND TË SUGJEROHET PËRSHTATJE E POLITIKAVE DHE VENDIMI DUHET TË MARRË NË KONSIDERATË NËSE DUHET TË BËHEN NDRYSHIMET E MËPOSHTME:

1

Ridefinimi i përkufizimit të problemit

2

Ridefinimi i objektivave të politikave/programit të propozuar

3


Rishqyrtimi dhe përcaktimi se cilat prioritete mund të nxisin në mënyrë aktive barazinë gjinore dhe të kenë një ndikim pozitiv si tek burrat ashtu dhe tek gratë.

Faza e III-të. Vlerësimi i ndikimit të barazisë/cilësisë gjinore

Hapi 5 Gjetjet dhe propozimi

Në Hapin 5, Gjetjet dhe rekomandimet për opsionet e politikave/legjislativë janë paraqitur rezultatet e analizës së ndjeshme gjinore (Faza II. Hapi 3) dhe janë theksuar ndikimet (pozitive ose negative) të politikave/programit të propozuar (Faza II. Hapi 4). Janë paraqitur rekomandimet se si të eliminohen ndikimet negative dhe se si të rriten ato pozitivet. Hapi i fundit është ai i shqyrtimit se si duhet të balancohet ose mënjanohet ndikimi negativ gjinor, qoftë ajo i theksuar në masë të gjerë apo minimal. Kjo mund të bëhet duke ridizajnuar politikën e propozuar. Megjithatë, nëse ndikimet negative janë minimale, atëherë mund të riorientohen vetëm fushat specifike të politikave (ato që shkaktojnë ndikimin negativ).

VLERËSIMI I CILËSISË GJINORE



Qëllimi i këtij hapi është vlerësimi se si do të ndikojnë politikën në normat shoqërore me bazë gjinore dhe rolet gjinore dhe se si do të kontribuojë kjo në promovimin e vlerës së barabartë shoqërore të grave dhe burrave, feminitetit dhe maskulinitetit. Gjithashtu, në këtë hap duhet të identifikoni se cilat veprime duhet të ndërmerren nga të gjitha institucionet publike të përfshira për të siguruar progres, duke pasur parasysh se ekziston një mungesë në njohuritë e çështjeve gjinore në të gjitha nivelet e politikë-bërjes. Integroni këto veprime në Planin e Zbatimit për Instrumentin e Koncept Dokumentit.

Thjesht, hapi i fundit është ai i shqyrtimit se si duhet të balancohet ose mënjanohet ndikimi gjinor negativ, qoftë i theksuar në masë të gjerë apo minimal. Vendimi se si mund të bëhet kjo është, për shembull, duke ri-dizajnuar politikën e propozuar ose, nëse ndikimet negative janë minimale, atëherë mund të riorientohen vetëm fushat specifike (të cilat e shkaktojnë ndikimin negativ) të politikave.

Nëse analiza në Fazat I dhe II dhe në Hapat 1 deri 3, tregon se politikat janë neutrale ndaj gjinisë, kjo duhet të shpjegohet qartë në Koncept Dokument. Megjithatë, nëse politika e propozuar e përcaktuar në Koncept Dokument është e lidhur me çështjet gjinore, atëherë duhet të theksohet edhe Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), ZBGj në përputhje me ministritë (e të gjithë sektorëve të prekur nga politika e propozuar) dhe subjektet tjera jashtë institucioneve publike duhet të përfshihen nga afër në procesin e konsultimit publik.

VLERËSIMI CILËSOR GJINOR



Identifikimi i treguesve për të lejuar monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve reale.



Vlerësimi se cilët tregues janë në dispozicion për momentin dhe sa janë të dobishëm ata në përcjelljen e progresit të barazisë gjinore.

Përndryshe, mund të jetë e nevojshme të vendosen tregues të rinj bazuar në të dhënat përkatëse të ndara sipas seksit

Kur mungesa e informacionit kufizon një analizë të duhur dhe në këtë mënyrë rezultoni në gjetje jo-bindëse, është e rëndësishme që kjo të përmendet në mënyrë eksplicite në raportin e VN(B)GJ-së.



Shpalosja e boshllëqeve të të dhënave dhe të informacionit lejon që të ndërmerren veprimet nga ata që janë përgjegjës për të zgjidhur këtë problem.

5A Rekomandimet dhe rezultatet

Në këtë hap renditni ndikimet/rekomandimet e prioritizuara, të cilat pranohen si pjesë e politikave dhe sqaroni rezultatet e synuara, që lidhen me ndryshimet e propozuara. Është e rëndësishme që të përdoret gjuhë neutrale ndaj gjinisë, për të garantuar se ekziston një vizualizim i drejtë i grave dhe i burrave gjatë gjithë dokumentit.

GJETJET DHE PROPOZIMI REKOMANDIMET DHE REZULTATET		
III. Vlerësimi i cilësisë gjinore - Hapi 5A	Titulli i politikave ose emri i programit	
	Emri i Ministrisë/Institucionit	
	Emri i Departamentit/Njesisë	
	Drejtoria ose Agjencia	
	Korniza ligjore	
	<i>Rekomandimet e pranuar</i>	<i>Rezultatet *</i>

SHËNIM PËR SKEDAR

Gjetjet dhe përfundimet duhet të formulohen në aspektin e ndikimeve tek gratë dhe burrat në kuadër të grupit(ve) të synuar. Për më tepër, duhet të paraqiten propozimet që promovojnë barazinë gjinore (si përgjigje ndaj gjendjes ekzistuese).

Për ta bërë këtë, duhet të identifikohet se si mund të forcohet barazia gjinore në pjesë të ndryshme të draft koncept dokumentit/politikave, duke marrë parasysh përfundimet e arritura:

1. Barazia gjinore **duhet të përmendet** në preambulën e ligjit ose në përcaktimin e politikave/programit të propozuar, si dhe në kornizën ligjore që i referohet asaj.
2. Barazia gjinore **duhet gjithashtu të përmendet** në objektivat, për të vendosur një pikënisje dhe për të inkurajuar angazhimin e të gjithë akterëve të përfshirë në zhvillimin e iniciativës.
3. **Veprimet** për të reduktuar mosbalancimet dhe pabarazitë dhe masat për të promovuar barazinë gjinore duhet të përfshihen në mesin e aspekteve të ndryshme të ligjit/politikave/programit.

Këto masa mund të lidhen me:

- promovimin e qasjes së grave në sektorin ku ato janë të nën-përfaqësuar;
- promovimin e qasjes së grave në vendimmarrje;
- promovimin e bashkëpërgjegjësisë së administratës publike, kompanive dhe punës së kujdesit;
- promovimin e përdorimit të statistikave dhe studimeve gjinore;
- parandalimin e dhunës me bazë gjinore;
- promovimin e veprimeve pro-aktive për të çrrënjësuar dhunën me bazë gjinore;
- eliminimin e stereotipave dhe roleve gjinore.

4. Gjuha gjithashtu duhet të rishikohet për të siguruar se është përdorur **gjuhë neutrale ndaj gjinisë** dhe për të garantuar vizualizimin e drejtë si të grave ashtu dhe të burrave përgjatë gjithë dokumentit.

5. Një komponentë tjetër e rëndësishme në këtë hap të fundit është **identifikimi i treguesve** për të lejuar monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve reale.

Për ta bërë këtë, duhet të merren parasysh aspektet e mëposhtme:

- Është e rëndësishme të vlerësohet se cilët tregues janë në dispozicion për momentin dhe sa të dobishëm janë ata në përcjelljen e progresit të barazisë gjinore. Përndryshe, mund të jetë e nevojshme të vendosen tregues të rinj bazuar në të dhënat përkatëse të ndara sipas seksit.
- Kur mungesa e informacionit kufizon një analizë të duhur dhe në këtë mënyrë rezultoni me gjetje jo-bindëse, është e rëndësishme që kjo të përmendet në mënyrë eksplicite në raportin e VN(B)GJ-së. **Shpalosja e boshllëqeve të të dhënave dhe të informacionit lejon që të ndërmerren veprimet nga ata që janë përgjegjës për të zgjidhur këtë problem.**

SI PËRFUNDIM

Çdo raport i VN(B)GJ-së duhet të përmbajë seksionet e mëposhtme:

- 1. Përkufizimin e qëllimit të politikave**
- 2. Relevancën gjinore të propozimit**
- 3. Analizën e hollësishme gjinore të propozimit**
- 4. Përfundimet nga perspektiva gjinore**
- 5. Propozimet për të përmirësuar projektin në aspektin e barazisë gjinore**

KAPITULLI 3: SI MUND TË INKORPOROHET VN(B)GJ-JA NË KONCEPT DOKUMENT DHE VLERËSIMET TJERA TË NDIKIMIT

Kombinimi me metodat tjera

Siç është përmendur shkurtimisht në seksionet paraprake të këtij manuali, Vlerësimi i ndikimit të barazisë gjinore mund të përdoret në tri mënyra:

Si një *instrument shtesë*

ose


Si një *mjet i pavarur*¹⁴

ose

Në një *mënyrë të integruar*.

Kur zbatohet si instrument shtesë, VN(B)GJ-ja është në përputhje me VN-të tjera (p.sh. VN-në e integritit, VN-në e qëndrueshmërisë, VN-në sociale, VN-në mjedisore, VN-në e tregtisë, VN-në e varfërisë - madje edhe VN-në e ekonomisë dhe VN-në financiare) dhe i shton analizës së tyre (me pyetje specifike rreth barazisë gjinore ose në vlerësimin e çështjeve përkatëse gjinore).

KOMBINIMI ME MËNYRAT E TJERA




Kur zbatohet në mënyrë të integruar, shqetësimet gjinore integrohen në *të gjithë hapat dhe proceset* e mjetit përkatës të VN-së (qasja e integritit gjinor). Në minimum, është thelbësore që të përdoret testimi i relevancës së VN(B)GJ-së si një instrument hetimi nga fillimi i çdo hulumtimi të VN-së për të shmangur rezultatet e disbalancit gjinor.

¹⁴ Një shembull i VN(B)GJ-së së pavarur mund të gjendet në:

<http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20130402195121/http://www.dwp.gov.uk/docs/genderimpactassessment.pdf>

KOMBINIMI ME METODAT E TJERA



Një VN(B)GJ i plotë (i pavarur) ka të bëjë me të gjitha hapat e VN-së, siç janë grumbullimi i të dhënave, pjesëmarrja dhe analiza e akterëve, analiza e të dhënave, zhvillimi i skenarit, monitorimi dhe vlerësimi.

KOMBINIMI ME METODAT E TJERA



Si një mjet i pavarur



Një VN(B)GJ i plotë (i pavarur) ka të bëjë me të gjitha hapat e VN-së, siç janë grumbullimi i të dhënave, pjesëmarrja dhe analiza e akterëve, analiza e të dhënave, zhvillimi i skenarit, monitorimi dhe vlerësimi.

Llojet e të dhënave të nevojshme

Parakushti për VN(B)GJ-në është që të sigurohen ose gjenerohen të dhëna të ndara sipas seksit. Të dhënat e ndara sipas seksit gjenerohen në terma sasiorë (me numërim).

Një VN(B)GJ i hollësishëm ka më shumë të ngjarë të përdorë metoda dhe të dhëna cilësore, të cilat mundësojnë një analizë në baza gjinore (për të drejtat, burimet, pjesëmarrjen, vlerat dhe normat). Në të shumtën e rasteve ekziston një bollëk i prodhimit të **njohurive cilësore** për gjininë dhe efektet e saj mbi popullatat dhe sistemet shoqërore në të gjitha disiplinat akademike, veçanërisht në studimet gjinore. Zakonisht, në ditët e sotme, shumica e **informatave sasiorë** janë të ndara sipas seksit (p.sh. nga zyrat shtetërore dhe supranacionale të statistikave)¹⁵. Shfrytëzimi i ndarjes së të dhënave sipas

¹⁵ Organizatat ndërkombëtare, të tilla si OECD, Banka Botërore, organizatat e bashkëpunimit për zhvillim etj., sigurojnë kryesisht studime sasiorë, evidenca statistikore mbi pabarazitë gjinore dhe gjenerojnë indekse gjinore, duke matur

seksit, në çfarëdo lloji të hulumtimeve të përqendruara në njerëz është një kërkesë e strategjisë së integritit gjinor.

Udhëzuesi dhe Manuali për Hartimin e Koncept Dokumenteve përcakton 7 hapa në procesin e zhvillimit të koncept dokumenteve të strategjive, politikave, programeve dhe masave të reja. Megjithatë qëllimi i qeverive duhet të jetë zbatimi i VN(B)GJ-ve të pavarura gjithmonë si një mënyrë për të informuar në mënyrë gjithëpërfshirëse proceset e tyre të politik-bërjes, është e këshillueshme të fillohet me zbatimin e VN(B)GJ-së në Kosovë në mënyrë të integruar, duke pasur parasysh proceset e vazhdueshme të qeverisjes së mirë.

HAPAT E KONCEPT DOKUMENTIT	INFORMATA RELEVANTE PËR VN(B)GJ
Hapi 1: Përkufizimi i problemit	Hapi 1 Përcaktimi i qëllimit të politikës
Hapi 2: Vendosja/përshkrimi i qëllimeve dhe objektivave	Hapi 2 Kontrolli i relevancës gjinore
Hapi 3: Përcaktimi i opioneve	Informacioni relevant nga Hapi 3 Analiza e ndjeshme gjinore dhe Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor
Hapi 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	Informacioni relevant nga Hapi 3 Analiza e ndjeshme gjinore dhe Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor
Hapi 5: Komunikimi dhe konsultimi	Si pjesë e Hapit 4 Peshimi i ndikimit gjinor
Hapi 6: Përzgjedhja dhe paraqitja e zgjidhjeve më të mira: duke krahasuar opcionet dhe ndikimet e tyre	Hapi 5 Gjetjet dhe propozimet
Hapi 7: Paraqitja e konkluzioneve dhe hapave të ardhshëm për Koncept Dokumentin	Rezultatet e VN(B)GJ janë paraqitur në Koncept dokumentin ose si nje dokument i pavarur

Tabelat, lart dhe poshtë, tregojnë që të dyja lidhjet midis hapave të VN(B)GJ dhe hapave të hartimit të koncept dokumentave në mënyrë që të mundësojnë politikëbërësit të shohin sesi ata të mund të përfshijnë gjetje relevante për VN(B)GJ dhe rekomandimet nga VN(B)GJ në procesin e hartimit të koncept dokumentit:

HAPAT E KONCEPT DOKUMENTIT	INFORMACIONE RELEVANTE PËR VN(B)GJ
<u>Hapi 1 Përkufizimi i problemit</u> Siguron bazën për koncept dokumentin dhe ofron përgjigje se përse Qeveria duhet të veprojë. Ai përfshin: → Kornizën ekzistuese ligjore dhe rregullatore → Intervenimet tjera jo-rregullatore, të	<u>Hapi 1 Përkufizimi i qëllimit të politikës</u> Vlerësimi dhe përshkrimi i gjendjes aktuale nga këndvështrimi i barazisë gjinore: → Mbledhja e çdo të dhëne statistikore të disponueshme gjinore, të fakteve dhe informacioneve që trajtohen nga

(pa)barazinë gjinore në lidhje me zhvillimin njerëzor, punësimin, arsimin, shëndetësinë, institucionet sociale etj. (p.sh. The Global Gender Gap Report/The Global Gender Gap Index 2017).

<p>rëndësishme për politikën</p> <p>→ Përkufizimi i problemit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja e të dhënave - Analiza e të dhënave - Përmbledhja e të dhënave dhe drafti i parë i përkufizimit të problemit - Verifikimi i të dhënave dhe drafti i dytë i përkufizimit të problemit - Konsultimi i përmbledhjes suaj (me shoqërinë civile, agjencitë, ...) - Finalizimi i draftit të tretë të përkufizimit të problemit - Rafinimi i përkufizimit të problemit gjatë punës në Koncept Dokument - Finalizimi i përkufizimit të problemit para se të dërgohet Koncept Dokumenti për aprovim në Qeveri <p>→ Mbivendosjet, mangësitë, mungesat dhe kundërshtitë e mundshme</p> <p>→ Palët e ndikuara të interesit</p>	<p>veprimi/objektivi i propozuar</p> <p>→ Identifikimi se çfarë dihet për përvojat, situatat dhe rolet e ndryshme të burrave dhe grave duke përdorur matjet cilësore dhe sasiore</p> <p>→ Konsultimi me gratë dhe burrat që kanë gjasa të preken nga prioritetet e politikave që pasohen (grupet punuese, konsultohen me Agjencinë për Barazi Gjinore, me ekspertët e jashtëm)</p>
<p><u>Hapi 2 Caktimi/përshkrimi i synimeve dhe objektivave</u></p> <p>Paraqet se çfarë synon Qeveria të arrijë në fusha të caktuara të politikës dhe si</p> <p>→ Identifikimi i të gjitha dokumenteve relevante afat-mesme të planifikimit të Qeverisë (synimet e përgjithshme të Qeverisë)</p> <p>→ Identifikimi i Synimeve të Politikave dhe Objektivave Specifike dhe Strategjike të cilat janë relevante për çështjen e politikës që trajtohet</p>	<p><u>Hapi 2 Kontrollimi i relevancës gjinore</u></p> <p>Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme të politikës së propozuar:</p> <p>→ Analiza e trendëve të ardhshme dhe zhvillimet e mundshme pa ndërhyrjen e politikave</p> <p>→ Vlerësimi i trendëve tek pozitat e burrave dhe grave, në mënyrë të pavarur nga ndikimet e ndonjë politike të propozuar</p> <p>→ Vlerësimi se cilat janë ndikimet e mundshme tek gratë dhe burrat, si dhe në raportet gjinore</p> <p>Duke u bazuar në këtë vlerësim, identifikimi se cilët instrumente janë më të duhura për të arritur performancën e dëshiruar <i>Rezultatet/gjetjet e Hapit 1 dhe Hapit 2 duhet të informojnë të gjitha synimet dhe objektivat, dhe duhet të ndihmojnë në identifikimin e qëllimeve relevante që Qeveria përpiqet të arrijë në fusha të caktuara të politikave.</i></p> <p><i>Gjinia duhet të inkorporohet në të gjitha synimet dhe objektivat afat-mesme të Qeverisë me indikatorët (e barazisë) gjinore, kur kjo është e përshtatshme.</i></p>
<p><u>Hapi 3 Përcaktimi i opsioneve</u></p> <p>Këto opsione janë mundësitë reale për të trajtuar problemin në mënyrë efektive brenda dhe përtej kuadrit rregullator ekzistues.</p> <p>→ Identifikimi i mangësive që rrjedhin nga përkufizimi i problemit</p>	<p><u>Hapi 3 Analiza me ndjeshmëri gjinore dhe Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor</u></p> <p>→ Informimi i rregullimit të politikës</p> <p>→ Shtimi i perspektivës gjinore në opsionet e përcaktuara dhe</p>

<ul style="list-style-type: none"> → Shqyrtimi i opsioneve të mundshme që mund të aplikohen për mangësitë dhe situatat specifike → Analiza e së paku tri opsioneve që mund të shërbejnë për trajtimin e problemit kryesor të politikës <ul style="list-style-type: none"> - “Opsioni pa ndryshime” paraqet gjendjen aktuale të çështjes së politikës dhe vazhdimin e saj nëse nuk ndodhin ndryshime - Mundësia për përmirësimin e implementimit dhe zbatimit të politikave ekzistuese dhe legjislacionit - Opsioni i një alternative të përshtatshme, e cila, kur është relevante, gjithashtu konsideron instrumentet tjera përveç atyre legjislative për të trajtuar problemin e identifikuar 	<ul style="list-style-type: none"> → Duke u bazuar në gjetjet nga Hapat 3 dhe 4 të VN(B)GJ, përcaktimi nëse duhet të bëhen ndryshime për të përmirësuar dhe rritur barazinë gjinore nëpërmjet iniciativës së propozuar të politikave. <p>Diskutimi i ndryshimeve në bazë të vlerësimit të kryer me grupin e punës për Koncept Dokumentin dhe diskutoni ndryshimet përmes konsultimeve të targetuara me akterët relevantë.</p>
<p><u>Hapi 4 Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme</u></p> <p>Zbatimi i opsioneve të identifikuara çon në lloje të ndryshme të ndikimeve në shoqëri.</p> <ul style="list-style-type: none"> → Analiza e pesë kategorive të mundshme të ndikimit: <ul style="list-style-type: none"> - Ndikimet ekonomike - Ndikimet sociale - Ndikimet mjedisore - Ndikimet ndërsektoriale - Ndikimet buxhetore → Identifikimi i çështjeve që duhet të analizohen brenda këtyre kategorive të ndikimit → Përcaktimi i rëndësisë së ndikimeve dhe thellësia e analizës → Përcaktimi i procesit të mbledhjes së të dhënave → Përshtatja e analizës për një Koncept Dokument në rast se ai trajton zbatimin e legjislacionit të BE-së → Përdorimi i parimit të analizës proporcionale për të përcaktuar thellësinë e analizës së ndikimeve → Vendosja e standardeve të duhura dhe mundësitë për zbatimin e tyre → Hartimi i planit të zbatimit duke përfshirë logjikën e aktivitetit-outputit për zgjidhje të mundshme që trajtojnë problemin e politikës → Përcaktimi i kostos për zbatimin e opsioneve duke u bazuar në planin e zbatimit → Zbatimi i rregullave të Ministrisë së Financave kur kostoja paraqet tejkalim të 	<p><i>VN(B)GJ i veçantë i shkurtër ose i plotë duhet të ndërmerret për të kuptuar plotësisht ndikimin gjinor të politikës. Përndryshe, siç sugjerohet më lart, gjinia mund të jetë një shtesë në vlerësimet tjera të ndikimit.</i></p> <p><i>VN(B)GJ do të ndihmojë në përcaktimin e prioritetit që duhet t'i bashkëngjitet adoptimit të politikave që promovojnë në mënyrë aktive barazinë gjinore dhe përcaktojnë nëse janë të nevojshme qasje ose veprime specifike të politikave për të siguruar që grupet specifike, brenda grupeve të burrave dhe grave, përfitojnë nga intervenimet e politikave të propozuara.</i></p> <p><i>Veprimet e identifikuara për aktivitetet relevante gjinore në të gjitha nivelet e politikë-bërjes duhet të integrohen në Planin e Zbatimit të Instrumentit të Koncept Dokumentit.</i></p>

<p>tavanit të buxhetit të një ministrie</p>	
<p>Hapi 5 Komunikimi dhe konsultimi</p> <p>Ka të bëjë me mbledhjen e të dhënave për një Koncept Dokument, por edhe me komunikimin e qëllimeve të Qeverisë për ndryshimin ose përmirësimin e politikave dhe motivimin që qëndron prapa këtyre qëllimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> → Komunikimi në mënyrë efektive gjatë hartimit të një Koncept Dokumenti → Zhvillimi i konsultimeve të brendshme brenda administratës dhe konsultimet publike me të gjitha palët e interesuara → Identifikimi i grupeve të synuara për aktivitetet e komunikimit → Sigurimi që konsultimi publik maksimizon pjesëmarrjen, që të jetë transparent dhe të jetë vlerë e shtuar për të gjithë ata që janë të përfshirë → Identifikimi i palëve të duhura të interesit që duhet të konsultohen për konsultime publike → Planifikimi në mënyrë efektive i aktiviteteve të konsultimit (takimet publike dhe konsultimi publik përmes internetit) → Harmonizimi i aktiviteteve të konsultimit dhe komunikimit → Organizimi i konsultimeve të targetuara gjatë tërë fazës së hartimit të Koncept Dokumentit 	<p>Si pjesë e Hapit 4 Peshimi i ndikimit gjinor...</p> <p>Procesi i komunikimit dhe konsultimit duhet të bëhet në mënyrë efektive dhe gjithëpërfshirëse për të llogaritur nëse dhe deri në çfarë shkalle duhet forcuar politika për të trajtuar synimet e barazisë gjinore.</p>
<p>Step 6 Përzgjedhja dhe paraqitja e zgjidhjes më të mirë: krahasimi i opsioneve dhe ndikimeve të tyre</p> <p>Duhet të përcaktohet opsioni optimal që do të zhvillohet dhe zbatohet më tej.</p> <ul style="list-style-type: none"> → Paraqitja e përfitimeve dhe kostove përkatëse nëpërmjet statistikave, shifrave dhe numrave konkret → Paraqitja e informacioneve në mënyrë logjike dhe të kuptueshme → Vlerësimi dhe krahasimi i opsioneve bazuar në vlerën e shtuar që ato ofrojnë 	<p>Hapi 5 Gjetjet dhe propozimi</p> <ul style="list-style-type: none"> → Identifikimi i opsioneve më të mira për rezultatet e barazisë gjinore brenda politikës përkatëse → Paraqitja e përfitimeve dhe kostove të zberthyer sipas gjinisë kur është e përshtatshme. → Paraqitja e informacioneve në mënyrë që të sigurojë qasje të barabartë në informacione si për gratë ashtu dhe burrat, djemtë dhe vajzat.
<p>Hapi 7 Paraqitja e konkluzioneve dhe hapave të ardhshëm për Koncept Dokumentin</p> <p>Opsioni i preferuar shërben si bazë për hapat e ardhshëm që identifikohen në Planin e Zbatimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> → Listimi i masave ligjore që rrjedhin nga opsioni i preferuar dhe paraqitja e tyre në një përmbledhje praktike → Ndërlidhja e analizës së politikave të Koncept Dokumentit me procesin ligjor të hartimit → Përshkrimi i proceseve të monitorimit dhe vlerësimit për të vlerësuar efektet reale që 	<p><i>Në disa vende, raporti i plotë i VN(B)GJ-së publikohet si shtojcë e Koncept Dokumentit.</i></p> <p><i>Përndryshe, hartohet një dokument më i shkurtër dhe i përmbledhur (shih strukturën e raportit të VN(B)GJ-së në faqe 32) dhe nëse politika e propozuar e përcaktuar në Koncept Dokumentin është e lidhur me çështjet gjinore, theksojeni këtë dhe sigurohuni që gjatë konsultimit publik, Agjencia për Barazi Gjinore, ZBGJ-të në ministritë e linjës (të të gjithë sektorëve të prekur nga politika e propozuar), dhe subjektet e tjera jashtë</i></p>

<p>pasojnë nga zbatimi i vendimeve të paraqitura në Koncept Dokument</p>	<p><i>institucioneve publike të jenë të përfshira ngushtë në konsultimin publik</i></p> <p><i>Nëse analiza tregon se politika është neutrale ndaj gjinisë, theksoni këtë në mënyrë të qartë në Koncept Dokument.</i></p>
--	--

Formati(-et) i dokumentit të VN(B)GJ

Siç u përmend më parë, deri tash së voni, VN(B)GJ si koncept i ri nuk është kuptuar dhe as pranuar si instrument në shumë vende në zhvillim. Thënë shkurtë, VN(B)GJ është konsideruar vetëm si një bllok tjetër burokratik dhe si diçka e imponuar nga akterët e jashtëm.

Megjithatë, nevoja për VN(B)GJ-të është bërë gjithnjë e më e rëndësishme brenda kontekstit të zhvillimit global dhe rritjes ekonomike, dhe tani po bëhet si kërkesë statutore në Kosovë. Ndërsa historikisht, zgjedhja e programeve/projekteve të reja është bazuar kryesisht në një kriter: në qëndrueshmërinë ekonomike, ndërsa sot ka kritere tjera, siç janë ndikimi mjedisor dhe social dhe ndikimi i barazisë, të cilat paraqiten si kërkesa të fuqishme. Në të vërtetë, informacionet e mbledhura gjatë procesit të zbatimit të VN(B)GJ-së tani konsiderohet globalisht si pjesë përbërëse e vlerësimeve të ndikimit rregullativ të vendit.

Megjithëse nuk ka formate universale për mënyrën se si duhet të duket një raport përfundimtar i VN(B)GJ-së, elementët e listuar në Kapitullin 2 të këtij manuali duhet të trajtohen në çdo VN(B)GJ - goftë si një vlerësim i thjeshtë ose si një vlerësim i plotë dhe i thellësishëm - si rregulla të përgjithshme që duhet respektuar gjatë përgatitjes së raportit final të VN(B)GJ. Pavarësisht nëse autoritetet përzgjedhin të realizojnë VN(B)GJ si vlerësim të pavarur ose si pjesë përbërëse të një vlerësimi ekonomik dhe/ose social dhe mjedisor, ai duhet të përmbajë së paku pikat në vijim:

FORMAT(ET) I DOKUMENTIT TË VN(B)GJ



Gjatë shkrimit të secilit seksion të VN(B)GJ-së, duhet të bëhen përpjekje të veçanta në përfshirjen e perspektivave të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, si dhe raporteve mes tyre. Për më tepër, secili seksion duhet të trajtojë dhe përfshijë perspektivat e një **përzgjedhjeje të larmishme të grave**

dhe burrave, vajzave dhe djemve. Në fakt, ekziston një keqkuptim i zakonshëm që vetëm perspektivat e grave dhe vajzave duhet të përshkruhen.

Analiza gjinore bëhet një instrument informues në rastet kur dallimet mes grave dhe burrave, vajzave dhe djemve janë të dukshme. Gjithashtu është e rëndësishme që të përfshihet një grup i ndryshëm i grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, duke u bazuar në faktorët si përkatësia etnike, klasa, orientimi seksual, etj. Duke vepruar kështu, do të ketë një larmi të gjerë perspektivash brenda grupeve gjinore me të dhëna të zbërthyer sipas seksit, që mbështesin ato dallime të theksuara.

Gjatë shkuarjes së raportit duhet të përdoret një gjuhë gjinore, dhe jo gjuhë neutrale ndaj gjinisë. Edhe pse ndonjëherë mund të duket e lodhshme përdorimi i termave “gra” dhe “burra”, “vajza” dhe “djem”, është një metodë për të bërë dallimet mes grupeve të ndryshme.

Përfundimisht, shmanguni përgjithësimet të problemit dhe cilësimit të grupeve gjinore si grupe homogjene dhe shmangni formulimin siç është "duhet të merret parasysh aspekti gjinor" por duhet të jeni më specifik dhe të identifikoni atë që kërkohet ose përshkruhet nga rekomandimi për grupin(-et) e caktuar të synuar.

Për të parë shabllonin e një **raporti të shkurtër final të vlerësimit të VN(B)GJ** ju lutem vizitoni ueb-faqen si në vijim:

Oxfam and Australian Aid. 2015. Gender and Hydropower National policy assessment MYANMAR. https://www.oxfam.org.au/wp-content/uploads/2015/09/2015-30-Myanmar-Country-Report_FA_WEB.pdf

ose

WBG. 2015. A cumulative gender impact assessment of ten years of austerity policies. A briefing from the UK Women’s Budget Group on the cumulative distributional effects of cuts in public spending and tax changes on household income by gendered types over the period 2010-20. https://wbg.org.uk/wp-content/uploads/2016/03/De_HenauReed_WBG_GIAtaxben_briefing_2016_03_06.pdf


Për të parë shabllonin e një **raporti të detajuar dhe final të vlerësimit të VN(B)GJ** ju lutem vizitoni ueb-faqen në vijim:

WBG. 2017. Gender impact assessment of the Spring Budget 2017. https://wbg.org.uk/wp-content/uploads/2016/12/WBG_Budget2017_Fullresponse-1.pdf

SHTOJCAT

SHTOJCA 1. INSTRUMENTI(-ET), TABELAT DHE SHABLLONET E VN(B)GJ

Në lidhje me fazat VN(B)GJ-së këtu më poshtë, faqet e mëposhtme përmbajnë tabela dhe shabllone (me pyetje relevante) specifike për secilën fazë/hap të procesit.



I. Vlerësimi i relevancës gjinore

Kjo fazë e parë përcakton qëllimin e një politike, strategjie, ligji ose programi të propozuar (Hapi 1 Përkufizimi i qëllimit të politikës) dhe tregon se si lidhet kjo me barazinë gjinore (Hapi 2 Kontrolli i relevancës gjinore).

Hapi 1 Përkufizimi i qëllimit të politikës

PËRKUFIZIMI I QËLLIMIT TË POLITIKËS	
I. Relevanca gjinore - Hapi 1	Titulli i politikës apo Emri i programit
	Emri i Ministrisë /Institucionit
	Emri i Departamentit/Njesisë
	Drejtoria ose Agjencia
	Korniza ligjore
	<i>Lista kontrolluese 1 – Gjendja aktuale</i>
Në fushën e politikës në shqyrtim, a ka dallime midis burrave dhe grave në organizimin gjinor të punës?	

	<p>⇒ A mbajnë gratë/burrat vende specifike pune në këtë sektor, a i përshtaten roleve specifike gjinore?</p> <p>⇒ A ekziston ndonjë boshllëk i dukshëm gjinor sa i përket pagës në këtë sektor/a marrin gratë paga të pabarabarta?</p> <p>⇒ A ekziston përshtypja se njerëzit janë të liruar nga përgjegjësitë e kujdesit, dhe si e tillë, nuk ka kufizime në pjesëmarrjen e tyre?</p> <p>A janë shqyrtuar dallimet midis grave dhe burrave në grupe kulturore/komunitete të ndryshme?</p>	
	<p>A ka dallime të rëndësishme në <u>organizimin e raporteve personale, relevante për këtë sektor/ose a munden këto dallime të ndikojnë në programin në fjalë në mënyrë pozitive/negative?</u></p> <p>⇒ A janë gratë kryesisht përgjegjëse për kujdesin familjar? A dallon kjo për grupet e ndryshme (sociale, etnike)?</p> <p>A synon politika në fjalë një transformim të normave ekzistuese?</p>	
	<p>A ka <u>shpërndarje të pabarabartë të burimeve</u> mes grave dhe burrave?</p>	
	<p>Çfarë <u>rregullash gjinore</u> ekzistojnë? (p.sh. a iu jepet më pak rëndësi roleve dhe aktiviteteve të grave/burrave në këtë sektor?)</p>	
	<p>Si do ta <u>vlerësonit situatën aktuale</u> në sektorin/fushën e politikave në aspektin e:</p> <p>⇒ Barazisë?</p> <p>⇒ Autonomisë/decentralizimit fiskal/përgjegjësisë për realizimin e shërbimeve?</p> <p>Diversitetit (grupeve të ndryshme ekonomike/integritit shoqërorë/moshës, etj.?)</p>	

	A keni të dhëna për të qenë në gjendje që t'i përgjigjeni këtyre pyetjeve?* ku mund të gjinden të dhënat (Statistikat, Të dhënat administrative, Hulumtimet)	
<i>Lista kontrolluese 2 – Gjendja e synuar</i>		
	A planifikohet të zhvillohet një politikë / program i ri ose të bëhen ndryshime në një politikë?	
	Përshkrim i shkurtër i politikës / programit të propozuar (ose ndryshimeve që duhet të bëhen në një politikë) – theksoni relevancën e tyre gjinore!!	
	Cilit rezultat(-te) të Barazisë Gjinore i kontribuon politika/programi i propozuar (ose ndryshimet që duhet të bëhen në një politikë)?	
	Çfarë synon të arrijë politika/programi i propozuar (ose ndryshimet që duhen bërë në politikë)? (Synimet-nga këndvështrimi i barazisë gjinore)	
	A përputhen synimet dhe rezultatet e politikës/programit të propozuar (ose ndryshimet që duhen bërë në politikë) me promovimin e barazisë gjinore?	
Përgatitur nga [emri (-at) dhe funksioni (-et)]		

* Mund të jetë e nevojshme të grumbullohen statistika të disponueshme të ndara sipas gjinisë, të përdoren matjet cilësore dhe sasiore dhe të bëhen konsultime me gratë dhe burrat të cilët mund të ndikohen nga politika (grupet punuese, inputet nga ekspertët e jashtëm)

Hapi 2 Kontrolli i relevancës gjinore

KONTROLLI I RELEVANCËS GJINORE		
I. Relevanca gjinore - Hapi 2	Titulli i politikës apo Emri i programit	
	Emri i Ministrisë /Institucionit	
	Emri i Departamentit/Njesisë	
	Drejtoria ose Agjencia	
	Korniza ligjore	
	<i>Informacionet mbështetëse</i>	
	Përshkrimi i politikës/programit të propozuar (ose të ndryshimeve që duhet të bëhen në një politikë) dhe të objektivave të saj	
	Përshkrimi i grupit(-ve) të synuar të politikës/programit të propozuar	
	Informacione se tek kush mund të ketë ndikim potencial politika/programi i propozuar.	
	<i>Përfituesit e drejtpërdrejtë</i>	
	Pjesëmarrja sipas gjinisë	
	Burimet sipas gjinisë	
	Normat dhe Vlerat sipas gjinisë	
	Të drejtat sipas gjinisë	
	<i>Përfituesit e tërthortë</i>	
	A ka përfitues të tërthortë të politikës/programit të propozuar (p.sh. të afërmit e përfituesve të drejtpërdrejtë, qytetet fqinje, ...)?	
	Si do të ndikohet secili grup i përfituesve të tërthortë nga politika/programi i propozuar? ⇒ Ndikimi pozitiv ⇒ Ndikimi negativ	
<i>Vlerësimi</i>		
A ka ndonjë indikacion ose dëshmi për pjesëmarrje ose pranim më të lartë apo më të ulët të grupeve të ndryshme? (shkalla e "lartë", "mesatare" ose "e ulët" e ndikimit)		

	A ka ndonjë indikacion ose dëshmi që grupe të ndryshme kanë nevoja, përvoja, çështje dhe prioritete të ndryshme në lidhje me politikën/programin e propozuar? (shkalla e "lartë", "mesatare" ose "e ulët" e ndikimit)	
	A është thënë në konsultimet e mëparshme me grupet, organizatat ose individët përkatës, se politikat e veçanta kanë krijuar probleme specifike për ta? shkalla e "lartë", "mesatare" ose "e ulët" e ndikimit)	
	A ekziston një mundësi për të promovuar më mirë barazinë e mundësive ose marrëdhëniet e mira duke ndryshuar politikën/programin e propozuar?	
Përfundimi		
	Cili është përfundimi? * ⇒ Justifikimi ⇒ Çështjet kryesore, nëse ka ⇒ Grupet në të cilat duhet përqendruar, nëse ka	
Përgatitur nga [emri(at) dhe funksioni(et)]		

*Ose Asnjë ndryshim në politika, funksione ose shërbime (p.sh. raporti "vetëm për informacion") ose Tashmë është realizuar VN(B)GJ përkatëse e kohëve të fundit ose Haptazi nuk ka relevancë me barazi ose Kërkohet vlerësim i plotë i ndikimit

II. Vlerësimi i ndikimit gjinor

Kjo fazë është e nevojshme për të arritur barazi gjinore dhe rritje të barabartë përmes politikës/programit të propozuar (Hapi 3 analiza e ndjeshme Gjinore). Bazuar në gjetjet e mbledhura në fazat e mëhershme, këtu konsiderohen edhe opsione të ndryshme dhe vlerësohet ndikimi pozitiv dhe negativ në grupet e synuara (Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor).

Hapi 3 Analiza e ndjeshmërisë gjinore

ANALIZA E NDJESHMËRISË GJINORE*		
II. Vlerësimi i ndikimit gjinor - Hapi 3	Titulli i politikës apo Emri i programit	
	Emri i Ministrisë /Institucionit	
	Emri i Departamentit/Njesisë	
	Drejtoria ose Agjencia	
	Korniza ligjore (përfshirë kornizën ligjore përkatëse për barazinë gjinore)	
	<i>Studimi i ndikimit **</i>	
	A ka dëshmi për natyrën e problemit nga perspektiva gjinore? Ku mund të gjendet kjo dëshmi (raporte, dokumente të diskutimit qeveritar, etj.?)	
	Cili është ndikimi i mundshëm i politikës në barazinë gjinore? (Pozitiv/Negativ/Neutral)	
	Nëse ka ndikim: ⇒ Si do të ndikojë politika/programi i propozuar tek gratë dhe burrat? (listoni ndikimet kyçe në grupe të ndryshme) ⇒ Kush do të ndikohet? (për çdo ndikim kyç) ⇒ Drejtpërdrejtë (informacione për përfituesit e drejtpërdrejtë nga grupe të ndryshme – nëse është e zbatueshme) ⇒ Tërthorazi (informacione për përfituesit e drejtpërdrejtë nga grupe të ndryshme – nëse është e zbatueshme) Përmbledhje e dëshmive (për çdo ndikim kyç) – ofroni statistika nëse janë në dispozicion dhe tregoni burimin e tyre	

<i>Mundësitë për promovimin e ndikimit pozitiv në barazinë gjinore</i>		
Nëse nuk ka ndikim, a ekziston mundësia të zhvillohet politika në atë mënyrë që të promovojë një ndikim pozitiv apo të ketë politika transformuese gjinore (a mund të jenë transformuese në aspektin e krijimit të vendeve të reja të punës në këtë sektor për burrat/gratë; të ndryshojnë normat?)		
<i>Shqyrtimi i dëshmive</i>		
	<i>Përmbledhje e shkurtë e dëshmive</i>	<i>Dëshmia mbështetëse (listoni dëshmitë cilësore dhe sasiore)**</i>
Cilat janë dallimet gjinore në këtë çështje? Merrni parasysh ndikimet e ndryshme të politikës së propozuar për gratë dhe burrat dhe identifikoni pasojat mbi: ⇒ Rolet dhe përgjegjësitë e grave dhe burrave (brenda sektorit) ⇒ Asetet dhe burimet me të cilat merren gratë dhe burrat (në lidhje me politiken e propozuar) ⇒ Fuqia dhe vendimmarrja ku gratë dhe burrat marrin pjesë në nivele të ndryshme (si familja, komuniteti, karriera) ⇒ Nevojat, prioritetet dhe perspektivat e grave dhe burrave		
Cilët janë faktorët ndikues social, kulturor, ekonomik dhe politik? Identifikoni dallimet midis grave dhe burrave, në zonën(at) e ndikimit në analizë, në aspektin e: ⇒ Pjesëmarrjes (përfaqësimi i grave dhe burrave në pozita vendimmarrëse, përbërja gjinore e grupit(eve) të synuar,...) ⇒ Burimeve (koha, hapësira, informacioni, fuqia ekonomike dhe politike, arsimit dhe trajnimit, puna, teknologji të reja, shërbimet e kujdesit shëndetësor, strehimi, edukimi, mobiliteti,...) ⇒ Normave dhe vlerave (rolet, qëndrimet dhe sjellja e grave dhe		

	<p>burrave, përkatësisht, pabarazitë në vlerën e përshkruar të burrave dhe grave, stereotipet, ...)</p> <ul style="list-style-type: none"> – Ndarja e punës sipas gjinisë – Organizimi i jetës private që është relevant për barazi gjinore brenda sektorit – Organizimi qytetar (pjesëmarrje relevante e grave/burrave në shoqata, sindikata, etj.) <p>⇒ Të drejtat themelore (civile, shoqërore, politike dhe të drejtat e njeriut, diskriminimi gjinor i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, qasja në drejtësi, ...)</p>	
	<p>Çfarë politika/legjislacione ekzistojnë në këtë fushë? A pasqyrojnë ato dëshmitë gjinore që keni identifikuar?</p>	
	<p>A ka pasur ndonjë ndryshim reagues gjinor në këtë fushë? Nëse po:</p> <p>⇒ Cilat janë ato?</p> <p>⇒ Si kanë ardhur këto ndryshime, çka i ka shkaktuar ato (buxheti, legjislacionet, programet e reja?</p>	
	<p>A kanë bërë këto ndonjë ndryshim të matshëm në përvojat e grave/burrave deri më tani? Nëse jo:</p> <p>⇒ Pse jo?</p> <p>⇒ A nuk ka pasur lobim/avokim?</p> <p>⇒ A nuk kanë qenë efektive metodat e lobimit?</p> <p>⇒ A ka pengesa tjera të identifikuara?</p>	
	<p>A është duke i adresuar politika e propozuar nevojat e grave dhe burrave duke marrë parasysh interesat, rolet dhe pozicionet e tyre të ndryshme?</p> <p>Identifikimi i mundësive për të mbështetur nevojat praktike të grave dhe interesat strategjike, për të kontribuar në eliminimin e pabarazive ekzistuese dhe për të promovuar barazinë ndërmjet grave dhe burrave:</p> <p>⇒ Në shkallën e pjesëmarrjes</p> <p>⇒ Në shpërndarjen e burimeve, përfitimeve, detyrave dhe përgjegjësive në jetën private dhe publike</p> <p>⇒ Në vlerën dhe vëmendjen e akorduar ndaj karakteristikave,</p>	

	sjelljeve dhe prioriteteve mashkullore dhe femërore?	
	A do të promovojë politika/programi i propozuar: ⇒ barazi të mundësive ⇒ Si?	
	<i>Përmirësimet e sugjeruara, shqyrtimi i masave lehtësuese dhe/ose alternativat e politikave</i>	
	Nëse është identifikuar ndonjë ndikim negativ, çfarë masash mund të merren për të zvogëluar ndikimin negativ të politikës?	
	Nëse është identifikuar ndonjë ndikim pozitiv, çfarë masash mund të ndërmerren për të rritur ndikimin pozitiv të politikës?	
<i>Përgatitur nga [emri(at) dhe funksioni(et)]</i>		

* Ky hap mbështetet në masë të madhe nga mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Po aq e rëndësishme është të merren parasysh pikëpamjet e atyre që janë të interesuar (kryesisht, por jo vetëm, të grupeve të synuara) përmes anketimeve, konsultimeve të grupeve, intervistave, ...

** Përmbledhje e të gjitha informacioneve të mbledhura në Hapin 1. Të dhënat duhet të përfshijnë informata aktuale të tilla si statusi, rolet dhe marrëdhëniet, moshën, religjioni, niveli arsimor, statusi martesor, ...

*** Sigurohuni që të tregoni nëse provat vijnë nga një burim që ka një 'interes të përfshirë' në këtë çështje?

Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor

4A. Vlerësimi gjithëpërfshirës i ndikimeve

Në këtë hap, është e rëndësishme të përcaktohet se si masa politike ose legislative do të kontribuojë në barazinë gjinore dhe të vlerësojë ndikimin e parashikuar në marrëdhëniet gjinore. Pasi të jenë identifikuar efektet e politikës së propozuar, ato duhet të "maten", duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme në mënyrë që të peshohet ndikimi pozitiv, neutral ose negativ i çdo iniciative:

- ⇒ Pjesëmarrja e grave dhe burrave. Ndikimi konsiderohet pozitiv kur parashikohet një rritje e konsiderueshme e përfaqësimit të gjinisë së nën-përfaqësuar në zonë.
- ⇒ Qasja dhe kontrolli i burimeve. Ndikimi konsiderohet pozitiv kur eliminohet boshllëku ekzistues gjinor (ose të paktën parashikohet një reduktim i konsiderueshëm). Ky reduktim duhet gjithmonë të synojë rritjen e fuqizimit fizik, emocional dhe ekonomik të grave.
- ⇒ Normat dhe vlerat shoqërore të bazuara në gjini. Ndikimi do të konsiderohet pozitiv kur:
 - Modifikohen mekanizmat ose strukturat që ndihmojnë në riprodhimin e barazive gjinore.
 - Është bërë progres në eliminimin e stereotipave gjinore.

PESHIMI I NDIKIMIT GJINOR					
VLERËSIMI GJITHËPËRFSHIRËS I NDIKIMEVE *					
II. Vlerësimi i ndikimeve gjinore - Hapi 4A	Titulli i politikave ose emri i programit				
	Emri i Ministrisë/Institucionit				
	Emri i Departamentit/Njesisë				
	Drejtoria apo Agjencia				
	Korniza Ligjore				
	<i>Vlerësimi i ndikimeve</i>				
		<i>Pozitiv, Negativ, Asnjë</i>	<i>Cilësor (dëshmi të detajuar)</i>	<i>Sasior (dëshmi të detajuar)</i>	<i>Shqyrtimi i masave lehtësuese dhe/ose politikave alternative **</i>
	Pjesëmarrja e grave dhe burrave ***				
	Si kontribuon politika e propozuar në promovimin e pjesëmarrjes së grave/burrave (nga grupe të ndryshme) në sferën publike? ⇒ Politikë ⇒ Ekonomi ⇒ Punësim ⇒ Kulturë				
	Nëse është relevante me				

	<p>sektorin/programin - Si kontribuon politika e propozuar në promovimin e pjesëmarrjes së burrave në punët e shtëpisë dhe kujdesit?</p>				
	<p>A është e nevojshme të theksohet një përjashtim nga këto rregulla të përgjithshme?</p> <p><i><u>Kur flasim për politikat, programet apo shërbimet specifike të grave për të nxitur fuqizimin e tyre dhe përfshirjen sociale, është me rëndësi të kuptohet se pjesëmarrja vetëm nga gratë është një strategji relevante dhe e pranueshme për të promovuar barazinë gjinore.</u></i></p>				
<p>Qasja dhe kontrolli i burimeve ***</p>					
	<p>Si kontribuon politika e propozuar në promovimin e qasjes së grave dhe burrave në burimet thelbësore?</p> <p>⇒ Arsim ⇒ Punësim ⇒ Karrierë ⇒ Shëndet ⇒ Kohë ⇒ Para ⇒ Pushtet ⇒ Informata ⇒ Teknologji të reja</p> <p><i><u>Ndikimi do të konsiderohet pozitiv atëherë kur parashihet eliminimi i boshllëqeve ekzistuese gjinore, ose të paktën një reduktim i konsiderueshëm i tyre. Ky reduktim duhet gjithmonë të synojë rritjen e fuqizimit fizik, emocional dhe ekonomik të grave. Në rastin e burrave, fokusi duhet të jetë në rritjen e përfshirjes së tyre në punët</u></i></p>				

<p><u>e shtëpisë dhe kujdesit ose në rritjen e punësimit në sektorët ku ata nuk janë të pranishëm, por aty ku ka mungesë të fuqisë punëtore (parashkollorë, arsim fillor, infermieri, etj.). Për të siguruar kontroll të barabartë të burimeve, është e rëndësishme të analizohet pjesëmarrja e grave dhe burrave në vendimmarrje në fushën e projektit, siç është përshkruar më sipër.</u></p>				
<p>Normat dhe vlerat shoqërore të bazuara në gjini ***</p>				
<p>Si kontribuon politika e propozuar në promovimin e vlerës së barabartë shoqërore të grave dhe burrave, feminitetit dhe maskulinitetit/ stereotipave gjinore? <u>Ndikimi do të konsiderohet pozitiv kur modifikohen mekanizmat ose strukturat që ndihmojnë në rikrijimin e pabarazive gjinore. Kjo do të thotë të veprosh në ndarjen gjinore të punës, në organizimin e jetës private, dhe/ose në organizimin qytetar. Në radhë të parë, bëhet progres në eliminimin e stereotipave gjinore.</u></p>				
<p>Përgatitur nga [emri (at) dhe funksioni (et)]</p>				

* Mund të jetë e dobishme të krahasohen dëshmitë e mbledhura me dëshmitë e organizatave qeveritare dhe joqeveritare, të dhënat publike (p.sh. përqindja e njerëzve të pakicave etnike që potencialisht janë të ndikuar, numri i grave të punësuara në nivele të larta, niveli i kënaqshmërisë së përdoruesve përfitues të shërbimit për grupe të ndryshme, Indeksi i Barazisë Gjinore, ...)

** Bazuar në gjetjet nga Vlerësimi i Relevancës Gjinore dhe Analiza e ndjeshme gjinore, duhet të sugjerohen rregullime të politikave. Vendimi duhet të shqyrtojë nëse duhet të (1) Ridefinohet përkufizimi i problemit, (2) Ridefinohen objektivat e politikave të propozuara ose (3) Rishikohet dhe përcaktohet se cilat prioritete mund të promovojnë në mënyrë aktive barazinë gjinore dhe të kenë ndikim pozitiv tek burrat dhe gratë (shih Hapin 4B)

*** Informatat duhet gjithmonë të përcaktohen veçmas për gratë/burrat.

4B. Prioritizimi i ndikimeve

Duke përdorur të dhënat nga tabela 4A, përpuni të përcaktoni prioritetin e ndikimit me anë të identifikimit të rëndësisë së ndikimit dhe probabilitetin e ndodhjes së këtij ndikimi.

PESHIMI I NDIKIMIT GJINOR PRIORITIZIMI I NDIKIMEVE *								
II. Vlerësimi i Ndikimit Gjinator - Step 4B	Titulli i politikave ose emri i programit							
	Emri i Ministrisë/Institucionit							
	Emri i Departamentit/Njësisë							
	Drejtoria apo Agjencia							
	Korniza ligjore							
	<i>Ndikimet pozitive</i>							
		<i>Ndikimi **</i>	<i>Rëndësia e ndikimit</i>			<i>Probabiliteti i ndodhjes</i>		
			<i>E lartë</i>	<i>E mesme</i>	<i>E ulët</i>	<i>I lartë</i>	<i>I ulët</i>	<i>I pamundur</i>
	Pjesëmarrja e grave dhe burrave							
	A promovon politika e propozuar pjesëmarrjen e grave/burrave (nga grupe të ndryshme) në sferën publike? ⇒ Politikë ⇒ Ekonomi ⇒ Punësim ⇒ Kulturë							
	NËSE është relevante me sektorin - A promovon politika e propozuar pjesëmarrjen e burrave në punët e shtëpisë dhe kujdesit?							
	Qasja dhe kontrolli i burimeve							
A e promovon politika e propozuar qasjen e grave dhe burrave në burimet thelbësore? ⇒ Arsim ⇒ Punësim ⇒ Karrierë ⇒ Shëndetësi ⇒ Kohë ⇒ Para								

⇒ Pushtet							
⇒ Informata							
⇒ Teknologji të reja							
Normat dhe vlerat shoqërore të bazuara në gjini							
A promovon politika e propozuar vlera të barabarta shoqërore për grat dhe burrat, feminitetin dhe maskulinitetin/ stereotipet gjinore?							
Ndikimet negative							
	<i>Ndikimi**</i>	<i>Rëndësia e ndikimit</i>			<i>Probabiliteti i ndodhjes</i>		
		<i>E lartë</i>	<i>E mesme</i>	<i>E lartë</i>	<i>I lartë</i>	<i>I ulët</i>	<i>I pamundur</i>
Pjesëmarrja e grave dhe burrave							
A e cenon politika e propozuar pjesëmarrjen e grave/burrave (nga grupe të ndryshme) në sferën publike? ⇒ Politikë ⇒ Ekonomi ⇒ Punësim ⇒ Kulturë							
A e pengon politika e propozuar pjesëmarrjen e grave dhe/ose burrave në punët e shtëpisë dhe kujdesit?							
Qasja dhe kontrolli i burimeve							
A e cenon politika e propozuar qasjen e grave dhe burrave në burimet thelbësore? ⇒ Arsim ⇒ Punësim ⇒ Karrierë ⇒ Shëndetësi ⇒ Kohë ⇒ Para ⇒ Pushtet ⇒ Informata							

II. Vlerësimi i Ndikimit Gjnor - Hapi 4C	⇒ Teknologji të reja							
	Normat dhe vlerat shoqërore të bazuara në gjini							
	A i cenon politika e propozuar vlerat e barabarta shoqërore për gratë dhe burrat, feminitetin dhe maskulinitetin /stereotipet gjinore?							
Përgatitur nga [emri (at) dhe funksioni (et)]								

* Kriteret për prioritizimin varen nga rrethanat specifike (vlerësimet individuale të ndikimit, prioritetet e ndryshme të qeverisë, nivelet e ndryshme të prioritetit)

** Çdo ndikim duhet të analizohet për gratë dhe burrat.

4C. Rëndësia dhe probabiliteti i ndikimeve

Bazuar në informatat e mbledhura në hapin 4B, identifikoni/tregoni të gjitha ndikimet në diagramin e mëposhtëm. Nevojiten dy diagrame të tilla, një për ndikime pozitive dhe një për ndikime negative.

PESHIMI I NDIKIMIT GJINOR RËNDËSIA DHE PROBABILITETI I NDIKIMEVE*										
II. Vlerësimi i Ndikimit Gjnor - Hapi 4C	Titulli i politikave ose emri i programit									
	Emri i Ministrisë/Institucionit									
	Emri i Departamentit/Njesisë									
	Drejtoria apo Agjencia									
	Korniza Ligjore									
	Rëndësia e Ndikimit**	<table border="1" style="width: 100%; height: 150px;"> <tr> <td style="text-align: center; vertical-align: top;">E lartë</td> <td style="width: 50%; height: 50px;">A</td> <td style="width: 50%; height: 50px;">B</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center; vertical-align: bottom;">E ulët</td> <td style="height: 50px;">C</td> <td style="height: 50px;">D</td> </tr> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">I ulët</td> <td style="text-align: center;">I lartë</td> </tr> </table>	E lartë	A	B	E ulët	C	D		I ulët
E lartë	A	B								
E ulët	C	D								
	I ulët	I lartë								
Probabiliteti i Ndhjes **										
Përgatitur nga [emri (at) dhe funksioni (et)]										

III. Vlerësimi i Cilësisë Gjinore

Hapi 5 Gjetjet dhe propozimi

5A Rekomandimet dhe rezultatet

Renditni ndikimet/rekomandimet e prioritizuara, të cilat pranoen si pjesë e politikës dhe qartësoni rezultatin e synuar të lidhur me ndryshimet e propozuara. Është thelbësore që të përdoret gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore për të garantuar një vizualizim të drejtë të grave dhe burrave në të gjithë dokumentin.

GJETJET DHE PROPOZIMI REKOMANDIMET DHE REZULTATET		
II. Vlerësimi i Cilësisë Gjinore - Hapi 5A	Titulli i politikave ose emri i programit	
	Emri i Ministrisë/Institucionit	
	Emri i Departamentit/Njesisë	
	Drejtoria apo Agjencia	
	Korniza Ligjore	
	<i>Rekomandimet e pranuar</i>	<i>Rezultatet*</i>
<i>Përgatitur nga [emri (at) dhe funksioni (et)]</i>		

* Identifikoni treguesit e disponueshëm që lejojnë monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve faktike. Kur këta tregues nuk janë të disponueshëm, bëjini të ditura boshllëqet e të dhënave dhe të informatave.

5B Rekomandimet dhe metodat e zbatimit

GJETJET DHE PROPOZIMI REKOMANDIMET DHE METODAT E ZBATIMIT		
III. Vlerësimi i Cilësisë Gjinore - Hapi 5B	Titulli i politikave ose emri i programit	
	Emri i Ministrisë/Institucionit	
	Emri i Departamentit/Njesisë	
	Drejtoria apo Agjencia	
	Korniza Ligjore	
	<i>Rekomandimet e pranuar</i>	<i>Metodat e zbatimit</i>
Përgatitur nga [emri (at) dhe funksioni (et)]		

SHTOJCA 2. REFERENCAT

Manualet e trajnimit

Grupi i Bankës Afrikane për Zhvillim., 2009. Checklist for Gender Mainstreaming in the Infrastructure Sector.

Në dispozicion në: <https://www.afdb.org/fileadmin/uploads/afdb/Documents/Policy-Documents/Checklist%20for%20Gender%20Mainstreaming%20in%20the%20Infrastructure%20Sector.pdf>

Austria Aid dhe OXFAM. 2013. Balancing the scales: using gender impact assessment in hydropower development.

Në dispozicion në: <https://www.oxfam.org.au/what-we-do/infrastructure-people-and-environment/save-the-mekong/gia-manual/>

Këshilli i Evropës., 1998. Gender Mainstreaming: Conceptual framework, methodology and presentation of good practices.

Në dispozicion në: <http://www.unhcr.org/3c160b06a.pdf>

Këshilli i Evropës (2004), Gender mainstreaming: Conceptual framework, methodology and presentation of good practices.

Në dispozicion në: http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/03themes/gender-mainstreaming/EG_S_MS_98_2_rev_en.pdf

Crawley & O'Meara., 2004. Gender Impact Assessment Handbook.

Në dispozicion në: <http://www.ofmdfmi.gov.uk/handbook1.pdf>

Komisioni për Barazi dhe të Drejta të Njeriut., 2010. Equality impact assessment quick-start guide. A step-by-step guide to integrating equality impact assessment into policymaking and review.

Në dispozicion në: [http://www.shropshire.gov.uk/equalopps.nsf/viewAttachments/KPAH-8QSCMD/\\$file/equality_impact%20assessment%20guidance_.pdf](http://www.shropshire.gov.uk/equalopps.nsf/viewAttachments/KPAH-8QSCMD/$file/equality_impact%20assessment%20guidance_.pdf)

Komisioni Evropian (1998), A Guide to Gender Impact Assessment.

Në dispozicion në: <http://bookshop.europa.eu/en/a-guide-to-gender-impact-assessmentpbCE1698788/?CatalogCategoryID=WpIKABst.SMAAAEjGJEY4e5L>

Komitetet Evropiane., 2008. Manual for Gender Mainstreaming. Employment, social inclusion and social protection policies.

Në dispozicion në: <http://ec.europa.eu/social/search.jsp?langId=en&menuType=basic>

JämStöd.2007. Step-by-Step Guide for Gender Impact Assessment: Gender Mainstreaming Manual. A 43 book of practical methods from the Swedish Gender Mainstreaming Support Committee.

Në dispozicion në: <http://www.regeringen.se/content/1/c6/08/19/44/3532cd34.pdf>

L. H., 2008. Gender Mainstreaming Reference Kit (GMRK).

Në dispozicion në:

http://www.humanrightsimpact.org/resourcedatabase/toolsets/resources/view/62/user_hria_toolsets

Komisioni Kombëtar për Promovim të Barazisë., 2006. Gender Mainstreaming in Employment Public Sector a Toolkit.

Në dispozicion në: <http://www.resourcepack.equality.gov.mt/toolkits>

NCPE. 2010. Gender Mainstreaming in Practice: Step by step guide for gender impact assessment.

Në dispozicion në:

https://ncpe.gov.mt/en/Documents/Projects_and_Specific_Initiatives/Gender_Mainstreaming_in_Practise/gmip_step_by_step.pdf

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara., 2011. Introductory Gender Analysis & Gender Planning Training Module for UNDP Staff. [Online].

Në dispozicion në: <http://www.undp.org.ir/DocCenter/gender/GenderMainstreamingTraining.pdf>

Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin., undated. Part I Gender Mainstreaming: 10 Steps for Integrating Gender Into The Policy-Making Process.

Në dispozicion në: http://www.unep.org/civil_society/gcsf8/pdfs/gender_10steps.pdf

Dokumentet dhe raportet e zbatimit të VNGJ

ADB. 2010. Cambodia: Country gender analysis.

Në dispozicion në: <http://www.adb.org/documents/cambodiacountry-gender-analysis>

Bundesministerin für Frauen und Öffentlichen Dienst (2013), Regulatory Impact Assessment and the Impact Dimension of Gender Equality.

Në dispozicion në:

https://www.oeffentlicherdienst.gv.at/wirkungsorientierte_verwaltung/dokumente/Folder_Wo_Folgenabschaetzung_EN.pdf

Dr. Doris Hayn Dr. Irmgard Schultz. 2002. Gender Impact Assessment in the Field of Radiation Protection and the Environment – Concluding Report – on behalf of the Federal Ministry for the Environment, Nature Conservation and Nuclear Safety (BMU).

Në dispozicion në: http://www.bmub.bund.de/fileadmin/bmu-import/files/pdfs/allgemein/application/pdf/gia_abschlussbericht_uk.pdf

Emakunde/Basque Institute for Women Guía para la elaboración de informes de impacto de género, (2013).

Në dispozicion në:

http://www.emakunde.euskadi.net/contenidos/informacion/pub_guias/es_emakunde/adjuntos/26.guia.para.la.elaboracion.de.informes.de.impacto.de.genero.pdf

Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Punësimin, Çështjet Sociale dhe Shanse të Barabarta (2007) Gender mainstreaming of employment policies: A comparative review of thirty European countries.

Gonäs, L.2002. Top Down - But How Far? Expert report on Gender Impact Assessment & the Employment Strategy. EGG.

J Rubery and C Fagan (2000) Gender Impact Assessment and European Employment S Policy (EGGE – EC's Expert Group on Gender and Employment)

Zyra për Gratë dhe Universiteti i Adelaide 2005, Gender Impact Assessment: implementing the Netherlands Model, viewed 8 August 2013.

Në dispozicion në: http://officeforwomen.sa.gov.au/_data/assets/pdf_file/0013/5134/Gender-Analysis-NETHERLANDS.pdf

Overseas Development Institute: Gender Impact Assessment: Framework for Gender Mainstreaming.

Në dispozicion në: http://www.odi.org.uk/rapid/tools/toolkits/EBP/Gender_impact.html

Resource Management in Asia-Pacific Program Australian National University., 2008. Gender Impact Assessment: An Introductory Guide.

Në dispozicion në: oecdwatch.org/publications-en/Publication_3287/at_download/fullfile

WBG. December 2017. Gender impact assessment of the Autumn Budget 2017.

Në dispozicion në: <https://wbg.org.uk/wp-content/uploads/2017/12/WBG-response-Autumn-Budget-2017-FINAL.pdf>

Manuali, Konceptet, dhe Trajnimi në Praktikë për Vlerësimin/Analizën e Ndikimit Gjinator

Programi – Dita e Parë

Objektivat e Punëtorisë:

1. Njoftimi i pjesëmarrësve me konceptet themelore të barazisë dhe ekuitetit gjinator si dhe instrumentet e vlerësimit të ndikimit gjinator (VNGJ).
2. Prezantimi i pjesëmarrësve me VNGJ si pjesë e një instrumenti për analizë gjinore i cili ka të bëjë me Vlerësimin e Ndikimit Rregullator.
3. Prezantimi i pjesëmarrësve me proceset dhe çështjet e VNGJ.

Prezantim: Çka është VNGJ?

Ushtrim: Pema e Vlerave - Vlerat gjinore, Qëndrimet dhe Praktikak

Ushtrimi:

- Ilustron vlerat dhe qëndrimet e rrënjësura thellë sa i përket gjinisë dhe institucioneve ose sistemeve që i përjetësojnë këto vlera.
- Thekson natyrën sistematike të pabarazisë gjinore.
- Thekson që puna drejt barazisë gjinore mund të kërkojë punë në nivele të ndryshme në mënyrë që të ndikojë në pabarazinë sistematike ose strukturore.

MESAZHET KYÇE:

Çështja kyçe është **analizimi se si shoqëritë përjetësojnë vlerat, qëndrimet dhe praktikak që çojnë në diskriminimin gjinator dhe identifikimi i mënyrave me anë të të cilave ju mund të mbështetni në mënyrë efektive barazinë gjinore.**

Kjo kornizë analitike është gjithashtu mjete i parë i analizës gjinore që do të futet në këtë punëtori dhe i njëjti është një instrument themelor që mund të përdorni me kolegët tuaj në mjedise të ndryshme.

UDHËZIME:

Ndahuni në grupe të vogla prej përafërsisht 5 deri në 6 persona. Moderator i jep secilit grup një deklaratë mbi çështjet që përfaqëson një vlerë ose praktikë. Grupi juaj duhet të përgatitë një pemë vlerash dhe qëndrimesh bazuar në çështjen tuaj, e cila përfshin elementet e mëposhtme:

Rrënjët: Vlerat dhe qëndrimet lidhur me gjininë.

Trungu/Degët: Institucionet që përjetësojnë vlera dhe qëndrimet në lidhje me gjininë.

Gjethet: Praktikak e vëzhguara në shoqëri të cilat reflektojnë vlerat dhe qëndrimet lidhur me gjininë të përjetësuar nga institucionet dhe sistemet.

Ju lutemi vini re:

- Edhe pse duket si **USHTRIMI I PEMËS SË PROBLEMEVE** - nuk është!!! Përdorni konceptet/kontekstin e vlerave, qëndrimeve dhe institucioneve që përjetësojnë vlerat, në

vend të problemit kryesor, shkaktarëve dhe konceptet e efekteve të analizës së pemës së problemeve.

- Vlerat dhe qëndrimet gjinore i referohen atyre tipareve sistematike në shoqëri që zbatojnë barazinë ose pabarazinë gjinore.
- Praktikrat gjinore i referohen rezultateve të vlerave dhe qëndrimeve gjinore dhe institucioneve që i përjetësojnë këto praktika.

Vizatoni një pemë me rrënjë, trung, degë dhe gjethe.

Fletë Pune e Aktivitetit të Pjesëmarrësve

Vendosni në grup, se ku ta vëni çështjen që ju është dhënë në pemë. Plotësoni pjesën tjetër të pemës për çështjen tuaj.

Mbani mend:

Rrënjët = Vlerat dhe Qëndrimet Gjinore

Trungu/Degët = Institucionet që i përjetësojnë këto vlera dhe qëndrime

Gjethet = Praktikrat gjinore

Do të keni gjysmë ore kohë për diskutimin dhe analizën e pemës.

Përgjidhni dikë në grupin tuaj për të raportuar në mbledhjen plenare për diskutimin që grupi juaj kishte gjatë zhvillimit të vizatimit.

Korniza e Fuqizimit¹⁶

- Fuqizimi i referohet një procesi që u jep grupeve specifike të burrave dhe grave kontroll dhe fuqi më të madhe mbi jetët e tyre.
- Kësisoj, premisa kryesore është që do të arrihet barazi më e madhe gjinore me anë të fuqizimit të grave dhe burrave në mënyra dhe nivele të ndryshme.
- Korniza e Fuqizimit shqyrton ndryshimet në fuqizimin e grave dhe burrave nga pesë perspektiva të ndryshme.
- Pesë kategoritë kryesore të analizës janë:
 - Mirëqenia
 - Qasja
 - Vetëdija kritike
 - Pjesëmarrja
 - Kontrolli dhe pronësia

Meqenëse marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit që ekzistojnë ndërmjet grave kanë bërë që gratë të kenë status vartës edhe nëse janë brenda së njëjtës klasë, ju mund të vini re se analiza juaj ka tendencë të përqendrohet kryesisht në situatën e grave. Megjithatë, është e rëndësishme të zhvillohet ndonjë analizë gjinore nga perspektiva mashkullore dhe femërore për të kuptuar se si inputet e dhëna do të ndikojnë në të dy sekset - si grupe të ndara dhe në raport me njëri-tjetrin.

¹⁶ Materiali i përshtatur nga: Dana Peebles. 2006. OAS Staff Gender Toolkit

Për të përdorur Kornizën, duhet të përcaktohet situata për grupet specifike të burrave dhe grave në lidhje me secilin nga nivelet e fuqizimit në vazhdim.

Mirëqenia: Niveli i mirëqenies i referohet çdo veprimi ose inputi që rrit mirëqenien materiale të grave dhe të burrave (p.sh., statusin e tyre ushqimor, sigurinë, shëndetin, të ardhurat, etj.) dhe që rrit cilësinë e tyre të jetës përmes ofrimit të nevojave bazë.

Qasja: Ashtu si në Kornizën e Qasjes dhe Kontrollit, kjo pjesë i referohet qasjes së grave dhe burrave në burime/resurse siç janë toka, kredia, punë, shërbime dhe faktorë tjerë të prodhimit. Fuqizimi në këtë nivel nënkupton rritjen e qasjes së burrave dhe grave në këto burime/resurse dhe sigurimin se të dy sekset kanë qasje të barabartë në to.

Vetëdija kritike: Në procesin e përpjekjes për të përmirësuar jetët e tyre, gratë dhe burrat përballen me shumë pengesa. Diskriminimi gjinor është një shkak themelor shumë i rëndësishëm i varfërisë. Për të qenë në gjendje ta trajtojmë këtë diskriminim në mënyrë efektive, edhe gratë edhe burrat duhet së pari të jenë të vetëdijshëm që ky problem ekziston. Prandaj, fuqizimi në këtë nivel nënkupton sensibilizimin dhe refuzimin e besimit se statusi i ulët socio-ekonomik i grave është pjesë e rendit natyror dhe se ato kanë më pak vlerë se sa burrat.

Politika, programi ose aktivitetet e projektit në këtë nivel inkurajojnë njerëzit të analizojnë shoqërinë në mënyrë kritike dhe të njohin praktikat diskriminuese për atë se çfarë janë dhe jo si diçka që nuk është as e pranueshme as e përhershme. Për më tepër, përfshinë zhvillimin e besimit në barazi ndërmjet grave dhe burrave si e drejtë themelore e njeriut. Gjithashtu nënkupton zhvillimin e inputeve strategjike që do të nxisin krijimin e një mjedisi më të barabartë.

Pjesëmarrja: I referohet fuqizimit në lidhje me vendimmarrjen në të gjitha nivelet. Boshllëku gjinor ndërmjet pjesëmarrjes së grave dhe burrave në proceset formale dhe jo formale të vendimmarrjes, është një dukuri shumë e dukshme dhe që mund të kuantifikohet me lehtësi. Rritja e fuqizimit në këtë nivel do të thotë se politikat, programet dhe projektet e zhvillimit duhet të nxisin rritjen e përfaqësimit në sferën publike dhe të vendosin mekanizma për të siguruar se gratë dhe burrat e marginalizuar përfaqësohen në vlerësimin e nevojave, identifikimin e problemit, planifikimin e projektit, menaxhimin, zbatimin dhe proceset e vlerësimit.

Kontrolli dhe pronësia: Boshllëku gjinor në këtë nivel rezulton gjithashtu si shkak i marrëdhënieve të pabarabarta të pushtetit ndërmjet grave dhe burrave. Bazohet në mosbalancim ndërmjet pronësisë mashkullore dhe femërore të mjeteve të prodhimit dhe kontrollit mbi vendimet në lidhje me alokimin dhe përdorimin e tyre. Për të rritur fuqizimin në këtë nivel nënkupton gjetjen e mënyrave inovative për të nxitur rritjen e pronësisë dhe kontrollit nga grupet gjinore të cilat aktualisht nuk kanë shumë kontroll ose pronësi.

Një politikë ose projekt mund të rris fuqizimin e grave dhe burrave vetëm në një nivel të fuqizimit ose në të pesë nivelet. Gjëja e rëndësishme është të përcaktohet se ku është nevoja më e madhe për t'i përqendruar burimet/resurset në ato nivele.

Udhëzuesi i Analizës Gjimore dhe Planifikimit: Korniza e Fuqizimit

Për të realizuar analizën gjimore të Kornizës së Fuqizimit, duhet të mblidhni të dhëna duke marrë përgjigje ndaj pyetjeve në vijim:

- **Mirëqenia** (interesat praktik)
 - Cilat nevoja bazë mund t'i adresojë në mënyrë efektive politika, programi ose projekti juaj?
 - Cilat janë boshllëqet kryesore në lidhje me mirëqenien e grave dhe burrave në këtë sektor?
- **Qasja** (nevojat praktike dhe interesat strategjike)
 - Cilat janë burimet/resurset kryesore në të cilat gratë dhe burrat kanë nevojë që të rrisin qasjen?
 - Çfarë lloje inputesh dhe aktiviteteve mund të vendos politika, programi ose projekti juaj që do të rrisin qasjen e grave dhe burrave në këto burime dhe që mundësojnë qasje më të barabartë në burime?
- **Vëmendja kritike** (interesat strategjike)
 - Cili është pozicioni relative i grave dhe burrave në këtë situatë?
 - A janë të vetëdijshëm grupet specifike të grave dhe burrave me të cilët do të punoni, se janë në pozitë relativisht të pafavorizuar në lidhje me qasjen dhe kontrollin e burimeve dhe me pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në komunitetin ose organizatën e tyre?
 - A janë gratë dhe burrat të vetëdijshëm për pozitën e tyre në lidhje me seksin e kundërt?
 - Çfarë lloj masash strategjike mund të vendosni përmes politikës, programit apo projektit tuaj, që do të rrisin vetëdijen kritike të burrave dhe grave për format dhe shkaqet kryesore të diskriminimit gjinor që ndikon tek ata në këtë situatë?
- **Pjesëmarrja** (interesat strategjike)
 - sa ka qenë pjesëmarrja për gratë dhe burrat para zbatimit të politikës ose projektit? (të dhëna kuantitative)
 - në çfarë niveli kanë marrë pjesë gratë dhe burrat para zbatimit të politikës ose projektit? (të dhëna kuantitative)
- **Kontroli dhe pronësia** (interesat strategjike)
 - cilat grupe, organizata ose individë kanë zotëruar ose kontrolluar burimet kryesore para zbatimit të politikës ose projektit?

- si ishin të ndarë këto grupe, organizata ose individë sipas seksit?

UDHËZIME

Ndahuni në grupe të vogla prej 5 - 6 personash.

Së pari

Diskutoni dhe analizoni pyetjen në vazhdim:

1. Cilat mendoni se janë çështjet kryesore të barazisë gjinore që Ministria e xx duhet t'i adresojë në procesin e analizës gjinore para se të finalizohet hartimi i politikës/programit/ligjit?

Së dyti:

Plotësojeni tabelën e Analizës së Fuqizimit të paraqitur më poshtë, në bazë të listës së katër aktiviteteve kryesore të projektit të përshkruar më lartë, për të përcaktuar se çfarë lloj ndikimi mund të kenë në pesë nivelet e ndryshme të fuqizimit për grupet kryesore të burrave dhe grave në fjalë.

Për të plotësuar matricën e fuqizimit të paraqitur më poshtë për secilin nivel të fuqizimit, duhet të përgjigjeni në këto pyetje:

1. Cilat grupe specifike të burrave dhe grave duhet të përfitojnë ose do të preken më së shumti nga aktiviteti i këtij projekti/programi? Mund ta shënoni këtë informacion në kolonën e supozimeve.
2. A do të çojë ky aktivitet i projektit në rritjen e fuqizimit për gratë dhe burrat nga këto grupe specifike në ndonjërin nga pesë kategoritë e fuqizimit? Shkruani po ose jo për secilën gjini për secilën kategori të fuqizimit.
3. Bazuar në vlerësimin tuaj fillestar, a mendoni se ky projekt ka gjasë të çojë në fuqizim më të madh për burrat apo gratë në çdo fushë? Nëse po, si dhe pse?
4. Kur analiza juaj të tregojë se ekzistojnë ende boshllëqe në fuqizimin e grave dhe burrave në ndonjërin nga nivelet, brenda kontekstit të projektit, çfarë lloj masash mendoni se mund të vendos kjo ekonomi për të zvogëluar këto boshllëqe?

Në disa raste, ju mund të vendosni se është e mundshme ose praktike të përqipeni dhe të bëni ndryshime në fuqizim në dy ose tre nga këto nivele. Gjithashtu vini re se të gjitha pesë nivelet janë të ndërlidhura ngushtë. Prandaj, ajo që ndodh tek njëri nivel potencialisht mund të ndikojë në të gjitha nivelet tjera.

Matrica e Kornizës së Fuqizimit

Inputi i projektit ose aktiviteti	Mirëqenia		Qasja në burime		Vetëdija kritike		Pjesëmarrja		Kontrolli dhe pronësia		Supozimet	
	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M

Hyrja në DITËN e 2-të:

Prezantim i shkurtë: VNR në Kosovë dhe zbatimi i VNGJ-së

(referojuni pjesës së prezantimit në powerpoint)

Prezantim i shkurtë: hapat e VNGJ-së

(referojuni pjesës së prezantimit në powerpoint)

Ushtrimi përmbyllës: Pikat e qarta dhe të paqarta¹⁷

Objektivi

- Të ndihmohen pjesëmarrësit që të reflektojnë në mënyrë kritike mbi të nxënit tuaj nga Dita 1 në lidhje me kontekstin/et tuaj të punës.

Shpjegim

Qëllimi i ushtrimit është t'iu ofrojë informata kthyesë për ditën 1, si dhe të informojë trajnerët në lidhje me çdo pikë për të cilën ende duhen sqarime.

Pikat e paqarta janë çështje për të cilat ju mund të kërkonit sqarim të mëtejshëm.

Pikat e qarta janë ato të cilat ju do të jeni të aftë që t'i përvetësoni nga punëtoria, si dhe janë diçka e re që keni mësuar ose parë dhe që mendoni se do t'iu ndihmojnë në punën tuaj.

Koha: 15 minuta.

Udhëzime

Shënoni në kartën e bardhë mësimin më të dobishëm për vendin tuaj të punës ose personalisht për ju, nga aktivitetet e trajnimit të realizuara sot. Shënoni në kartën e verdhë atë që është ende e paqartë për ju nga aktivitetet e sotme të punëtorisë.

Trajneri do të mbledhë dhe grupojë kartat sipas kategorive, dhe brenda natës do të përmbledh pikët kryesore dhe në fillimin e punëtorisë së ditës vijuese do të sqarojë çdo fushë që ka mbetur e paqartë.

Programi – Dita e dytë

Prezantimi: Instrumenti i analizës gjinore – Hapat, Nevojat Praktike dhe Interesat Strategjike

(referojuni pjesës së prezantimit në powerpoint)

Materiale mbi historikun: MANUALI I VNGJ-së SË KOSOVËS

Politikat, programet dhe projektet mund të përqendrohen në iniciativat që adresojnë qofte nevojat praktike të grave dhe burrave ose interesat strategjike të tyre, ose kombinimin e të dyjave. Në vijim janë përmbledhur dallimet kryesore në qasjet e programit. Varësisht nga lloji i rezultatit të barazisë gjinore që shpresoni të arrini, ju mund të përdorni këtë udhëzues për t'iu ndihmuar në përcaktimin e llojit të qasjes që duhet të përdorni në fushën tuaj të punës.

¹⁷ Ushtrimi i përshtatur nga: Susanne Schech and Rhonda Sharp. 2007 APEC Gender Analysis Workshop Training Manual.

Krahasimi i nevojave praktike dhe interesave strategjike

Nevojat praktike	Interesat strategjike
<ul style="list-style-type: none"> Janë nevoja të menjëhershme dhe afatshkurta që përqendrohen në nevojat bazë (ushqimi, strehimi, etj.) 	<ul style="list-style-type: none"> Kontribuon në ndryshimet strukturore afatgjata që nxisin rritjen e barazisë gjinore
<ul style="list-style-type: none"> Janë të veçanta për grupe të posaçme të grave dhe burrave 	<ul style="list-style-type: none"> Janë të përbashkëta për të gjitha gratë dhe për grupe specifike të pafavorizuara të burrave
<ul style="list-style-type: none"> Identifikohen lehtë 	<ul style="list-style-type: none"> Kanë të bëjnë me pozitë e pafavorizuara të grave dhe burrave, varësinë e tyre ndaj grupeve tjera, mungesën e burimeve dhe arsimit, cenueshmërinë dhe varfërinë e tyre si dhe ndikimin e dhunës në jetën e tyre Analizoni shkaqet rrënjësore të këtyre mangësive të cilat jo gjithmonë janë lehtë të identifikueshme nga grupet në fjalë
<ul style="list-style-type: none"> Adresohen duke siguruar inpute specifike si ushqimi, pompat e dorës, klinikat, kreditë, trajnimi për aftësi, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> Promovimi dhe fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile që synojnë çështjet në fjalë, janë adresuar përmes diskutimeve dhe analizës dhe përmes lobimit për ndryshimet ligjore dhe politike
<ul style="list-style-type: none"> Ekzistojnë tendenca për të përfshirë gratë dhe burrat si përfitues dhe vetëm nganjëherë si pjesëmarrës 	<ul style="list-style-type: none"> Përfshirja e grave dhe burrave të pafavorizuar si agjentë kyç të ndryshimit dhe në mënyrë aktive të kërkohen mënyra për t'u mundësuar atyre të bëhen agjentë të ndryshimit
<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i inputeve për të përmirësuar kushtet e jetesës së grave dhe burrave 	<ul style="list-style-type: none"> Mund të përmirësojë pozitën dhe statusin e grave dhe burrave
<ul style="list-style-type: none"> Përqendrimi në përmirësimin e kushteve të jetesës, por të mos punohet në mënyrë aktive për të ndryshuar rolet dhe marrëdhëniet tradicionale gjinore 	<ul style="list-style-type: none"> Mund të çojë në ndryshim të pozitave të grave dhe burrave në lidhje me njëri-tjetrin, si dhe në rolet e tyre përkatëse gjinore
<ul style="list-style-type: none"> Mund t'u mundësojë grave dhe burrave që të përmirësojnë kushtet e jetesës 	<ul style="list-style-type: none"> Mund të fuqizojë gratë dhe burrat për të transformuar marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin

I. Formulari i vlerësimit të relevancës gjinore (për këtë hap përdorni tabelën e dhënë në shtojcën e manualit të VNGJ-së së Kosovës)

Kjo fazë e parë përcakton qëllimin e politikës, strategjisë, ligjit ose programit të propozuar (Hapi 1 Përkufizimi i qëllimit të politikës) dhe tregon ndërlidhjen me barazinë gjinore (Hapi 2 Kontrolli i relevancës gjinore).

KJO ËSHTË FAZA E NJËJTË SI NË HAPIN 1 TË VNR-së megjithatë kësaj here palët e interesit duhet të shikojnë dhe të përcaktojnë politikën dhe qëllimin e saj përmes thjerrëzës për kontrollimin e aspekteve gjinore (gender lens) sa më shumë të jetë e mundur. Përgjigjet e përcaktuara në pyetjet "Lista kontrolluese 1" duhet të ofrojnë përgjigje që përshkruajnë situatën (AS IS) në sektor nga perspektiva gjinore. Përgjigjet e pyetjeve "Lista kontrolluese 2" duhet të ofrojnë përgjigje për situatën "duhet të jetë" (REZULTATET E ARDHSHEME TË DËSHIRUARA NË KËTË SEKTOR) nga perspektiva e barazisë gjinore

Hapi 2 Kontrollimi i relevancës gjinore (për këtë hap përdorni tabelën e dhënë në shtojcën e manualit të VNGJ-së së Kosovës)

Ushtrime: *Identifikimi i çështjeve gjinore në politikë dhe kontrolli për relevancën gjinore*

Objektivi

- Të kontrollohen politikat/projektet për relevancën gjinore

Koha: 20 Minuta

Udhëzime

1. Formoni grupe të vogla me 5-6 persona.
2. Diskutoni Rastin Studimor, mostrën xx, koncept dokumentin, draftin/propozimin
3. Rishikoni relevancën gjinore
4. Të gjitha grupet vlerësojnë nëse ky projekt/masë është me relevancë gjinore dhe nëse ka përdorur qasjen e nevojave praktike ose interesave strategjike për çështjet e barazisë gjinore.
5. Përgatituni të prezantoni vlerësimin tuaj para grupit.

II. Vlerësimi i ndikimit gjinor (për këtë hap përdorni tabelën e dhënë në shtojcën e manualit të VNGJ-së së Kosovës)

Kjo fazë është e nevojshme për të arritur barazinë gjinore dhe rritjen e barazisë përmes politikës/programit të propozuar (Hapi 3 analiza e ndjeshme Gjinore).

Bazuar në gjetjet e mbledhura në fazat e mëhershme, gjithashtu shqyrton opsionet e ndryshme dhe vlerëson ndikimin pozitiv dhe negativ në grupin(et) e synuar (Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor).

Hapi 3 Analiza e ndjeshme gjinore

Hapi 4 Peshimi i ndikimit gjinor (për këtë hap përdorni tabelën e dhënë në shtojcën e manualit të VNGJ-së së Kosovës)

4A. Vlerësim gjithëpërfshirës i ndikimeve

Në këtë hap, është e rëndësishme të përcaktohet se si politika ose masa legjislative do të kontribuojë në barazinë gjinore dhe të vlerësohet ndikimi i paraparë në marrëdhëniet gjinore. Pasi të jenë identifikuar ndikimet në politikën e propozuar, ato duhet të "maten", duke marrë parasysh kriteret në vazhdim në mënyrë që të peshohet ndikimi gjinor pozitiv, neutral ose negativ i çdo iniciative:

- ⇒ Pjesëmarrja e grave dhe burrave. Ndikimi konsiderohet pozitiv kur parashihet një rritje e konsiderueshme në përfaqësimin e gjinisë së nën-përfaqësuar në zonë.
- ⇒ Qasja dhe kontrolli i burimeve. Ndikimi konsiderohet pozitiv kur eliminohen boshllëqet ekzistuese gjinore (ose të paktën kur parashikohet zvogëlimi i dukshëm i tyre). Ky zvogëlim gjithmonë duhet të synojë rritjen e fuqizimit fizik, emocional dhe ekonomik të grave.
- ⇒ Normal shoqërore dhe vlerat e bazuara në gjini. Ndikimi konsiderohet pozitiv kur:
 - Modifikohen mekanizmat ose strukturat që ndihmojnë në riprodhimin e pabarazive gjinore.
 - Është bërë progres në eliminimin e stereotipave gjinor.

4B. Prioritizimi i ndikimeve (për këtë hap përdorni tabelën e dhënë në shtojcën e manualit të VNGJ-së së Kosovës)

Duke përdorur informacionin nga tabela 4A përpuni të prioritizoni ndikimin duke identifikuar rëndësinë e ndikimit dhe probabilitetin e ndodhjes së këtij ndikimi.

4C. Rëndësia dhe probabiliteti i ndikimeve (për këtë hap përdorni tabelën e dhënë në shtojcën e manualit të VNGJ-së së Kosovës)

Bazuar në informacionet e mbledhura në hapin 4B, identifikoni/listoni të gjitha ndikimet në diagramin e mëposhtëm. Janë të nevojshme dy diagrame të tilla, një për ndikimet pozitive dhe një për ndikimet negative. Varësisht nga situata ky diagram mund të theksojë rëndësi dhe probabilitet të ndryshëm për burrat/gratë nga grupet e ndryshme shoqërore, ekonomike dhe etnike.

4D. Prioritizoni ndikimet e konsiderueshme pozitive dhe negative

Ky hap përcakton prioritetin që duhet të lidhet me miratimin e politikave që promovojnë në mënyrë aktive barazinë gjinore dhe përcaktojnë nëse qasjet ose veprimet specifike politike janë të nevojshme për të siguruar se grupet specifike (brenda grupeve të burrave dhe grave) përfitojnë nga ndërhyrjet e politikës së propozuar.

III. Vlerësimi cilësor gjinor, Hapi 5 Gjetjet dhe propozimet-5A Rekomandimet dhe rezultatet

Listoni ndikimet/rekomandimet me prioritet, që janë pranuar si pjesë e politikës dhe qartësoni rezultatit e synuar që lidhet me ndryshimet e propozuara. Është thelbësore të përdoret gjuha neutrale gjinore për të garantuar se ka një vizualizim të drejtë të grave dhe burrave në të gjithë dokumentin.

5B Rekomandimet dhe metodat e zbatimit

SHTOJCA 4. SHEMBULL I ANALIZËS SË NDIKIMIT GJINOR

Disa instrumente që mund të ndihmojnë

1. Evaluating Socio Economic Development, SOURCEBOOK 2: Methods and techniques: Gender Impact Assessment

Kjo ofron disa udhëzime të detajuara mbi vlerësimin e ndikimit dhe vlerësimin e ndikimit gjinor

http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docgener/evaluation/evalsed/sourcebooks/method_techniques/conducting_impact_assessments/gender/index_en.htm

2. M Crawley and L O.Meara Gender Impact Assessment Handbook

Kjo ofron udhëzime miqësore të mbështetura nga shembuj përkatës që shpjegojnë dhe thjeshtësojnë procesin e vlerësimit të ndikimit të politikave për burrat dhe gratë në Irlandën e Veriut

www.ofmdfni.gov.uk/handbook1.pdf

3. J Rubery and C Fagan (2000) Gender Impact Assessment and European Employment S Policy (EGGE – EC's Expert group on Gender and Employment)

Kjo ofron një analizë të VNGJ-së, një qasje me 7 faza dhe vlerësimin e përdorimit të VNGJ-së në shtetet anëtare

http://docs.google.com/viewer?a=v&q=cache:KtEIN0vwHw0J:research.mbs.ac.uk/europeanemployment/Portals/0/docs/gendersocial/GIA_Report.pdf+GIA_Report.pdf+Rubery&hl=en&gl=uk&pid=bl&srcid=ADGEEShQDJCQS3StDr7Zqbb3fgBRhsIDQDZnWRypIO2YPEVuXg2bnw5LqBYFyUFst2ktMi0rwCUMkLt7kwOqTkMugUN1Es2zEIVdbKWWXKn41kcmI8uaCbqgVvJy5njksl8yq8rb3a&sig=AHIEtbSzUr5xoilAOd9LLzhfkW4HX42x3w

4. European Commission, Directorate-General for Employment, Social Affairs and Equal Opportunities (2007) Gender mainstreaming of employment policies:

Rishikim krahasues i tridhjetë vendeve të Evropës. Kjo përmban disa udhëzime mbi atë se çfarë përfshin integrimi gjinor i politikës së punësimit duke përfshirë integrimin gjinor në paga dhe karrierë, bashkërendimin e punëve të shtëpisë dhe në punë, politikat aktive të tregut të punës dhe politikat për të adresuar sigurinë e fleksibilitetit

http://docs.google.com/viewer?a=v&q=cache:3JzoEPe0QQJ:ec.europa.eu/social/BlobServlet%3FdocId%3D2059%26langId%3Den+Gender+mainstreaming+of+employment+policies:+a+comparative+review&hl=en&gl=uk&pid=bl&srcid=ADGEESjbAWUTUBLMTgGKHHIJMtOUj6K170Bt5uCqq904s1Eat8B7tKJ_oxTG9JeSouB1wSzON1wltIXwe8jkM_SwF01wWjBh0s4qoKVzwXsphSVUMxpmH3Hhka6kt2TuqqyR7AU0gHls&sig=AHIEtbQ035_qPOyXNoRhoXx29tRN1RThjg

5. Overseas Development Institute: Gender Impact Assessment: Framework for Gender Mainstreaming.

Kjo siguron një përmbledhje të dobishme të instrumentit për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor të Njesisë së Gruas dhe Barazisë në Mbretërinë e Bashkuar

<https://www.odi.org/publications/7263-gender-impact-assessment-framework-gender-mainstreaming>

Disa VNGJ të zbatuara kohëve të fundit në MB:

Future Fit Programme-

<https://shropshire.gov.uk/committeeservices/documents/s20529/EIA%20exec%20summary%20for%20JHOSC%20and%20media.pdf>

GIA of the Spring Budget 2017-

https://wbg.org.uk/wp-content/uploads/2016/12/WBG_Budget2017_Fullresponse-1.pdf

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

305-055.1(035)

305-055.2(035)

Manuali për vlerësimin e ndikimit të barazisë gjinore / Agjensia për Barazi Gjinore. - Prishtinë : Agjensia për Barazi Gjinore, 2019. – 108 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-545-24-2

ISBN 978-9951-545-24-2



9 789951 545242

